

Thoma Noti

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

N 85

**Këngë
për
nënat**


tregime

SH-31
NBS

THOMA NOTI

KËNGE
PËR
NËNAT

tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

që shprehin një dëshirë të theksuar të luftëtarëve të
kësaj llojeje të luftës. Në të vërtetë, këto shprehje
të dëshirës së luftëtarëve të kësaj llojeje të luftës
dëshirojnë të shprehin një dëshirë të theksuar të
luftëtarëve të kësaj llojeje të luftës.

Që të shprehin një dëshirë të theksuar të
luftëtarëve të kësaj llojeje të luftës. Në të vërtetë,
këto shprehje të dëshirës së luftëtarëve të kësaj
llojeje të luftës dëshirojnë të shprehin një dëshirë
të theksuar të luftëtarëve të kësaj llojeje të luftës.

FANTAZMA E TË HUMBURVE

Në sfondin e përflakur të perëndimit çadra e
kuqe e sulltanit dukej sikur që zhytur në një det
gjaku. Ajo ishte e madhe sa një pallat dhe ngrihej
mbi të tjerat si një mal.

Jashtë vazhdonin të binin daullet, ndërsa në
çadrën e kuqe hynin e dilnin komandantë ushtrish,
kamerierë me lloj-lloj mezeesh e frutash në duar,
gra dhe vajza gjysmëlakuriqe. Të gjithë ata bënë
çmos që ta ozbutnin sadopak zemërimin e egër të
sulltanit. Por atë asgjë nuk e kënaqte. Mbi gjoks
i rëndonte si shkëmb mëria e mijëra të rënëve.
Në fytyrën e tij dhe të atyre që e rrethonin nuk
kishte mbetur asnjë shenjë nga gëzimi i dy ditëve
të shkuara, kur në fushën pa anë e fund të kampit
ishte rreshtuar e tërë ushtria dhe kur sulltani, hi-
pur mbi kalë, kishte kërkuar me çdo çmim kokën

e Skënderbeut në majë të shtizës. Në përgjigje kishte ardhur një thirrje e thellë dhe e zgjatur, si gjëmimi i një mijë topave të zbrazur njëherësh. Ushtria njëqindmijëshe ngjante me një pyll të pafund, që lëkundej e gjëmonte duke ia zënë frymën tokës.

Po papritur çdo gjë që përmbysur e shpërfytyruar si në një ëndërr. Mbi «pyll» kishin rënë sëpatat e mijëra dhe mijëra «druvarëve». Kishin shkrepur rrufe të papërmbajtura. Që përhapur zjarri anembanë. Dhe «pemët» ishin djegur e rrëzuar e ashtu, pa degë e fletë, të përmbysura e të përzhitura ndillnin panik e katastrofë.

Sundimtari shfrynte me tërbimin e një ujku. Nuk ishte keqardhja për «pyllin» ajo që ia ndizte flakë mërinë. Toka do të rriste «pemë» të tjera dhe ai do t'i shtynte ato përsëri drejt zjarrit. Po a do të arrinte ta shihte një ditë kokën e Skënderbeut majë shtizës?

— Ju jeni të gjithë gënjeshtarë dhe frikacakë, bubulliu zëri i tij. — Përjashta!

Anëtarë të këshillit të luftës, komandantë të ushtrive dhe sanxhakbejlerë u ngritën pa zhurmë e dolën në heshtje. Sulltani qëndroi për një kohë i përhumbur në mendime. Fantazmat e të rënëve nuk i ndaheshin. Iu duk sikur ishte ulur mbi malin e kufomave të tyre. U ngrit dhe nisi ecejaket nëpër gadër. Mendimet e sulmuan si një re bletësh. Thirrjet e egërsuara të dhjetëramijëve, zhurma e paduruar e daulleve, shiu i shigjetave e gjëmimi i topave e ndiqnin hap pas hapi dhe ia zinin frymën. E ndjeu se po i merreshin mendtë dhe, po të mos i kishin ardhur në ndihmë, do të që rrëzuar. «Qenkam lodhur!» tha dhe u ul. Sytë pa shprehje i ho-

dhi mbi njeriun që qëndronte si hije në fund të çadrës. Ishte komandanti plak i rojës së tij personale. Sulltan Mehmeti i bëri shenjë të afrohej. Ai ra në gjunjë para tij.

— Ti je me një këmbë në varr dhe nuk ke frikë nga e vërteta, — foli sulltani pa e vështruar në sy. — Më thuaj: përse e humba betejën?

Kryeroja u përpoq t'i zgjidhte me kujdes fjalët dhe të shfrytëzonte rastin që iu dha për të vënë në jetë planin e tij:

— Kush më shumë se unë, o prijësi im i ndritur, zot e sundimtar i gjithë viseve të botës, kush më shumë se unë, pra, ka parë se si ka rrjedhur mbi këtë tokë lavdia e pashterur e osmanëve? Unë që të kam shërbyer me përrulje ty dhe të parëve të tu, që jam dëshmitar i aq fitoreve sa dhe vjet kam mbushur, unë që...

Sulltani ngriti dorën në shenjë padurimi:

— Mjaft! Unë pyeta: përse e humba betejën? Kryeroja priti, sipas zakonit, sa të ulej kraharori i zemëruar i sundimtarit dhe vazhdoi të fliste me përrulje:

— Zemra ime e plakur, o padishah i madh, që ka parë si janë dridhur e gjunjëzuar para teje kor-dhëtarë të shquar, mbretër e perandorë të Lindjes dhe të Perëndimit, nuk ka më forcë të durojë humbjen e pamerituar dhe kam vendosur, të vras veten. Por, para se ta bëj këtë, po i drejtohem zotit dhe robëruesit të saj me një lutje.

Sulltani i ngriti mjekrën me shkopin e tij të florinjte,

— Foll!

Ai ra prapë përmbys. Fjalët u rrokullisën mbi qilimin e trashë persian të lëmuar nga pëllëmbët e të gjunjëzuarve:

— Dëshira ime e fundit, o zot dhe kryezot, është që të më lësh të shkoj në atë kala të mallkuar dhe të shoh me sytë e mi se ku qëndron forca e paqenë e këtyre njerëzve të pafe, që guxojnë të ngrenë dorë kundër Allahut. Pastaj le të vdes.

Sulltani i ra disa herë çadrës nga kreu në fund. Befas qëndroi para njeriut të gjunjëzuar. Fjalët e kryerojës sikur rrinin ende pezull në hapësirën mbytëse të çadrës. Por ai e dinte se fjalët shpesh nuk kanë ndonjë rëndësi dhe nuk shprehin mendimet e vërteta të njeriut. Ç'shpërhte vallë fytyra e të gjunjëzuarit? Për një çast mendoi se vitet e fundit kishte parë më shumë shpina sesa fytyra njerëzish. Ç'i kishte shkrepur në kokë këtij plaku të hidhte një hap të tillë tani, kur ditët dhe vitet e kishte të numëruara? A e kishte menduar vallë se po të shkonte mund të mos kthehej më?

— Shko! — thirri. — Dhe mos harro se pasnesërisemi!

Kryeroja u tërhoq prapa me këmbë e me duar dhe doli. Të pragu i çadrës për pak u përplas me rojën. Drejtoi trupin, i hodhi një sy kampit të ushtrisë së mundur dhe shpejtoi drejt çadrës së tij. Atje e kishte përgatitur çdo gjë me kohë. Sa u shkëput nga çadra e fundit, u vesh si çoban vendas dhe e lëshoi doriun me tërë forcën përpara.

Ishte mëngjes dhe puhiza që zbriste nga mali iu fut në tërë qenien e tij dhe e bëri t'i vërshonte gjaku në deje me forcë. Kishte vite që nuk kishte provuar një ndjenjë të tillë. Ndofta që nga koha kur kishte ndjekur plot shpresë hapat e Mehmetit të vogël. Ylli i fatit i kishte pëshpëritur atëherë në vesh se nën Mehmetin do të fitonte një vend të lakmuar në oborr dhe ai vendosi t'i jepej me mish

e me shpirt kësaj pandehme. Pas kësaj, çdo gjë tjetër kaloi në plan të dytë dhe ai nisi ta ndiqte ngado Mehmetin e t'ia plotësonte me përulje çdo dëshirë. Ashtu sikurse njeriu nuk e vë re hijen e tij, ashtu edhe sundimtari i ardhshëm në fillim nuk i kushtoi asnjë vëmendje shërbëtorit të vet. Po me kalimin e kohës u mësua me të dhe nisi ta mbante pranë. Në ceremonitë e pambaruara të hipjes në fron, sundimtari i ri nuk harronte t'i hidhte kohë më kohë nga një vështrim, buzëgaz kryerorës së tij, gjë që natyrisht nuk kaloi pa rënë në sy. Këto qenë çastet më të lumtura në jetën e vet të gjatë e të përbuzur. Dalngadalë në shpirtin e tij mirënjohës erdhi e u poq një dëshirë e vetme: t'ia kushtonte dhe jetën dhe vdekjen Mehmetit. Ai e kishte ndjekur hap pas hapi sundimtarin e ri në fushatat ndëshkimore anembanë perandorisë, kishite qenë dëshmitar i sa e sa fitoreve të bujshme që tronditën botën.

Dhe ja, më në fund, kjo fushatë e pafat! Për muaj me radhë, që nga Anadulli e deri atje, në Arnautistanin e mallkuar, kryeroja vrojtoi me kujdes përgatitjet e mëdha të Mehmetit për të sulmuar Krujën. Thellë në ndërgjegjen e vet ai nuk kishte qenë asnjëherë i bindur për domosdoshmërinë e gjithë atyre përgatitjeve dhe vetëm pas rrebeshit i kishte dhënë të drejtë sulltanit. Kur trupat e jenigerëve, të azapëve dhe akënshinjve ishin kthyer të lebetitura në kamp, kryeroja e qortoi rëndë veten që ishte treguar një parashikues aq i keq. Në ato orë të kobshme vetëm ai e kishte parë sulltanin të hante thonjtë me dhëmbë derisa gishtat iu përgjakën dhe kërceu brenda çadrës me tërbimin e një bishe të mbyllur në kafaz. Në ato çaste

kryeroja plak kishte urreyer veten dhe, duke rënë në gjunjë para allahut, i qe lutur atij t'i shpjegonte nga zbriti ky rrebesh i çuditshëm. Por edhe allahu kishte heshtur dhe atëherë kryeroja mori guximin e i kërkoi leje sulltanit që ta lejonte të shihte me sytë e tij se si qëndronin punët në kampin e kundërshtarit.

Kali i bardhë, me perçet gjer afër gjunjëve, kapërcente në revan përrenj e monopate. Nga larg ai dukej sikur nuk ecte, por fluturonte mbi fantazmat e të rënëve. Duke dashur ta largonte mendjen prej tyre, kryeroja përpiquej të përfytyronte se ç'njerëz ishin ata që e kishin goditur aq rëndë krenarinë e sulltanit të ri në kulmin e fuqisë e të lavdisë së vet. Po fantazia e tij ishte krejt e pafuqishme për ta bërë këtë dhe ai shtyhej vazhdimisht përpara, me shpresë se do ta zbulonin sytë atë që nuk e arrinte dot mendimi.

Kur u ngjit majë një kodre, vuri re befasi se kështjellën e kishte aq pranë, sa iu duk se me një të kërcyer do të ndodhej në mes tyre. Kështjellarët dalloheshin qartë. Mbi kryet e tyre ngrihej një brohoritje e fuqishme burrash. «Festojnë», tha dhe ndjeu t'i rritej ajo ngasje e fuqishme, që e shtynte drejt bedenave. Duke dëgjuar zërat e kështjellarëve, thirrjet e tyre, befasi e pyeti veten se si e festonin vallë ata njerëz fitoren. A kishte ndonjë ngjasim në mes festës së osmanëve dhe festës së tyre? A e dinin ata se në atë betejë të egër fitorja dhe humbja kishin qenë fare pranë njëra-tjetrës? Më në fund, a arrinin ta merrnin me mend se jo shumë larg kështjellës, në një çadër të kuqe dergjej i mundur njëri prej sundimtarëve më ambiciozë e më kryelartë të Stambollit, Mehmeti energjik, i cili

pas kësaj fushate kishte ëndërruar Vjenën dhe tërë Evropën?

Duke u përpjekur t'u jepte përgjigje këtyre pyetjeve, as që e vuri re se kali kishte qëndruar pranë një burimi. Zbriti, piu me ëndje dhe i hodhi disa grushte ujë fytyrës. Uji ia kthjelloi mendimin dhe, bashkë me etjen, sikur ia shoi edhe kureshtjen për festën e tyre: Si pjesëmarrës në shumë fushata, ai ishte i sigurt se pas thyerjes së ushtrisë njëqindmijëshe fitimtarët qenë vërsulur mbi prenë e tyre, mbi të vrarët e të plagosurit, kishin bërë plaçkë pa hesap dhe qenë tërhequr të ngopur brenda mureve të kështjellës, ku hanin, pinin e zbaviteshin në kulm të gëzimit.

Në këto e sipër arriti nën muret e kështjellës. Rryma e fuqishme e luftëtarëve që dyndej drejt hyrjes kryesore e shtyu përpara.

— Po, ju, burra, krah ju solli e mira? — dëgjoji sakaq një zë.

Përgjigjen e dha një djalosh krenar me vështrim shqiponje:

— Nga viset e largëta të arانيتasve. Vrapojmë të përshëndesim Gjergjin tonë dhe të bashkojmë shpatat me ato të gjithë Arbërisë.

Dukej sikur muret nuk do t'i mbanin dot tërë ata luftëtarë dhe kështjella do të çahet. Dërgata e arانيتasve u ndal pak çaste në vendin ku luftëtarëve të rinj u shpërndaheshin armë nga ato të ushtrisë së mundur dhe zuri vend pranë mureve lindore të kështjellës. Prëj andej rrugët që të sillnin aty dukeshin si në pëllëmbë të dorës. Ishte diçka e mahnitshme. Kryerója e sulltanit vështronte dhe nuk arrinte ta kuptonte nga vinin tërë ata njerëz e ku shkonin. A ishte e mundur që atij vendi, sa një e

njëqindta, e perandorisë, të mos i mbaroheshin luftëtarët, apo ai ishte në ëndërr dhe çdo gjë që e rreme? Megjithëse vrojtoi gjatë, ai nuk ishte i zoti të thoshte nëse ato dallgë ngjiteshin nga thellësitë drejt kështjellës, apo dilnin prej saj e shpërndaheshin në të katër anët, duke i dhënë detit të një rrezve gjithnjë e më shumë gjerësi e thellësi.

— Hoop!... Urraaa... Burraaaa...

Kryeroja mblodhi supet i hutuar. Vështrimi i tij rrëshqiti përsëri mbi fytyrat e luftëtarëve, duke u përpjekur të gjente përgjigjen që e mundonte. Po pamja që kishte përpara ishte aq e çuditshme dhe e papritur sa, po të mos kishte qenë vetë dëshmitar i ngjarjeve tragjike të dy ditëve të kaluara, do të thoshte me bindje se beteja ishte bërë diku larg dhe se kështjellarët po përgatiteshin për ndeshjen vendimtare, që do të zhvillohej të nesërmen a të pasnesërmen, duke e shikuar me siguri e besim fitoren që i priste.

— Hoop!... Urraaa... Burraaaa...

Nga vinin ata zëra? Ç'po ngjiste ashtu me kështjellarët? Në vend që të shijonin frytet e ëmbla të fitores, të pinin verën e saj dehëse, ata plotësonin vendet e të rënëve, rindanin armët, stërviteshin. Të mëdhenj e të vegjël kishin rrëmbyer kazmat, qysqitë e varetë dhe meremetonin muret e kështjellës, duke u përpjekur të zhduknin me kujdes çdo gjurmë që kishte lënë armiku. Pak më tej vështrimin ia rrëmbeu një pyll i dendur burrash qelshëbardhë. Buçima e zërave të tyre përplasej në malet dhe që andej kthehej jehona e saj rrëqethëse.

«Vallëzojnë», tha me vete kryeroja dhe bëri t'u afrohej.

«Jo, stërviten», shtoi më pas në heshtje. Me-

gjithatë, e ndjeu se nuk qe i zoti të përcaktonte nëse ata stërviteshin apo vallëzonin. Veshët i gjëmonin nga thirrjet e fuqishme, kurse nën këmbë toka dridhej sikur binte tërmet. Teksa vështronte, iu kujtua se një dijetar i oborrit i kishte thënë se ky popull shkonte duke hedhur valle në luftërat për Atdhe, kurse në vallet e tij kishte futur shumë elementë të stërvitjes luftarake.

«Allah, allah!» — mermëriti në mënyrë të pavullnetshme dhe ngriti duart drejt qiellit. Në çast u kujtua ku ndodhej dhe vështroi me frikë përreth se mos ky veprim i pamatur ishte bërë shkak për t'u zbuluar. Por jo. Diçka tjetër i kishte rrëmbyer vështrimet e njerëzve, gjersa dallgët e ndalën lëvizjen dhe deti i njerëzve gjëmoi sa u tundën muret e kështjellës:

— Po vjen Gjergji!

— Rroftë Gjergji ynë!

— Rroftë!... Rroftë!...

Vështrimi i kapi atë burrë shtathedhur e ballëllart. Nga të katër anët njerëzit e rrethuan në çast me një dashuri e respekt të patreguar. Kjo dukej në gjësimin e zërave, në duart që zgjateshin drejt tij, në atë ndjenjë të pafund dashurie që shprehnin fytyrat e tyre. Deri atë çast atij nuk i kishte takuar kurrë të shihte në sytë e një populli një ndjenjë të tillë dashurie, respekti e mirënjohje për udhëheqësin.

«Ja, pra, Gjergji i tyre! — mendoi. — Qenka thinjur para kohë!» Përfytyroi Skënderin pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetëvjeçar, të fortë e simpatik, siç e kishte parë shumë vjet të shkuar shesheve të oborrit. Që atëherë ai i kishte lënë gojëhapur oborrtarët me energjitë, vullnetin dhe guximin e

vet të pashoq. A e dinte vallë Skënderi se ç'përshlytje bëri kthimi i tij në Shqipëri, sidomos të dhjetëra e qindra të rinjtë e marrë peng nga princat vasalë? A e merrte me mend se ç'shkruhej e fli-tej për të në oborrin e sulltanit? A e kishte dëgjuar se kryekronikani i oborrit ishte mbyllur në qeli vetëm pse kishte thënë që Skënderbeu u përkishte shekujve të ardhshëm më shumë se shekullit të vet? Jo, ai nuk duhej të dinte asgjë nga këto, përderisa nuk i jepte asnjë rëndësi vetes, përderisa nga veshja, qëndrimi e sjellja nuk dallonte aspak nga ata mijëra luftëtarë të cilëve u shtrëngonte duart, u rrihte krahët dhe bisedonte si shoku me shokun. Kryetrimi iu afrua sakaq luftëtarëve që mbanin lart njëra të gjatë e të rëndë dhe bashkoi supin me të tyre, duke e lënë gojëhapur kryerojën e sulltanit. Atë çast dhjetëra supe burrash e grash bënë të njejtën gjë dhe, sa të hapje e të mbyllje sytë, trari rrëshqiti sipër kokave të njerëzve dhe u gjend në muret rrethuese të kështjellës. Kryeroja u përpoq të ndiqte rrjedhën e njerëzve e të mos e humbiste nga sytë Skënderbeun, por puna për meremetimin e kalasë mori zjarr dhe ai nuk arrinte të dallonte burrin nga gruaja, fëmijën nga i rrituri, kryekomandantin nga ushtari.

Të pasnesërmen në agim, në atë shesh të pa-fund u rreshtua për nisje ushtria dhjetëramijëshe e sulltanit, me fytyrat e kthyera në drejtim të Anadollit. Një ushtri tjetër, e mjaftë për të fituar një betejë, dergjej përgjithnjë me shpatullat në dheun e ftohtë të vorrëzave masive. Zemra e sull-

tanit pikonte helm. Mbi atë kraharor rëndonte më-
ria e të vrarëve dhe e robërve që kishin mbetur
brenda një dite rreth kështjellës, pa i sjellë asnjë
dobi perandorisë. Nën bedenët e asaj kështjelle të
murme kishte mbetur ajka e ushtrisë së tij, më tri-
mat e trimave, ata që, nën gjëmimin e daulleve, hi-
dheshin në ballë. Ndërsa ushtarët më të vjetër, ata
që për shumë vite me radhë kishin boshatisur ham-
mbarët e perandorisë, në çastin më kritik kishin
ditur t'i shmangeshin me dhëlpëri kosës së vdekjes
duke e braktisur fushën e betejës.

Si ngjau kjo? Nga shpërtheu tërë ai rrebesh
tamam në çastin që priste lajmëtarët e fitores?

I dërrmuar nga pesha e rëndë e mendimeve
ogurzeza, sulltani u përpoq t'i rikujtonte edhe një
herë ngjarjet nga fillimi, ashtu siç kishin rrjedhur.
Po ato i ngatërroheshin çuditërisht me njëra-tjetrën
dhe atij padashur i erdhi ndër mend një vegim i
fëmijërisë.

Atëherë ishte fare i vogël, nëntë apo dhjetë
vjeç. I përcjellë nga mizëria e rojave dhe e kujdes-
tarëve, kishte dalë të shëtiste mbi kalë maleve të
Azisë së Vogël. Aq shumë që hutuar pas gjithë
atyre mrekullive të natyrës që shihte për herë të
parë dhe aq shumë ishin gëzuar rojat me zbavitjen
e sulltanit të ardhshëm, sa asnjëri nuk e kishte ve-
në re se si ishte prishur koha papritur. Gjer pak më
parë në qiell lundronin re të mëndafshta, por befas
shtrëngata u dynd nga të katër cepat e horizontit
dhe qielli nisi të goditte tokën me kamxhikë vetë-
timash e me breshër kokërrmadh, sa shoqëruesve u
hyri frika në palcë për fatin e Mehmetit të vogël.
Tamam ashtu kishte ngjarë dhe atë mëngjes. Në
fillim çdo gjë ishte e shndritshme e plot shpresa,

pastaj befas koha u prish dhe vetëtimat e shpatave dhe breshri i plumbave e i gjyleve e ndoqën ngado si murtajë ushtrinë turke.

Tani ajo ushtri të gjallësh dhe të vdekurish qëndronte rreth tij; kurse tej, në horizont, ngrihej hijerëndë kështjella e Kastriotëve. Ç'po bënin vallë në ato çaste zotërit e asaj kështjelle? Ku ndodhëj tani kryeroja? Çfarë kishin parë e dëgjuar sytë dhe veshët e tij?

Duke dashur t'u jepte një përgjigje këtyre pyetjeve, sulltani herë-herë e hidhte vështrimin drejt kështjellës, po i hiqte sytë shpejt. Ajo e verbonte si një diell.

— Po vjen! — u dëgjua një zë. Mehmeti u fut në çadër dhe priti.

Kryeroja hyri brenda, po këtë radhë nuk ra në gjunjë, si zakonisht. Ndofta mendoi se udhëtimi që kishte bërë i kishte dhënë të drejtën të qëndronte disa çaste ballë për ballë sundimtarit të lartë.

Sulltani i hodhi një vështrim nga koka te këmbët. Iu duk sikur kthehej nga një udhëtim që kishte nisur në fëmijërinë e tij dhe kishte zgjatur gjatë gjithë jetës, gjersa që plakur. Gropat e syve i ishin thelluar çuditërisht dhe sytë i kishin humbur brenda tyre. Mbi mollëzat e faqeve i që shfaqur hija e verdhë e vdekjes.

Sulltani i shkoi pranë:

— E madhe duket brenga që shprehin ata sy, o plak fatkeq, — tha.

— E rëndë si balta e varrit, o padishah i madh, — iu përgjigj tjetri. Gjatë gjithë kohës më dridhej trupi si në ethe. Kurrë nuk më është dridhur ashtu në jetën time. Hera-herës më ngjante sikur më

ndiqte pas një hije e madhe sa bota. Veshët më gjëmonin nga buçima e hapave, e krismave dhe thirrjeve të zgjatura. Ecja dhe nuk guxoja të ktheja kokën. Më dukej se po ta ktheja nuk do të isha në gjendje të vazhdoja më tej. Më në fund këmbët m'u bindën. Qëndrova dhe shikova.

— Kush ishte? — pyeti Mehmeti me padurim.

— Në fillim nuk pashë asgjë. Por shpejt e kuptova se pas më vinin fantazmat e mijëra të rënëve dhe të atyre, që do t'i ndjekin hap pas hapi në botën e hiçit.

— Dora e Mehmetit mbërtheu mylqin e shpatës.

Kryeroja nuk foli më. Mbylli sytë, dhe ndërsa priste shpatën e ftohtë t'ia ndante trupin më dysh, i dolën përsëri para syve muret e kështjellës së Krujës.

Sulltani qëndronte si i ngurosur në fronin e lartë. Kryeroja nuk e vuri re se në fytyrën e tij shprehej një mëri e thellë dhe padurim i përmbajtur.

— Po tjetër ç'panë sytë e tu të lodhur, o plak i mjerë? — pyeti.

— Tjetrën sytë e panë, o sundimtar i madh, po mendja ime e plakur nuk është ende në gjendje ta kuptojë, — dhe, si heshti një hop, vazhdoi qetësisht: — Turma e pambaruar ma rrëmbeu nga sytë Skënderbenë. Çava në mes tyre me shpresë ta ndeshja përsëri. Doja të sigurohesha, o padishah, në qe ai apo isha gabuar. Kur ja, njerëzit largohen majtas e djathtas. Rruga boshatiset. Dikush afrohet ngadalë. «Ai!» — thashë dhe nuk e di pse ndjeva të më rrihte zemra fort. Por në vend të tij, që lart zbriste një grua flokëthinjur. «Do të jetë e ëma!»

mendova dhe prapë ndjeva rrahje zemre. Ajo sec mbante para duarve dhe çapitej me vështrimin mbi kryet e njerëzve. Pranë një topi qëndroi dhe vendosi mbi grykën e tij atë që mbante në duar. Largoi me kujdes mbulesat e leshta. Atëherë unë dallova një fëmijë. «Trashëgimtari!» mendova dhe u afrova ta shihja. Po përsëri isha gabuar. Ishte biri i një kështjellari të thjeshtë.

— Ç'po bëjnë me të? — pyeta.

— Është duke vdekur, — thanë. — E tretën ethe të forta. Topi do ta shpëtojë.

Isha i sigurt se gëzimi i fitores i kishte dehur dhe ata nuk dinin ç'thoshin e ç'bënin. Dikush afroi një kovë të madhe. Uji rrodhi si krua mbi fëmijën, pastaj mbi grykën e topit dhe u derdh në një kazan. Atje nëna lagu një çarçaf dhe mbështolli me të të sëmurin. Pastaj të gjithë mbajtën vesh. Prisnin. M'u duk sikur ankthi u ngrit nga zemrat e tyre dhe pushtoi qiellin. Më në fund u dëgjua një belbëzim i dobët. Turma nxori një ofshamë, që u duk sikur doli nga gjoksi i çliruar i tokës ku qëndronin dhe... Sulltani e humbi dërrmën dhe u vërsul si egër-sira drejt hekurave të kafazit.

— Ç'ngjau më tej? — ulëriu.

— «Shpëtoi! E shëroi topi!» — gjëmoi vendi tej-
embanë.

— Gënjen!

— Si do të guxoja ta bëja këtë para robëruesit të shpirtit tim? — pyeti.

Tjetri e kuptoi se ata sy mund t'i fshihnin çdo gjë për kurrë të vërtetën.

Kryeroja uli kokën.

— Edhe në ëndërr i dëgjova ato britma gëzimi e triumfi, — vazhdoi.

— Një zë i thellë më thotë se ata njerëz, që e kanë lidhur me armët e tyre dhe jetën dhe vdekjen, i përkasin pavdekësisë.


Sulltanit s'iu ndenj në një vend. Brofi në këmbë dhe eci me hap të rëndë mbi qilimin e butë të punuar nga mjeshtrit më të shquar të Persisë. Kryeroja nuk ia shihte shprehjen e fytyrës, por vjetët e shumtë në shërbim të sulltanëve e kishin bindur se Mehmeti ecte ashtu, kur e pushtonte zemërimi i egër i stërgjyshërve të tij.

Befas këmbët u ndalën. «Po vjen fundi!» — mërmëriti kryeroja.

Sulltani ia ngriti kokën me majën e shpatës vezulluese.

— E ndiej se nuk ke faj, — i tha. — Ky popull do të na mbulojë me turp jo vetëm ne, por edhe brezat që do të vijnë! — dhe tehu i mprehtë i shpatës u zgjat mbi qafën e shtrirë të kryerojës.

Gjaku i ngrohtë rrodhi mbi qilimin e trashë persian, duke i mbështjellë me heshtjen e varrit fjalët e sulltanit, që nuk e lejoi dëshmitarin të mbetej i gjallë.



AI I BUZËQËSHI

Ishte një pasdite e qetë vjeshte. Retë qëndronin si një çadër e stërmadhe mbi ndërtesat e larta, të ngritura në të dy anët e rrugës. Njerëzit ecnin të heshtur trotuarit, kurse në rrugë rëshqiste butë-butë një karrocë luksoze, e tërhequr nga dy kuaj të lartë e të bardhë. E kredhur në heshtjen e vet të mistershme, rrugica e periferisë sikur i bënte sfidë qytetit të zhurmshëm, që po zhytej pa e kuptuar në mugëtirën e lagësht.

Po brenda pak minutave çdo gjë u përmbys. Nga jugu u dynd mbi qytet një erë e çmendur. Si të ishte fshehur pas ndërtesave, ajo frushulloi me zhurmë dhe e mbështolli rrugicën me një re pluhuri, të përzier me fletë pemësh e copa letrash. Xhamat krikëllinë.

«Po vjen shiu!» — nisën të ndiheshin zëra.

Dhe, si të ishte një mortajë vdekjeprurëse ajo që do të vinte, njerëzit nisën të vraponin për t'u

fshehur nën strehët e për t'u mbrojur nga ajo re e murme bubulluese. Por tamam në atë çast ngjau e papritura; që e mbështolli rrugicën në ankth. U duk sikur që lart reja e murme e goditi qytetin me gjarpërinj të zjarrtë rrufesh. Pastaj çdo gjë u sqarua. Nga mesi i rrugicës që zbrazur me rrokopujë një grykë revolveri. Rrugicën e përshkoi tej e tej fishkëllima rrëqethëse e plumbave. Në një çast gjithçka u fiksua në vend, gjersa një forcë e gjithëpushtetshme e mposhti atë hophth dhe nisi prapë lëvizja. Por tani në këtë lëvizje kishte diçka komike, si në një film multiplikativ.

— E vranë!

Kjo fjalë u ngrit mbi rrugicë me një kumbim të cuditshëm.

— E vranë!

Brikena u drodh.

— Kë vranë?

Para syve i rrëshqiti një djalë truplartë. Pastaj çdo gjë u përzejë në atë vorbull erërash, krismath e britmath. Ajo u përpoq të kuptonte se ç'ngjiste rreth saj. Por ishte diçka e pakapshme.

— Kë vranë?

Zërat, hapat, fishkëllimat e gjëmimet dukej sikur prisnin përgjigje.

— Kuestorin!

— Unë e pashë kur ra. Ishte duke hipur në veturë. Sa hapi derën e qëlluan. Rojat ua mbathën.

Vajza u çlirua nga ankthi, që e kishte përfshirë atë rrëmbyeshëm. Në fillim nuk e kuptoi as vetë pse kishte ngjarë kështu me të. Ndofta ngaqë vrasja nuk kishte të bënte me atë djalin truplartë që ishte shfaqur e zhdukur si një vegim i vetëtimtë.

— Vranë kuestorin!

Njerëzit qenë bërë gardh para saj. Ajo u ngrit mbi majat e gishtave. Tej supeve të tyre dalloi një njollë gjaku. Kufomën gati nuk e pa. As veturën. Dalloi vetëm dy sy thujse të xhamtë, të hapur tej mase. Pikat e shiut përplaseshin mbi ta, por kapakët nuk lëviznin. Gjithçka kishte ngrirë e ishte mbështjellë nga vdekja e akullt, veç currilit të gjakut, që rrëshqiste bashkë me rrëkezat e shiut. Ato rrëkeza u afroheshin këmbëve të njerëzve. Ajo ndjeu të mbushej trupi me mornica. Befas e pushtoi dëshirë që të vraponte, të largohej sa më shpejt nga ai vend. Kurrë në jetën e saj nuk e kishte pasur vrasjen aq pranë. Bëri të largohej. Iu duk sikur nuk do të ecte mbi asfalt, por mbi fishkëllima bilbilash, krisma armësh dhe njolla gjaku. Fare afër gjëmuan zërat:

— Të bllokohet rrugica!

— Kontroll i përgjithshëm!

Ajo nuk ishte në gjendje të dallonte kush thërriste dhe kush heshte.

— Janë këtu! Këtu!

— S'kanë si na shpëtojnë... T'i kapim!

Këpucët alpine me gozhdë kafshonin asfaltin. Llozet e armëve kërcisnin. Sytë e spiunëve rrëshqitnin mbi fytyrat e njerëzve. Kërkonin vrasësit. Të gjitha këto sikur përsëritnin me ritmin e hapave: «T'i kapim!... T'i kapim!... T'i kapim!...»

Njerëzit u hutuan nga këto thirrje. Por shpejt e mblodhën veten. Dikush tha:

— Po i ndjekin!

— Kë?

— Atentatorët.

Mbi këto fjalë u ngrit i rreptë dhe urdhërues një zë i fortë burri:

— Të mbrojmë shokët! T'i fshëhim në mes tonë!

Këto fjalë rendën gojë më gojë.

Që lart vazhdonte të zbriste një shi i rrimtë.

Shpërthenin bubullimat. Po tani askush nuk e kishte mendjen tek ato. Turmën e kishtë pushtuar një shqetësim i ri. Zërat përplaseshin mbi njëri-tjetrin. Atë shprehnin guxim, pasiguri, ngulmim. Pak ngat pak thirrjet, hapat, gjësimet u përmblodhën të gjitha në dy fjalë të vetme: «T'i kapim!» Pranë Brikenës dikush pëshpëriti:

— Afroju asaj! Është jona.

— Ajo u kthye me rrëmbim.

— Jam unë! — dëgjoi një zë të ulët. Pastaj dalloj djalin truplartë, sytë e tij të njohur dhe një buzëqeshje të lehtë e të druajtur.

Diku i kish parë atë fytyrë të mprehtë, atë ballë të gjerë, ata flokë të dredhur. Ndofta në shkollë. Në rrugë. Ose në një mbledhje ilegalësh. U mat përsëri ta pyeste. Por ai nuk i la kohë. I thërrinë në vesh:

— Po më ndjekin!

Edhe zëri i tij ishte i njohur. Krejt i njohur. Ku e kishte dëgjuar?

Ajo po hutohej. Ai e kupoi gjendjen e saj dhe i hodhi krahun. Vajza e vështroi përsëri. Djaloshi përsëri i buzëqeshi lehtë. Ishte një buzëqeshje e ngrohtë, e përzier me hutim.

— Ç'kërkoni nga unë? — e pyeti Brikenën.

Ai ia shtrëngoi krahun ngadalë.

— Unë vrava kuestorin! — i pëshpëriti.

Ajo hapi sytë.

— Ju!

Që prapa i erdhi një zë i qetë:

— Motër, mos u huto!

U kthye të shihte atë që foli. Ishte një mo-shatare e saj. Ndofta më e re. Me gjoksin ende të paformuar mirë. Me flokët e pleksur gërshet.

Në zërin e saj ndihej një forcë e çuditshme. Edhe atë zë diku e kishte dëgjuar.

— Mos u huto! — i tha shoqja. — Nuk jemi vetëm. Kemi gjithë popullin që na mbron. Ja, dëgjo!

Brikena u përqëndrua. Ngado vinin zëra: «Të mbrojmë shokët! Janë vëllezërit tanë!» Vështrimi i saj kërkoi fytyrat e atyre që flisnin. Përreth kishte vetëm djem e vajza si ajo. Të gjithë e vështronin. I buzëqeshnin.

«Ku i kam parë, vallë?»

Në vështrimet e tyre ndjeu forcë. U kthye nga ai.

— Ecim!

Pranë tyre u dëgjuan hapa të rëndë xhandarësh dhe thirrjet:

— T'i kapim!

— S'kanë ku futen!

Këto fjalë e shqetësuan disi. Po sikur t'i kapnin vërtet?

Padashur iu kujtua vëllai, Tomori. Edhe ai merrej me punë ilegale. Ajo i qe lutur ta njihte me shokët e njësitit gueril. Ai i fliste vazhdimisht për luftën dhe i kishte premtuar se do ta merrte në grupin edukativ. Po nuk arriti. Dy muaj më parë e kapën. Në gji i gjetën trakte. E torturuan egërsisht, por nuk mundën t'i nxirrnin asnjë fjalë. Pastaj e internuan larg. Ku ndodhej tani, vallë? Eh, sikur të ishte diku pranë e ta shikonte! Mbase e njihte edhe djalin që i kishte hedhur krahun. Edhe të tjerët ndofta i njihte. Tani ajo ndodhej në

mes tyre. Sa e kishte ëndërruar atë çast bashkë me shoqet. Ato flisnin gjithnjë për guerilast. Dhe ajo kishte menduar: Sikur të mund të njihej me atentatorët! Sikur të mund të bashkëpunonte me ata! Të ndihmonte edhe ajo luftën. Kurse tani, ja ku i kishte ndeshur krejt papritur!

Ajo vështroi rishtas atë që e kishte kapur nga krahu. Sa i ri ishte! Moshatar me vëllanë e saj. A thua vërtet ai ta kishte shtrirë pa jetë kuestorin? Po si mundej të ecte aq i qetë?! Po Tomori a do të mundej ta bënte këtë? A kishte ngritur ndonjëherë dorë ai mbi fashistët? E pse jo! Ndofta atë mbrëmje që ishin ndier krismat afër shtëpisë së tyre, kur ai kishte rrëshqitur vetë i tretë nëpër oborr dhe ishte hedhur në kopshtin e fqinjit.

Ajo e ndjeu se pak nga pak po shpihej. Po i largohej marramendja e fillimit. Kjo mbase vinte ngaqë rreziku vërvitej si hije rreth tyre. Mbajti vesh:

— Shoku Çelik!

«Çelik? Ku e kam dëgjuar këtë emër? Cili është Çeliku?» Ktheu kokën.

— Shoku Çelik! Ka nisur kontrolli. Fute pistoletën në borsetën e shoqes! Nën spinaq!

Ai që foli rrëshqiti anash dhe doli para tyre. Ecte aq pranë, saqë për pak u pengua në hapat e tij. E vështroi me vëmendje. Kishte shpatulla të gjera. Trup mesatar e të ngjeshur. Rrallë kishte parë një trup të tillë.

Djali truplartë i pëshpëriti:

— Afrota me marifet borsetën, të lutem!

Ajo ia afroi. Ai ngriti spinaqin e me një shpejtësi të pakapshme futi në të revolverin. Sa i rëndë iu duk asaj! Po sikur t'i shpëtonte nga duart dhe

të gjëmonte para këmbëve të tyre? Atëherë këpucët alpine do të afroheshin edhe më e do të hidheshin mbi ta.

«Ja vrasësit!» — do të shpërthenin gërthitjet. Pastaj...

Mendimet iu përzjënë me hapat që po afroheshin. Shokët? Jo. Ishin hapa më të rëndë. Kërcënues. Njerëzit u ngjeshën edhe më shumë rreth tyre.

— Po afrohen!

Ajo i ndjeu fare pranë thirrjet. Kërcitjen e llozeve. E kuptoi se kishte ardhur çasti kritik. Po për çudi nuk u frikësua. Nga i kishin ardhur ato forca?! Ndofta ngaqë e shihte se nuk ishte vetëm. Ngado i rrethonin shokët.

Ai i shtrëngoi krahun dhe nisi t'i pëshpëriste fjalë pa kuptim e me një intonacion të çuditshëm, si në ligjërata dashurie. Ajo u skuq e tëra. Gjer atëherë askush nuk kishte guxuar t'i flistë ashtu.

— Të shtiremi se jemi të fejuar! — i tha ai. — Duhet!

Dhe vazhdoi qetësisht...

— Mua më quajnë Brikena.

Ai buzëqeshi.

— Emër i bukur! — belbëzoi.

Ajo as që e vuri re se i ishin afruar murit të xhandarëve. Një burrë rrondokop bërtiste në kupë të qiellit. Vajza nuk kuptoi asnjë fjalë. As tiparet s'ia dalloi mirë. I shqoi vetëm sytë. Sa të pësh-tirë i kishte! Të lyrët. Tërë gjak.

Eci drejt tyre, duke e ndier fare pranë frymëmarrjen e shokut truplartë.

— Më hahet diçka, — i tha atij me qëllim.

— Restoranti është atje. Shkojmë!

Sytë tërë gjak lëvrinë nën qepalla:

— Dokumentet! — foli vrazhdë, duke kontrolluar me ngut djaloshin. Pastaj ndali përballë saj. Ajo nuk mund t'i vështronte ata sy. I vinte ndot.

— Ç'kanë me ne! — e pyeti «të fejuarin».

Ai mblodhi supet.

— Nuk e di. Më duket është vrarë një njeri.

— Kuestori! — ulërinë sytë e përgjakur.

— Ah! Sa tmerr!

Ajo u mbështet tërësisht në trupin e djaloshit. Pas pak çanë së toku mes murit të xhandarëve.

— Këtej! — se kush thirri. Ata të dy zgjatën hapin. U futën në një shtëpi përdhese. Atë çast buçiti një zë tjetër:

— Andej!

Thirrjen e përsëritën katër-pesë bashkë. Pastaj e tërë rrugica gjëmoi:

— Andej! Andej!

Xhandarët thërrisnin, u binin bilbilave, vraponin. Të gjithë qenë vënë në lëvizje, si të kishte shpërthyer një bombë diku pranë. Brikena nuk arriti të kuptonte se ç'po ngjiste ashtu, për ku vraponin ata.

— I mashtruan shokët! — pëshpëriti ai. — I mashtroi populli!

Disa minuta më vonë rrugica ra në heshtje. Ata qëndronin pranë dritares dhe e ndienin se e papritura i kishte lidhur fort.

— Ta falemnderit, Brikenë! — tha ai.

Asaj i ngjante sikur ishte në ëndërr. Gjoksi i ulëj e i ngrihej me rrëmbim. I dukej sikur nuk do ta mbante dot tërë ngazëllimin e asaj dite të paharruar... Kishte hyrë në radhët e luftëtarëve për liri.

Shiu i imtë vazhdonte.

ATA QË I BIEN DYARES

Maloja kishte zënë vend pas një shkëmbi me shkrepë. Përmes unazës së thepit të pushkës e kishte ndehur vështrimin përpara. Gjithçka ishte përfshirë brenda atij thepi: bregu i lumit, luginë dhe kodra përtej, ku kishin ndërtuar pozicionet ushtarët armiq. Maloja e njihte me pëllëmbë atë vend. Aty kishte pritur qengjat e kecat në duar, kishte ngrënë përshesh me bukë misri! Në atë tokë të ashpër shtufi e kishte lëshuar revan doriun, ndërsa tej, ku zbriste i kulluar uji i lumit, e kishte zënë pestrovën me duar. Maloja ishte vërtitur në tërë atë vend, gjersa ishte rritur e bërë aq, ndërsa tani e vështronte përmes shqekëzës së maliherit.

Pështyu dhe e shtrëngoi shuallin e pushkës në gropën e kraharorit. Iu duk sikur rrëzë kodrës di-

kush rrëshqiti si gjarpër. Vështroi me kujdes. Po, nuk ishte gabuar. Maloja e futi «gjarprin» në unazën e thepit dhe tërhoqi ngadalë këmbëzën. Pushka krisi.

«Ba-bam!» sikur e imituan nga përtej. Pastaj u ndeh një heshtje e gjatë. Dukej sikur në ato kodra nuk kishte shenjë jete. Po ai dhe shokët e dinin mirë se kjo dukje ishte e rreme. E dinin se nga ajo anë përgjonin qindra sy. Përgjonin grykët e pushkëve, të automatikëve dhe mitralozave armiq, kurse më prapa qenë topat, që e kafshonin tokën si përbindsha të uritur. Hëpërhë gjithçka po heshtte. Por ja! Një gjëzim i fuqishëm tundi vendin. Shungullima e plasjes mbështolli faqen e malit.

«Top i mallkuar!»

Maloja u përpoq ta largonte mendjen nga ai. Unaza e thepit e përfshiu përsëri vendin në rrethin e hekurit, si një kufi që ndantë jetën nga vdekja. Ajo unazë, ai thep dhe gryka nën ta kërkonin me ngulm prapa çdo shkëmbi, pas çdo gëmushe. Prisin një lëvizje që të nisnin në çast plumbin. Po prapë iu fanepsën topat. Gjëmimet e tyre sikur talleshin me krismat puf — puf të pushkëve e mitralozave, madje edhe të bombave. Talleshin me pushkën e tij.

«Tfu!»

Pak nga pak nga gjoksi iu ngjit një ngasje e çuditshme për të zbuluar më çdo kusht pozicionin e topave e për t'u matur me ta. Le të ishin pjellë e nëmur e hekurit!

«Dale, pa shihemi!»

Në fillim dëshira për t'u matur me topat e kishte bërë të qeshte. Por ngadalë vështrimi i tij i la prapa kodrat dhe vrapoi atje, tek ngriheshin

grykat. Edhe kur heshtja u thye dhe nisën të kërkëllinin pushkët, ai mendjen e kishte përsëri tek ato gryka. Dëshira për t'u ndeshur me topat e rëmbeu të tërin.

U ngrit në bërryla: «Ku je, o i mallkuar!» Këto fjalë u mbuluan nga një krismë si shpërthim rrufeje. Prëdha e parë u përplas te këmbët e malit. E dyta e ndezi flakë kasollen në kodër. E treta e nguti lart shtufin në mes të formacionit të çetës.

— Lutua! — drithëroi një zë shoku.

Maloja ktheu kokën dhe pa Luton të shtrirë përmbys. Vrapoi drejt tij.

— Luto!

Tjetri ktheu kokën. Buzët i kishte gjysmë të hapura, kurse sytë... Ç'ishin ata sy? Të zbardhur, pa bebëza.

— Lutooo!

Ai zgjati dorën andej nga erdhën predhat. Buzët iu mblodhën. U përpoqën të formonin fjalë, por nuk arritën.

— Luto, vëlla, fol!

Ai mblodhi forcën që i kishin mbetur. Bebëzat e syve të tij u kthyen një hop në vend.

— Merimi hak! — tha. — Shkatërrojini! — dhe koka sikur iu këput.

Maloja i hapi gjoksin. Dora i preku diçka të fortë në atë gjoks leshtor. Dyarja? Jo. Copë prede! E hoqi ngadalë. Nga goja e shëmtuar e plagës shpërtheu një buronjë gjaku.

— Luto!

Po Lutoja heshtte. Maloja e kuptoi se ai do të heshtte përgjithnjë. Lutoja, komandanti i skuadrës së tij, shoku më i mirë. Lutoja i fëmijërisë, fitues së dhënve, i përsheshit me dhallë. Shoku i

aksioneve. I netve pa gjumë. I ditëve pa bukë. I këmbëve pa opinga. Lutoja i këngëve.

— Lutooo!

— E shkallmoi topi i mallkuar! — foli Zarifi.

Ai nuk e dalloj kush foli. Nuk ia shqoi fytyrën. Vështrimi i qe errësuar.

Shokët u ngritën nga pozicionet. Rrëshqitën ngadalë dhe erdhën aty. Vunë buzët mbi Luton. Po Maloja nuk pa asgjë nga këto. Nuk dëgjoi asgjë. Mbi kodër, mbi shtuf, në vend të shokëve, shihte vetëm atë — Luton. Ballin e ftohtë. Sytë e hapur. Buronjën që po shterte. Dhe mbi të gjitha dëgjonte zërin e tij: «Merrni hak! Shkatërrojini!»

Kërceu më këmbë.

— Do shkoj! — tha.

— Ku? — e pyeti komandanti.

— Të shkatërroj ata, topat.

— Mirë, — ia ktheu komandanti, — shkol! Ti i njeh me pëllëmbë këto vende. Merr dhe Zarifin.

U nisën. Tej gjëmoi një batare. Plumbat kafshuan fletët e shelgjeve.

— Shtrihuni!

Ata nuk u panë më. Tre shokë tërhoqën trupin pa jetë të Lutos. Të tjerët rendën te pozicionet.

Maloja ishte si në ëndërr. Me një kërcim arriti te rrapet. Atje qëndroi. Mbajti vesh. Shikoi rrjedhën e lumit, shtufin, arën e mbjellë dhe sipër tyre malin. Çdo gjë ishte në vendin e vet, si më parë. Vetëm Lutoja nuk ishte më. Ai dergjej atje tej, i goditur për vdekje nga predha e topit. Malos nuk i bëhej të besonte. Kishte të gjallë para syve fytyrën e tij, buzëqeshjen, vështrimin. Atë vështrim që e përzhiti flaka e barutit. Ato shpatulla si krahe mali. Atë gjoks shkëmb. Zërin që iu burrërua duke

thirrur shokët aksioneve. Mendimin që iu poq llogoreve... Maloja psherëtiu. E rrëmbyen kujtimet...

Një ditë ata lanë tufën dhe zbritën në çetë. Ishte dimër i sertë atë vit, sa të ngrinte dhe fjala në buzë. Ata u frynin duarve që t'i ngrohnin dhe qëndronin të heshtur para komandantit. Gjokset ua rrihte era. Dëborë u binte mbi flokët e dendur, mbi vetullat e trasha.

— Demek, doni të luftoni? — i pyeti komandanti.

Ata ulën kokat.

— Po, me se? Me duar? Dyfeqe s'keni!

— Do t'ia marrim italianit.

— Demek, erdhët duarbosh.

Maloja nxori nga gjoksi dyaren. E nxori dhe Lutoja. Komandantit i ndrinë sytë.

— Dini t'i bini?

— Jemi çobanë.

— Pa hë, njëherë!

Ata i afruan dyaret te buzët. Përreth u mblodhën partizanët. Lutoja ia mori. Maloja e ndoqi pas. Tingujt u derdhën të mbështjellë nga flokët e dëborës. U duk sikur zbriti aty tufa dhe veshi faqen e kodrës.

— Avazi «Dhentë kullosin», — tha komandanti.

Pastaj morën një melodi tjetër. Në tinguj u ndje gëzimi i barinjve për vedrat e mbushura me shkumë, blegërimat e qengjave, tringëllima e zileve.

— Dhentë në shtrungë», — u dëgjua përsëri zëri i komandantit.

— Qenke çoban dhe ti! — i foli Maloja.

— Çoban e bir çobani, — qeshi komandanti dhe u kthye nga shokët: — Si thoni, i pranojmë?

— Djem të mirë, — thanë ata. — I pranojmë.
Malos i gufoi zemra!

— Me një kusht, — foli komisari. — Që të mësojnë dhe këngët e luftës.

— Mirë, — u përgjigjën ata. — I mësojmë.

U caktuan në një skuadër. Në luftimin e parë u bënë me automatikë. Dy ditë e dy net nuk mbyllën sy nga gëzimi. I zbërthyen, i mbërthyen dhe i pastruan për merak një herë, dy. S'u lanë burmë pa prekur. U mësuan shpejt me çetën. Edhe çeta me ta. Në luftë gishtat kërcenin mbi këmbëzën e automatikut. Në pushimë dridheshin mbi dyare. Tingujt qanin me mall për tufën. Më pas në melodi-në e tyre u fut diçka e re, që të kujtonte krismat e pushkëve, dhimbjen për shokun e rënë, gëzimin e fitores.

— Do bëheni kompozitorë, — u tha një ditë komisari.

Ata nuk e kuptuan atë fjalë, por e ndien se lidhej me këngët që u gëlonin në gjoks.

«Eh, Luto, Luto!»

Zarifi e vështroi i habitur.

— Përçart flet?!

Jo, ai nuk fliste përçart. Ai fliste me Luton. Atë shihte në vend të Zarifit. Atë në rrapishte, mbi valët e lumit, kudo. S'ndaheshin as ditë as natë. Edhe mbrëmjen e fundit në Labovë bashkë e shkuan, në një shtëpi përdhese. Iu kujtua djali i vogël i të zot të shtëpisë, me dy sy si rruaza të tejdukshme. Edhe atë e quanin Luto. Ishte gazi i shtëpisë. Maloja kishte nxjerrë dyaren, kurse Lutoja, kishte nisur të imitonte zogjtë e pyllit. Dhoma që mbushur me tinguj e cicërime. Vogëlushi vërtitej nëpër këmbët e tyre; bilbili ligjëronte, ai zgjaste dorën ta kapte;

bilbili fluturonte në buzët e Lutó partizanit, ai hu-tohej, gjersa më në fund vogëlushi bëri si bëri dhe u fut në gjoksin leshtor të tij. Lutoja i lëmoi flo-kët dhe s'mbylli sy tërë natën.

«Më kujtoi fëmijët ky adashi», — i pati thënë në mëngjes Malos.

«Edhe mua», — ia pati kthyer Maloja.

— Eh, Luto, Luto! — psherëtiu përsëri.

— Me kë kuvendon kështu, o Malo? — e pyeti Zarifi.

— Ai u përshkund. Mbajti vesh. Lufta vazhdonte. Në të djathtë të shkëmbit kërkëllinte mitralozi i Za-çes, pak më tej breronte automatiku i Sotirit. Armët e tjera nuk i dallonte dot nga njëra-tjetra. Nga e kundërta përgjigjeshin fashistët. Armët e tyre bë-nin zjarr të pandërprerë dhe vetëm kur bukose-shin nga gazrat pushonin ca si për t'u ngopur me frymë dhe derdhnin prapë plumba të nxehtë. Du-kej sikur e kishin bërë me radhë. Qëllonte herë njëra palë, herë tjetra. Këtë rregull e prishte gjë-mimi i topave. Ata qëllonin pa e përfillur rradhën dhe e shtrinin pushtetin e tyre gjer prapa maleve, ku arrinte e ku nuk arrinte syri. «Prisni dhe ca!» — foli Maloja.

— The gjë?

Në vend të përgjigjes ai dredhoi rrapishtes. Nuk ecte, por çante si një tigër. Me një kërcim hi-dhej nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Atje ndalej, përgjonte, mbushej me frymë, mbliidhej sërish grusht dhe lëshohej përpara. Te pylli i lajthive era e ba-rutit dhe frushullima e ajrit e bënë të ndalej. Iu duk sikur u hap toka dhe mbi krye çau një shpend i zjarhtë.

«Këtu qenkan!» — tha me vete dhe e pushtoi

tërë vendin me një vështrim. Ai njihte aty çdo rrënjë, çdo fije bari. Verës ulej pranë burimit dhe i binte dyares. Afroi dorën në gjoks, po në vend të saj sikur preku copën e predhës në gjoksin e Lutos.

«E mallkuara!»

Çau përmes lajthive. Vështrimi i tij kërkoi topat. Dhe ja! Ja ku ishin, të rëndë, mospërfillës, tamam atje ku verës ai ndërtonte vathën e dhenve. Rreth tyre silleshin ushtarët. Ata flisnin një gjuhë të huaj, rrëqethëse, si vetë krismat. Ishte hera e parë që armiqtë i kishte aq pranë. I numëroi. Dy topa dhe dhjetë ushtarë. Afroi automatikun. Topi i djathtë dhe ushtarët që i shërbenin u përfshinë në unazën e thepit. Do t'i lante hesapet me ta një e nga një. Pastaj do të vraponte te Lutoja. Do t'i thoshte: «Luto vëllai, ta morëm hakun. I shkatërruam». Dhe mbase do t'i lehtësohej paksa ajo peshë që i zinte frymën. Lutoja qe shtrirë atje tej. Aty do të shtriheshin ata. Ai një, ata dhjetë. A mund të barazoheshin? Kurrë. Sa Lutoja nuk vlente një ushtri e tërë.

«Eh, Luto, Luto!» — Afroi pushkën dhe mbësh-teti fytyrën mbi qytën e saj. Shikimin e zgjati tej. Tek ushtarët. Cili nga ata e kishte nisur predhën drejt Lutos? Cili qe vrasësi?

Vështroi ushtarin që kishte më afër. Ishte ulur mbi kofshën e topit dhe i kishte kthyer krahët. «Jo, pas shpine nuk të vras». Dhe kërkoi një tjetër. Atë që mbante predhën në duar.

— Ç'presim? — Ishte zëri i Zarifit.

— Zarif, ti nuk do të qëllosh. M'i lër mua të dhjetë, do t'i shfaros me bomba. Kupton?

Zarifi tundi kokën. Ai ia njihte kokën Malos. E dinte sa shok e kishte Luton. Si i therte për të. Po

t'i qëronte vetë hesapet me armiqtë, ndofta do të lehtësohej diçka më shumë nga dhimbja për të.

— Si të duash, por kujdes mos të të shpëtojnë.

Maloja nxori granatat, por nuk arriti t'i rreshtonte. Vendi u tund nga shungllima. Maloja vështroi pozicionet e çetës. Po predha nuk ra atje. Plasi më thellë.

— Qëlluan Labovën!

Mbi pullazet e shtëpive u davarit një re e hollë. Malos iu kujtuan cicërimat e bilbilit dhe fëmija me sytë si rruaza, që mbështeti kokën në gjoksin e Lutos.

«Po unë ç'pres?»

Rrëmbeu granatën e parë. I hoqi me dhëmbë siguresën dhe e vërviti. Pas saj një tjetër. Trajektorja ishte e lartë. Ato rendën drejt topave. Rreth tyre vërtiteshin ushtarët armiq, me predhën në fole. As që e merrnin me mend se vdekja që mbanin në duar ishte sulur e pamëshirshme drejt tyre.

Granatat e para qenë ende në ajër, kur Maloja vërviti të dytat. Një çast dhe shpërthyen krismat. Kuadri ngriu në vend. Tymi u ngrit ngadalë, si sipari i një drame të përgjakshme. Maloja u ngrit mbi bërryla dhe vështroi. Kuadri sikur qe kthyer përmbys. Ushtarët armiq përpëliteshin në grahmat e fundit. Befas njëri u ngrit dhe u lëshua drejt lajthishtes. Maloja e mori në shenjë, po kur nisi të tërhiqte këmbëzën vuri re se ushtari nuk kishte sy. Në vendin e tyre rridhnin dy currila gjaku. U përplas sakaq mbi një shqopë, si një dem me kokë të prerë.

— Të fala Duçes! — i tha Maloja dhe u ngrit. Disha hapa më tej shenjuesi i topit të parë kishte rënë përmbys. Malos iu duk sikur po merrte një sy gjumë. Por, nga mënyra si e kishte lëshuar trupin dhe si

i lëkundeshin duart në hapësirë, e kuptoi se ishte pa jetë.

— Dhe ti të fala bëji!

Si përgjigje, fare pranë u ndje një krismë pisto-lete. Plumbi i fshikū faqen, por atij nuk i bëri ndonjë përshtypje, si të mos kishte të bënte me të. Pastaj ushtoi një krismë tjetër. Kishte qëlluar Zarifi.

— Dësh ta kripti mirë, — i tha ai, duke ecur drejt një ushtari që kishte rënë në gjunjë e rrotullohej sa majtas djathtas. Dy pëllëmbë më tej qe pistoleti «Beretë», me të cilën kishte qëlluar mbi Malon pak sekonda më parë. I përgjunjuri përpiquej të përmblihte të gjitha forcat e ta kapte. Por ishte tmerrësisht i pafuqishëm. Arma qëndronte aq afër, po dhe aq larg tij, sa janë jeta dhe vdekja. Maloja ia afroi «Beretën» me majën e opingës. Ushtari hap-i gishtat mbi dorëzën e pistoletës, por nuk mundi t'i mblidhte më. Maloja e kuptoi se kjo ishte lëvizja e tij e fundit dhe eci më tej. Pas mburojës së topit u dukën në fillim dy duar, pastaj një fytyrë. Sytë, goja, flegrat e hundës e gati poret e asaj fytyre ishin zmadhuar çuditërisht dhe kishin humbur çdo pamje njerëzore. Malos i erdhi ndot:

— Frikacak! — i tha. — Ti mund të më vrisje.

— Nxori pistoletën dhe ia drejtoi. Por ushtari i ra në gjunjë dhe nisi t'i puthte opingat, pantallonat prej shajaku, duart e të thoshte diçka të pakuptueshme në gjuhën e tij. Ajo fytyrë, ato duar, duke-shin krejt pa jetë, pa ngjyrë. Maloja nuk kishte parë kurrë një fytyrë të tillë.

— Frikacak! — bërtiti rishtas dhe pështyu më-njanë.

Robi, siç u duk, e kuptoi se e kishte fituar jetën, ndaj s'dinte ç'të bënte. Iu afrua Zarifit dhe

nisi t'i puthte edhe atij opingat. Pastaj nxori nga xhepi një fotografi zhubra-zhubra e ua tregoi. Maloja vështronte herë robin, herë djaloshin në fotografi. Thujse nuk ngjasonin. Në krah i rrinte gruaja, me fytyrën si të ikonave, po me gjoksin të mbushur që nuk ia zaptonte mirë fustani.

Robi seç shtoi tjetër në gjuhën e tij. Maloja u hodhi sytë dy fëmijëve që i buzëqeshnin që nga fotografia. Ata dukeshin të mirë e të pafajshëm, si gjithë fëmijët e botës.

— Të kishe menduar të paktën për këta! — iu drejtua robit. Pastaj vështrimi i tij i përhumbur u ngul diku thellë, andej nga vinin brohoritjet e shokëve, brohoritjet e fitores së tyre. Po ku qe ai, Lutoja?

U ul mbi kofshët e ftohta të topit, nxori dyarën e nisi t'i binte. Dukej sikur nga ajo nuk dilnin tinguj, por lot.

KËNGË PËR NËNAT

Ata e thërrisnin të gjithë «nënë». Kurse ajo u thoshte: «bijtë e mi». Përgjerohej për ta. I vështronte si futeshin në oborr, si e mbushnin dhomën me zërat e të qeshurat e tyre, si e ndanin kafshatën në mes dhe i regëtinte zemra. «Bijtë e nënës, — u gëzohej, — ju ka nëna të mirë. Ju ka nëna trima!»

Natën, kur ata flinin, ajo ngrihej. I shihte të gjithë me radhë. I mbulonte. Pastaj ndalej te Mitroja i saj. Ai flinte, si gjithnjë, pranë dritares. Ajo largonte pak perden, atij i binte mbi fytyrë një fashë e zbehtë drite, që e tregonte edhe më të ri, më të pashëm. Nëna vinte dy bërrylat mbi gjunjë, mbështeste mjekrën mbi duar dhe e vështronte. E vështronte e nuk ngopej. Hundën e kishte me kurriz e ballin të shtruar, si i ati, Sadushi. Nga sytë dhe lëkura e lëmuar dhe e zbehtë e fytyrës i ngjante asaj.

I dukej sikur në fytyrën e tij qenë përzier të dy, qenë lidhur pore pas poreje dhe jetonin përjetësisht. Pa i kujtohej si u dilte gjumi kur ai ishte i vogël. Si përkuleshin me Sadushin mbi djep dhe si qeshnin e luanin me të. «S'arrite ta gëzoje, — iu drejtua fotografisë së varur në mur. — Të përpiu kurbeti». Dhe u kthye prapë nga i biri, e vështroi e psherëtiu thellë. «Shpirt!» — mërmëriti.

Ai mernte frymë qetë. Në fytyrë iu end një buzëqeshje. «U qesh shokëve, — mendoj. — I sheh në ëndërr.» Ata qenë shtrirë radhë-radhë. «Më rrofshi! — tha ngadalë. — Marrshi ditë dhe nga unë!» E përsëri e ndali vështrimin te Mitroja. I shkoi dorën mbi ballin me bulëza djerse. «Zemra e nënës!» Ai hovi. E kishte gjumin pendë. U mbështet mbi bërryla e picërroi sytë:

— Nënë, nuk po fle ti?!

— Fjeta, bir, fjeta. Po ti ishe zbuluar e thashë mos ftoheshe.

Ajo eci mbi majat e gishtave. Ai shpuri buzën në gaz. Në cepat e buzëve iu formuan dy gropëza. «Si Sadushit», mendoj nëna dhe u shtri në dyshekun e saj. Mitron e mundi prapë gjumi, kurse asaj nuk i flihej. Diku u dëgjuan krisma të thella. Ato, herë afroheshin, herë largoheshin. «Bijtë e nënës!». Përsëri u ngrit ndenjtur. Ata flinin pranë e pranë. «Si vëllezër, — mendoj. — E lumja unë! M'u mbush dhoma me djem. Të ishte edhe ai e t'i shihte! T'u gëzohej.»

Sadushi i donte shumë fëmijët dhe ajo i lindi dhe vajzë dhe djalë. Vajzën e martoi. Në shtëpi i mbeti vetëm Mitroja si një syth. Pëstaj hodhi shtat si plep. Ajo e vështronte në bebe të syrit. «M'u rrit, — thoshte. — M'u bë burrë. Po ç'e do, më mbeti je-

tim me baba gjallë.» Dhe përgjonte rrugën se mos i dilte Sadushi nga ndonjë anë. Po ai s'erdhi që s'erdhi dhe ajo u venit si gonxhja në degë. Gëzimi i saj qe Mitroja, djali i saj i vetëm. Kurse tani ja ku i kish gjithë ata vëllezër! «Ju pastë nëna», — mërmëriti rishtas.

Zemra i kërcente si zog në kraharor. Herë i bëhej se dëgjonte krisma, herë se ndonjëri merrte frymë rëndë. Dhe ngrihej e i vështronte me radhë. Afronte veshin. Përgjonte. Pastaj qeshte me veten. «Të mirët e nënës! Flenë si qengja.» Ajri i dhomës iu duk i rëndë. U zgjat dhe hapi dritaren përgjysmë. Puhiza e mëngjesit u dynd në dhomë. Jashtë këndonte bulkthi i natës. Një këndes rrahu krahët. «Po zbardh, — mendoj. U ngrit. — T'u bëj trahana, — tha. — Trahanaja u pëlqen shumë.»

Ata u zgjuan njëri pas tjetrit. Kërceyen mbi shoshokun e u gajasën së qeshuri. Pastaj u kujtuan për të.

— Nëno, ku je? — pyeti Nuria. E pa nga plasa e derës, tek përziante trahananë dhe rendi në të ndarën tjetër. — Seç më hahet sot një gjë e mirë, — tha.

— Çfarë, xhan?

— Trahana me gjalpë e me erë trëndeline.

Nëna hovi:

— Harrova trëndelinën!

Rendi te dollapi. Po Mihali i kish vënë shpatullat.

— Nuk të lë ta hapësh, — i tha, — se na mbarohet.

Ajo u përpoq ta largonte. Po ku lëvizej ai! Ata e rrethuan sakaq dhe filluan me shakatë. Asaj iu morën mendtë nga lumturia.

— Trahanaja, — bërtiti. — M'u zu trahanaja!
— Mos ki dert! — e siguroi Loni. — Po e trazoj
unë.

Mihali i preu rrugën.

— Kam një bisedë serioze sot me ty, nëno, —
dhe psherëtiu thellë.

— Përse holas kështu, mor bir.

Mihali përpiqej të dukej i mërzhitur, por ishte
e kotë. E tërë fytyra i ndriste nga një gaz i brend-
shëm. Psherëtiu prapë.

— Kam rënë në dashuri, nënole, — tha ngadalë,
duke u shkelur syrin shokëve.

Nëna, profi nga gëzimi:

— E lumja unë! Po me cilën, mor bir? E njoh
unë atë?

— Si s'e njeh! E ke gjitone.

— Naja!

— Ajo vetë. Po ç'e do, nuk më përfilli fare.
«E ke të kotë, — më tha një ditë. — Ti je si fundi
i tiganit».

— Nëna rrahu gjunjët.

— Naja kështu? Dhe unë e dija për vajzë të
shtruar! Dale, pa më sheh! — Dhe u ngrit. — Të gjen
nëna një thëllëzë ty që, kur ta shohësh, të lësh
mendjen.

— Po mua, nëno? — pyeti Nuria.

— Edhe ty, të pastë nëna! Vetëm gojën të ha-
pësh. — Dhe i pa me radhë. Ata qeshnin dhe kaf-
shonin buzët, duke e mbajtur me zor të qeshurën.
Nëna e kuptoi se po bënë shaka. — Nuk keni sy
për Qahbe ju, jo; — tha. — Na ka prishur mendjen
gjermani.

— Ai është me sot e me nesër, — ia ktheu Mi-
hali. — Kur ta qërojmë së këtejmi, ta dish, nuk

të shqitemi pa na gjetur nga një nuse. Dhe të gjitha dasmat do t'i bëjmë këtu. Në këtë odë.

Nënës iu mbushën sytë nga gëzimi.

— Eh, të vijë ajo ditë, pa le të vdes! — tha. — Ju ka nëna si pëllumba.

— Dua dhe unë një, — foli ngadalë Mitroja.

Nëna rrëmbeu stapin dhe iu lëshua.

— O nënole, jo kaq avash, jo kaq avash! — e ngacmoi i biri.

Ata u shtruan të hanin, po shakatë nuk i lanë. «Janë të gëzuar, — mendoi nëna. — Do të kenë marrë ndonjë lajm të mirë». Ishte mësuar ajo me ta. E dinte se, sa më të gëzuar e hokatarë të ishin, aq më të vështira qenë detyrat që i prisnin.

— Ruajuni! — i porositi kur po dilnin.

— Sonte mos na prit! — i tha Loni kur po dilnin. — As nesër.

Asaj iu prenë gjunjët nga meraku. — Ruajuni! — përsëriti. Dhe i vështroi me radhë kur po dilnin. «Të pesë luanë, — tha me vete. — Luanët e nënës».

Mitroja doli i fundit. Iu hodh në qafë dhe e puthi. Asaj i regëtiu zemra nga gëzimi.

— Mos u vono shumë! — e porositi. — Po të kesh punë, dërgomë fjalë, se s'më zë gjumi.

Atë natë nuk mbylli sy. As të nesërmen. Përgjonte rrugën. Sa e mundte pak gjumi, i bëhej se dëgjoheshin hapa. «Erdhën!» — thoshte dhe i afrohej dritares. Për rruga heshte, si nata.

Mbrëmjen e tretë trokitën në derë. Ajo e hapi në çast. U futën të tre kokulur. Ajo priti, po Mitroja dhe Luani nuk u dukën. E ndjeu në çast se diç do të kishte ngjarë.

— Na i zunë, — tha Loni.

Nënës sikur iu ça gjoksi më dysh. Fjalët iu lidhën komb në grykë.

— Ku i çuan? — pyeti.

— Në rrugën e Durrësit. Te Xhelal Staravecka.

Ajo e njihte mirë Xhelalin. Dikur kish qenë partizan, i futur kundrabandë në Lëvizje. Kish ngrënë e kish fjetur në shtëpinë e saj. Pastaj qe hedhur me Ballin.

— Qeni, — tha. — Tradhtari!...

Ata nuk guxonin të ngrinin sytë. E dinin mirë se sa e dëshpëroi nënën lajmi që i sollën, sado që ajo përpiqej të mos e jepte veten.

— Na kanë zbuluar, — tha Loni. — Do të dalim në mal.

— Kur?

— Që sonte.

— U ngritën njëri pas tjetrit. Nëna i porositi gjer jashtë. I mbështolli në gjoks. Qëndruan gjatë pranë e pranë, pa thënë asnjë fjalë. Ishin të bindur se nuk gjendej fjalë t'i shprehte plotësisht ato që ndienin. Nëna nuk ua lëshonte duart. Ua shtrëngonte në të sajat.

— Mbeç me shëndet! — i tha Loni. — Shokët nuk do të të lënë të mërzitësh.

Shtëpia u zbraz. Asaj iu duk sikur i mbeti i zbrazët tërë kraharori. Qëndroi në mes të dhomës. Heshtja ia zuri frymën. Dysheku ishte shtruar, po ajo e dinte se nuk do të mund të mbyllte sy atë natë. U kujtua se në qoshe të dhomës ishin bërë kapicë teshat, që i kishin sjellë për t'i larë. Ndezi zjarrin, vuri ujën për t'u ngrohur dhe iu vërsul rrobave. Gjersa çeli dita, u mor me to. I lau dhe i ndeu të thaheshin në oborr. Pastaj u nis të kërkonte djem-të.

Në hyrje të komandës së xhandarmërisë e ndali roja.

— Dua djalin, — tha. — Ku ma keni djalin?

— Kë ke djalë ti? — e pyeti një oficer që bridhte poshtë e përpjetë korridorit të errët. Ajo nuk ia dalloi dot fytyrën.

— Mitron.

Oficeri iu afrua. Ndaloj përballë saj. Në dorë mbante një kamxhik meshini.

— Atë komunistin e rrezikshëm? — pyeti dhe u duk sikur do ta përpinte.

Ajo përsëriti pa u tutur:

— Dua djalin! Ku ma keni? Ç'doni nga ai?

Oficerit iu rrudh balli. Ktheu krahët dhe eci prapë poshtë e përpjetë korridorit.

— Hajde nesër, — tha më në fund dhe ngjiti shkallët përpjetë. Ajo u mbështet te muri i komandës së xhandarmërisë dhe priti gjersa u errësua krejt. Xhandarët zbrisnin dhe ngjiteshin me këpucët me gozhdë. Ndaleshin një hop para saj, e vështrojnë dhe e pyesnin. «Dua djalin, — u thoshte ajo. — Nxirrni djalin!» Ata se si ia ngulnin sytë dhe i kthenin shpinën. Seç thoshin me njëri-tjetrin, po fjalët e tyre sikur i përtypnin këpucët alpine me gozhdë. Iku kur u ndezën dritat. Tërë natën lau përsëri teshat e të pasurve. I hekurosi, i vuri stivë, përgatiti gjellën për djemtë dhe kur zbardhi dita shkoi prapë në komandën e xhandarmërisë. Atje e priti po ai oficer, edhe kësaj here me kamxhik në dorë. Fijet e kamxhikut qenë shpleksur.

— M'u prish në trupin e tët biri, — i tha, — Ai e ka kyçur gojën dhe s'flet, po unë nuk mërzitem. Kam kamxhikë të tjerë.

Nënës i erdhi t'i hidhej në grykë. Po t'i hidhej,

mund ta mbyste me ato duar, aq të madhe e kishte urrejtjen. Po nuk e dha veten.

— Dua djalin! — përsëriti. — Më sillni djalin!

— Hajde nesër njëherë! — i përgjigj sërishmi oficeri dhe humbi prapë përpjetë shkallëve.

Ajo priti sa priti, pastaj shkoi në shtëpi, lau prapë teshat e të pasurve, gatoi për djemtë dhe erdhi prapë që pa gdhirë. Oficerit i përshkënditën sytë. Hoqi me kamxhik kapakun e tenxheres.

— Mirë paske gatuan, po ç'e do! Ai s'ka dhëmbë ta përtypë. Ia theva që të gjithë, — i tha dhe tregoi grushtin. Gishtat i nxinin nga gjaku i piksur.

— T'u theftë koka! — e mallkoi nëna.

Pas disa ditësh e njoftuan se djalin ia kishin shpurë në burgun e ri. Ajo shkoi atje. Pa se në hyrje prisnin edhe shumë të tjerë.

— Takimet fillojnë pas orës dy, — i thanë.

Asaj iu duk minuta orë. Nuk i durohej sa t'i shih-te djemtë me sy. «Kushedi sa i kanë munduar, kati-lët», mendoi. Atë çast dikush e kapi nga krahu.

— Nëna e Mitros je? — e pyeti.

— Po.

— Mos u mërzit! Mitroja është më mirë. Kujde-sen shokët për të.

"Ajo u drodh. Përse tha se Mitroja ishte më mirë? Pra, e kishin torturuar. Kur u hap dera e jashtme dhe u fut në korridorin e gjatë e të errët, iu duk sikur do t'i pushonte zemra. Nga krahu e mban-te një vajzë me flokët gërsheta. E shtrëngonte fort. Nëna e ndjeu se vajza dridhej.

— Po ti kë ke në burg? — e pyeti.

— Shokët, — tha ajo.

Ecnin të dyja sikur e tërhiqnin shoshoqen me

forcë. Korridori u dukej i gjatë e i gjatë. Në fund edhe nxinte, edhe zbardhte diçka.

— Ja ku janë!

Ajo dalloi hekurat dhe djemtë prapa tyre.

— Mitro!

Po zëri mbeti brenda saj.

— Mitro!

Ata seç pëshpëritën me zë të ulët. Njëri prej tyre u shkëput nga shokët dhe u largua.

— Prit pak! — i thanë. — Ta sjellim ne tani Mitron.

Minutat u zgjatën tërkuzë. Rreth saj njerëzit që kishin ardhur për takim flisnin me zë të ulët me ata që qëndronin tej hekurave, po ajo nuk arrinte të dallonte asnjë fjalë. E kish mendjen te djali. Përse nuk ishte edhe ai me shokët? Përse nuk kishte dalë në takim si të gjithë? Mos i kishte ngjarë ndonjë e keqe? Po shokët nuk jepnin shpjegim. Kurse vështrimet e tyre sikur i fshihnin diçka. Ajo as që e vuiri re, kur u larguan e kur në mes tyre zunë vend dy të tjerë.

— Nënë!

Kujt i flisnin? Cilët ishin ata? Vështroi të parin, pastaj të dytin.

— Nënë! Nuk na njeh?

Ajo u zmbrops.

— Janë ata, Mitroja me Luanin! — i tha vajza me gërsheta dhe ia shtrëngoi edhe më shumë kra-hun.

Mitrua!?

— Nënë!

Zëri i tyre! I Mitros së saj. Ajo i mbërtheu fort hekurat që të mos binte.

— Bijtë e mi! Ç'ju kanë bërë kështu të poshtrit!?

U përpoq t'i shihte më mirë. Fytyra e Mitros nxinte nga goditjet. Nofulla e majtë i ishte fryrë. Mbi vetulla i shquhej qartë një shenjë plage. Kurse Luani e kishte ballin të lidhur. Fasha skuqte nga gjaku i piksur. Buzët i ishin mbushur me puçrra.

— Miti... Luan... Bijtë e mi!...

— Nënë! Nëna jonë!

Ajo nuk arriti të dallonte kush i tha këto fjalë. Të gjithë ata që ishin tej hekurave e vështronin. Të gjithë i pëshpërisnin fjalën «nënë», që e bënte me flatra.

— Qëndroni të fortë, djem-o! Për këtë ditë ju kemi rritur!

— Dhe ti, nënë, mos u jep!

Këto qenë të vetmet fjalë që këmbyen. Ajo kishte aq shumë për t'u thënë. Edhe ata. Po nuk mundën të shqiptonin gjë tjetër, gjersa erdhën rojat me bajonetat hapur dhe i përzunë.

Takimi kishte mbaruar.

Ajo doli. Nga krahu e mbante vajza me gërshet.

— Harova t'u jepja gjellën! — tha nëna dhe u vërsul drejt hekurave. Po bajoneta i preu rrugën. Ajo u kthye. Në duar mbante tenxheren e gjellës dhe një fanellë leshi.

— T'i kisha dhënë këto, — tha e dërrmuar shpirtërisht. — Ku ta dish sa ftohtë bën atje brenda!

Vajza e mori fanellën në dorë.

— Sa mirë punoke! — u përpoq të ndërronte bisedë.

Nëna i lëmoi shpatullat.

— Po ty të jepet të thurrësh? — pyeti.

— Më jepet. Kam thurur një për Mitron. — Tha kështu dhe u skuq e tëra. — Por jo kaq bukur sa ti.

Nëna e vështroi për herë të parë me vëmendje. Ishte e re, pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetëvjeçare. E dobët por e hijshme. Shumë e hijshme. Nëna nuk e kuptonte nga i vinte ai, nur. Nga gërshetat e trashë, nga kaçurrelat që i vareshin mbi ballë e mbi veshë, apo nga sytë që i dukeshin gjithnjë si të për-lotur? Ia mori dorën në mes pëllëmbëve të plasaritura nga soda dhe sapuni. Ia lëmoi me dashuri. Ish e butë ajo dorë. «Do të marr për nuse», mendoi. Vajza sikur ia zbuloi dëshirën dhe u bë prapë lulë-kuqe.

— Edhe ti punon për Partinë? — pyeti nëna.

Ajo uli kokën.

— Po, nënë.

— Më rruash, bij-o!

Rrugën që u kishte mbetur gjer te shtëpia e bënë në heshtje. Para se të ndaheshin, ajo iu hodh në qafë dhe e uthi.

— Nënë, këtej e tutje nuk do të lash më rroba, — i tha. — Kam porosi nga Partia. Do të gatuash gjellë për shokët dhe do t'ua shpiësh.

— Po paret?

— Do të t'i sjell unë.

Nëna u mendua.

— Jo, tha. — Paret duhen për luftën. Unë jam e fortë. Do punoj.

Dhe gjer natën vonë lante rrobat e të pasurve. I mpiheshin krahët, si të mos qenë të saj. Duart i bëheshin gjak nga soda. Po ajo nuk e ndiente lodhjen. Ishte si e dehur. Mendja i rrinte gjithnjë te djemtë. I tërë gëzimi i saj përmbli dhej në atë gjysmë ore takimi dy herë në javë. Koha tjetër mezi shtyhej. Ajo numëronte orët. Numëronte ditët. Dhe nuk ngrinte kokë nga govata. Atje, në shkumën

e sapunit i shfaqeshin të gjithë ata një e nga një. E vështronin në sy: I qeshnin. Pastaj mbylleshin në dhomë dhe nisnin nga punët e tyre. Asaj i dukej se, po të hapte derën e odës, do t'i gjente djemtë. Donte të mbetej në mendimin se i kishte atje.

Kur mbaronte punë, ulej në minder dhe i sillte ndër mend të gjitha me radhë. Te dera e burgut shkante një orë përpara. Në fillim vinte vajza me gërsheta dhe ajo gruaja me fustanin e zi gjer mbi këpucë e me shaminë e lidhur mbi vetulla. «Kush të ka vdekur?» — e pyeti një ditë nëna e Mitros. Ajo e lidhi edhe më mirë shaminë, duke mbështjellë me të të gjithë fytyrën. Vetëm sytë i mbetën jashtë.

«Më mirë pyetëm kë ke gjallë», — iu përgjigj.

«Po në burg kë ke?»

«Dritën e syve. Vajzën e vetme».

«Komuniste?»

«Si të gjithë».

Pas saj vinin prindët e Luanit. Ata përshendetnin nënën e Mitros dhe uleshin të heshtur në fron, pranë saj.

«Luani nuk u ngjan fare këtyre, — mendonte nëna. — Është shakaxhi».

Të tjerët, si ta kishin bërë me fjalë, vinin varg, kush me një bohçe, kush me një çantë a trastë në dorë. Kur hapej dera, ajo futej e para. Djemtë e vështronin që prapa hekurave.

— Erdhi nëna! — thoshin.

Ajo i njihte të gjithë me fytyrë. Edhe emrat kishte filluar t'ua mësonte: Skënderi, Mirashi, Pali, Todi, Strazimiri... Kur mungonte ndonjëri, e pikaste menjëherë:

— Po Leka ku është? — pyeste. — Po Todi?

Ata nuk ia tregonin asnjëherë të vërtetën. Nuk donin ta mërznitnin:

— U transferuan, — i thoshin.

Po sytë e tyre flisnin ndryshe. Ajo e kuptonte menjëherë dhe i dridhej zemra.

— Katilët! — thoshte. — Do ta pësojnë edhe ata.

Pastaj kërkonte Mitron. Ai rrinte pas shokëve. Ata sikur i bëheshin gardh me shpatullat e tyre. Së paku nënës ashtu i dukej.

— Bijtë e mi, mbahuni të fortë! — i porosiste.

E ndiente se pas krahëve të saj përgjonte një hije. Përgjonin ajo fytyrë e qullët, ata sy të kërcyer si sy brekose.

— Mbaroi takimi, — thërriste. — Nisuni!

Nëna nuk e shihte asnjëherë në fytyrë.

— S'është e vërtetë, — ia priste. — Unë tani sa erdha.

Të tjerët niseshin një nga një. Mbetej vetëm ajo me të birin. Gardiani në mes dhe ajo fytyrë e qullët pas krahëve, që bërtiste e ulërinte. Po nëna nuk donte t'ia dinte për thirrjet. Për të ishte një-lloj sikur ata s'ishin. Ajo shihte vetëm Mitron. Edhe ai e shihte. E shihte... Për ato sekonda jetonte, për atë minutë. Fytyra e qullët thërriste sa thërriste, pastaj e tërhiqte nga krahu... Ajo ecte me fytyrën prapa.

— Mirupafshim, nënë!

— Mirë mbeç, bir!

Pas këtyre fjalëve vinin prapë tri-katër ditët e zbrazëta të jetës së saj. Ditët që mbusheshin me punë të lodhshme dhe me mendimin se do të shihte prapë djemtë. Po orët e ditët tërhiqeshin zvarrë si njëra, tjetra.

Një natë ndjeu trokitje të lehta në derë. U ngrit dhe vrapoi atje.

— Mitrua?

Dhe nuk gjente dot rezen. Më në fund e hapi. Ata u futën njëri pas tjetrit. Vajza me gërsheta dhe katër të tjerë. Nëna i pa me radhë. Iu dukën fytyra të panjohura. Vajza iu hodh në qafë. Dridhej e tëra. Qe bërë limon në fytyrë. Nëna parandjeu diçka të keqe dhe priti.

— Mbahu e fortë, nënë! — tha njëri prej tyre.

Asaj iu mpinë gjymtyrët. I ngriu gjaku në deje. Vështrimi iu errësua. Nuk ua dallonte dot fytyrat. Vajza me gërsheta dridhej në kraharorin e saj.

— Kur? — pyeti.

— Mbrëmë. E varën në oborr të burgut vetë i tretë.

Nëna vuri dorën te fyti. Iu duk sikur nuk ishte i saj. Vështrimi i ngriu në mur. Atje qe një kornizë me fotografinë e Mitros. Vajza u ngrit dhe ia soll. Ajo e vështroi gjatë. E shtrëngoi në gji.

— Bir! — foli ngadalë. — E paç hallall gjirin që të dhashë!

Mori të çohëj. Po këmbët nuk iu urdhëruan. As duart. Si të mos qenë të sajat. U ngrit vajza me gërsheta.

— Ku e ke? — pyeti.

— Në sergjen.

Vajza vuri xhezven në zjarr. Bëri kafën. Po nënës iu zu në fyt. Nuk qe e zonja ta shkonte poshtë. I dukej sikur ia kishin shtrënguar fythin me litarë.

— Qëndro e fortë! — thanë djemtë. — Na ke ne.

Vajza mbështeti kokën në gjoksin e saj.

— Më ke mua, nënë. Unë e ai... — Nuk vazhdoi dot më gjatë.

Nëna e kuptoi se ç'donte të thoshte. I lëmoi flokët gërsheta.

— Vajza e nënës! Nusja e nënës! — përsëriste vazhdimisht. Vështrimi i kishte ngrirë në mur. Në vendin që kishte lënë zbrazur fotografia. Atje rrodhi si film tërë jeta e saj. Pastaj u ngrit e hoqi tenxheren nga zjarri.

— I gatoi nëna pulë me patate, — tha. — I kish-te vajtur mendja.

Të nesërmen kishte takim. Ajo numëronte orët. Nuk i pritej sa të vinte çasti i takimit. Sa ta shihte. Tani nuk do ta shihte kurrë! Si do të rronte pa të?!

Mëngjesi agoi i bardhë, po për nënën çdo gjë nxinte si nata. Si ajo natë. Djemtë kishin dalë para agimit, kurse ajo kishte mbetur buzë vatrës. Pranë saj ngashërehej vajza me gërsheta.

— Ngrehu, — i tha nëna afër dreke. — Ngrehu, se shkoi vonë! — Dhe rrëmbeu tenxheren ku kishte pulën me patate.

— Për ku, nënë?

— Është dita e takimit.

Ajo e humbi. «Ç'po flet nëna kështu?» Por ishte e pazonja ta kundërshtonte.

Te burgu nuk e prisnin. Nuk shkoi si çdo ditë, para të gjithëve. Njerëzit nuk guxonin ta shihnin në sy. S'dinin ç'ti thoshin. E ç'mund t'i thoshin? Si ta ngushëllonin për djalin e vetëm? Apo ajo nuk dinte ç'kishte ngjarë? Ndofta nuk kishte marrë vesh. Por jo, duhej të dinte, derisa vështrimi i kish-te ngrirë në një pikë e në fytyrë nuk i lëvizte asnjë nerv.

I shtrënguan dorën në heshtje. Ajo u ul. Priti. Kur kërcitën hekurat e derës, eci drejt saj. Prapa kabinës së xhamtë e përgjonin sytë e pështirë, fytyra

e qullët. «Ky ma ka vrrarë,» mendoj, gati t'i hidhej në fyt. Ta mbyste me ato duar.

— Ku shkoi? — e pyeti fytyra e qullët.

Nëna nuk e ktheu fare kokën.

— Te djali!

— Ti nuk ke djalë. Ta...

Ajo ia zuri fjalën në fyt:

— Djem s'kanë nënat tuaja me fëmijë gjallë, — i tha. — Unë kam gjithë këta. Ja, shikoji!

Dhe eci drejt tyre.

Djemtë kafshuan hekurat me dhëmbë. Të gjithë ndalën e mbajtën vesh. Që brenda vinte murmuri-ma e një kënge. Ishte këngë për të rënë. Për ditët që po vinin. Burgu u drodh që nga themelet prej buçimës së saj. Pastaj ra heshtja. Dëgjoheshin vetëm hapat e nënës dhe rrahja e zemrave.

— Nënë!... Nënë!...

Ajo ndali përballë tyre:

— Bijtë e mi!

— Na ke ne, nënë! — foli Luani për të gjithë.

Ajo e njohu.

— Luan, bir!

U zgjat, si të mund të prekte duart e atij, duart e Mitros, të të gjithëve.

— Mbahuni të fortë, djema! Nëna ju do trima.

Si përgjigje, që përtej hekurave shpërtheu përsëri kënga për ditët që po vinin. Mbi këngën u ngritën zërat e djemve:

— Nënë!....

Një heshtje e shkurtër. Pastaj i tërë burgu gjëmoi:

— Nënë... Nënë...

Ishte një këngë e re për nënat.

NGARKESA E DËBORËS

Sulo Motina ishte ulur pranë vatrës, ku digjej një zjarr bubulak. Grinte në heshtje duhanin dhe ndiqte me cep të syrit lëvizjet e së shoqes dhe të fëmijëve. Pas shumë javësh, e shoqja e pa të udhës të hiqte nga muri sofranin, ta pas-tronte me kujdes e ta shtronte buzë vatrës që të hanin edhe ata si njerëz.

Te cepi i vatrës misërnikja nxirrte avuj të ngrohtë, duke e mbushur kuzhinën me një kundërmim të këndshëm. Të vegjëlve nuk u durohej. Rëndnin mbi shtrojën prej balte të kuzhinës, cimbisnin kërcet e ëmbla si mjalti dhe i përtypnin plot shije.

— Prisni dhe ca, or të uruar, se misërnikja e ngrohtë nuk ka duk! — u thoshte e ëma dhe matej t'u binte duarve, po ndërronte mendje. «S'kanë faj, — mendonte. — Janë të unshëm. Kaq ditë pa

parë bukë me sy!» Ata e thyenin urinë me çorbë lakrash të egra, po ku të mbanin ato! I ati bëri si bëri dhe i siguroi dy grushte misër. Po ç'gëzim solli në shtëpi ajo misërnike! Tani grinte duhan dhe shihte i kënaqur si çukitnin fëmijët koret e koret. «Le të çukitin dhe sot e nesër, — thoshte. — Gjer pasnesër shohim e bëjmë.»

Kur sofrja u bë gati, fëmijët u sulën drejt saj duke shtyrë shoku-shokun, kush e kush të zinte vend pranë babait. Po nuk arritën të uleshin. Në derë u dëgjuan trokitje. Ata vështruan njëri-tjetrin, po zë nuk nxorën. Trokitjet u përsëritën më të forta.

— A pranon miq, o i zoti i shtëpisë?

«Metja ky!»

— Hajde, bujrrëm, o Mete kryetari!

Në gjysmerrësirën e kuzhinës u futën tre veta të armatosur dhe Mete kryetari katër.

— Vdekje fashizmit, shokë! — tha i pari, me shtatin gjer te trarët dhe ngriti grushtin.

— Liri popullit, vëllezër!

U duk sikur nga kjo përshëndetje shtëpia mori më shumë dritë. Sulo Motina i pa më qartë ata që qëndronin pas të parit. I dyti, me një palë mustaqe të holla e mollëzat e faqeve pak të kërcyera, mbante një mitraloz pranë këmbës. I treti vinte më i ri e më i pakët nga trupi. Vështrimi i tyre rrëshqiti shpejt e shpejt nëpër dhomë. Në qoshe — një hasër e mbledhur për miqtë, një stivë dru, një kusi e varur në oxhak, mbi të gjitha, sofrja e shtruar. Misërnikja nxirte ende avuj.

— Ju dashkan vjehrrat, — tha i zoti i shtëpisë dhe i ftoi të uleshin.

— Vjehrrat tona akoma nuk kanë lindur, — ia

ktheu ai me mustaqe. U mbështet mbi mitraloz e u ul pranë vatrës. Duart iu përcëlluan në flakë.

— Ja, këtij i thonë zjarr, or tungjatjeta! — foli prapë ai i mitralozit. Vetëm atëherë u kujtua për fëmijët, që nuk ia ndanin sytë. I shtypi hundën vogëlushit që kish më pranë dhe e pyeti duke buzëqeshur:

— Do dalësh partizan ti?

— Do dal, — iu përgjigj vogëlushi në çast. Pastaj shtoi si i dëshpëruar: — Po... nuk më lë babai.

— Mos është gjë me Ballin yt atë?

— Jooo, — kërceu fëmija vetullrrudhur. Jemi me Partinë të gjithë ne. Edhe xhaxhanë në mal e kemi.

— Si e quajnë?

— Petrit Motina.

— Ua, po ai është komisar! Xhaxhai yt qenka!?

Po pse nuk thua, or trim, që paske një xhaxha me halle! Kemi luftuar tok ne. Pa ia kemi marrë edhe këngës, që thua ti.

Partizani me mustaqe tregoi si ishte njohur me Petrit Motinën në Drashovicë, si i kishin bërë kërmë fashistët e si kishin ngritur të dy bashkë një këngë. Dhe ia mori asaj sakaq:

*Te ura, moj, te ura,
te ura në Drashovicë...*

I zoti i shtëpisë ia ktheu, të tjerët i mbajtën iso. Kënga vajti zile.

— Ju lumtë goja, vëllezër! Tani afrohuni të hamë një kafshatë, — i ftoi Suloja.

Nisën të përtyפשhin në heshtje. Vetëm mitra-

ljeri me mustaqe nuk pushonte së treguari për komisarin dhe për Drashovicën tek ura.

— Të ëmbël mjaltë e ke bukën, or i zoti i shtëpisë, — tha ai që ishte ftuar i pari.

— Edhe gojën të ëmbël e ke, or vëllai i komisarit, — tha mitraljeri.

— Po gjumin si do ta kesh, vallë? — pyeti i treti.

— Për shtatë palë qejfe, or byrazer, — iu përgjigj i zoti i shtëpisë, duke i hedhur zjarrit një krah shkarpa të thata.

Gjuhët e flakës u ngritën lart dhe një tufë shkëndijash u vërsulën përpjetë oxhakut. Po partizanët nuk i panë. I mundi gjumi.

«Janë lodhur», mendoi Sulo Motina. Fëmijët dhe e shoqja dolën pa zhurmë, kurse vetë Suloja u shtri pak më tej, po gjumë nuk kishte. Vështroi me radhë partizanët. «A u ngopën vallë? — pyeti veten. Dhe iu kujtua Petriti. — Po ai ku e gdhin këtë natë? A e ka shuar urinë?» I sëmbonte në zemër për të. E kishte jo vetëm vëlla, po dhe si fëmijë. Babai ia la në djep dhe ai e rriti vetë. «U bë burrë, — tha. — Më la në bisht».

Partizanët flinin si qengja. Pas shtatë — tetë orësh do të zgjoheshin. Do të uleshin prapë rreth vatrës. I doli para syve sofa. Sofra e zbratur. Ata. Dhe përsëri Petriti. A e kishte shuar vallë urinë!

E ngriti vendi. Shkoi në dhomën ngjitur, ku flinin fëmijët. E tundi gruan nga supi.

— Po shkoj, — i tha.

— Ku?

— Për një kafshatë.

— Ajo fërkoj sytë.

— Kot e ke. Kafshata s'gjendet ditën e jo natën.

— Do ta gjej, — ia preu ai i vendosur.

— Mirë.

Sulo Motina i hodhi samarin mushkës, i vuri një dorë bar ziles që të mos zgjonte fshatin dhe u nis. Hënë s'kishte, po ai e dinte rrugën. Edhe mushka e dinte. Ajo rrëmbente një guç bar anash rrugës dhe e përtypte, Suloja përtypte mendimet. Po t'i shkonte mbarë, me mesnatën bashkë do të arrinte te lerat. Atje ishin gropat e thella rrëzë shkëmbinjve, të cilat suferina e malit i mbushte me dëborë. Verës, kur vendi përgjerohej për një pikë ujë, barinj të e nxirrnin dëborën në diell dhe shuanin me të etjen e tufës. Nga ajo dëborë Suloja nxirrte dy kallëpë të mëdhenj dhe i shpinte poshtë, në qytet. Tek ai...

Ata ecnin. Pylli i shoqëronte me cicërima, fëshfërima e frushullima. Pemët i pëshpëritnin njëra-tjetrës një ligjëratë të pambaruar, që të ndilte mendime. Pa niste ai të kuvëndonte me gruan, me fëmijët, me Petritin dhe me mushkën:

«Përse ropatesh kështu, o njëri?» — i thoshte Lena. «Po ja, moj, për këta, për ty.»

Ajo e vështronte gjatë në sy dhe sikur i thoshte: «Të thërresin shokët, o Sulo!» Ai mbante vesh. Vërtet sikur e thërrisnin. Dhe i shfaqej para syve Petriti.

«Hajde me ne, o Sulo!» — i thoshte. Ai shkurtoi hapin, si të donte ta dëgjonte më mirë zërin e tij.

Pylli mernte frymë thellë. Diku afër rrahu krahet gjeli i egër. Mushka turfulloi. Sulo Motina kërkoi fillin e bisedës me të vëllanë.

«Hajde!» — e ftoi prapë ai.

«Po fëmijët?»

«Rriten ata, rriten. Kanë Lenën. Pastaj edhe fshati s'i lë.»

«Fshati, thotë! E ku e lënë këmborët e tij fshatin të dëgjojë zilet e mia!»

«Kanë ndryshuar kohët, Sulo vëllai. Nuk është më si përpara.»

Vërtet, kohët kishin ndryshuar. Ja, kush ua lëroi tokën Mukajve? Kush ua hodhi drutë e dimrit Bardhajve? Kush ua ndërtoi shtëpinë Dukajve, kur ua dogji Italia? Fshati. Dhe në sa ditë pa? Brenda javës, si të mos ish djegur kurrë.

«Po, o Titi, kanë ndryshuar», — e ngau fjalën ai.

«Atëherë ç'pret?! Rrëmbe dyfekun dhe hajde!»

«Ja, sa të fus dhe ata dy duaj brenda dhe do të vij, o Titi, që, kur të më shohësh, të fërkosh sytë. «Sulua është ky!» — të thuash. Po, or, po, Sulua. Pse, ç'pandehe ti, se do të ndahej Sulua nga shokët?» Potkonjtë e mushkës shkrepninë në gurët e strallit. Po u afroreshin lerave.

— Deee! — tha Suloja e goditi mushkën fort pa e pasur mendjen. Ajo rënkoi. «Pse më qëllon», sikur u ankua. Ai e fërkoi atje ku e kish goditur.

— Më fal! — i tha.

«Lëre, ç'mushkë është kjo, o Titi! Po ku ke haber nga mushka ti! Të është bërë mendja gjerman. Do ta bluajmë edhe atë me gjithë kocka thua. Në mokrën e revolucionit do ta bluajmë thua! Eh, më të kulloftë goja mjaltë!»

— Ya! — thirri Suloja. Mushka shpejtoi hapin. Tej nxinin lërat. «Arritëm», — tha Suloja. Po mendja i mbeti te mokrat. Ku ta dish ç'mokër e madhe do ish ajo, gjersa mund t'i bluante të gjithë gjermanët! Po Petriti e kishte parë, vallë? Doemos që e kishte parë. E ku i shpëtonte gjë Petritit! Apo s'kishte mësuar ca fjalë, që e hutonin fare Sulon! Revolu-

cion, thoshte. Reformë. Pastaj dhe ajo fjala tjetër. Ce-ce-celulë. Celula është shtëpia jonë, i tha një ditë Petriti. Shtëpia e komunistëve. Djall, o Titi. U bëre me dy shtëpi. Edhe komisar u bëre. Kush e pandehte këtë! Kush e pandehte!...

Mushka qëndroi. Ndali dhe Suloja. «Lerat», — tha dhe, si hoqi lopatën e mushamanë, mori një grusht dëborë e fërkoj fytyrën. Një afsh i ngrohtë e pushtoi. Vështrimi i rrëshqiti mbi qiellin blu të thellë, si një kadife, ku digjnin yjet. Ai kërkoi Yllin e Mëngjesit.

«O burra!» — thirri dhe rrëmbeu lopatën. Shënoi mbi dëborë një katrore të madhe sa mezi mund ta pushtonin krahët e një njeriu dhe rëndoi me tërë peshën e trupit mbi lopatë. Dëborë që e ngjeshur dhe e fortë. Po Suloja nuk donte t'ia dinte. E preu nga të katër anët, shkoi lopatën nën të dhe e tërhoqi me kujdes, që të mos çahet. Kallëpi u shkël. Ai e mbështolli mirë e mirë me mushama dhe iu vërsul të dytit. Lopata dukej si një lodër në krahët e tij si degë lisi. Po t'i ecte mbarë, do të kthehej në shtëpi bashkë me rrezet e diellit. Do ta vinte bukën e grurit mbi sofër. «Tani bujrim, vëllezër e t'ju bëjë mirë!» — do t'u thoshte. Ata do të hanin e do të shkonin. As që do ta merrnin me mend se sa ishte lodhur i zoti i shtëpisë për atë kafshatë. Dhe ndofta nuk do të shiheshin më kurrë. Suloja qeshi i kënaqur. «I kam në vend të Petritit», — tha.

— Tani afrohu! — i foli mushkës. Ngarkoi kallëpet e dëborës dhe u nis. Rrugën gjer poshtë, në qytet, e bëri duke sjellë në mend Mane Gërshërën. U grind e u thër me të.

Iu kujtua nata e parë kur e bëri atë rrugë. Korrrik që dhe atëherë, si tani. Kohë e thatë për ibret.

U dogj misri në gjethe. Fëmijët i bloi uria. Sulo Motina pa ç'pa dhe i trokiti Mane Gërshërës në derë. Sa më shumë i qe afruar dyqanit të tij, aq më tepër i ishin prerë gjunjët. «Më mirë në thonjtë e ujkut, se në dorë të Manes!» kishte menduar. Po burimet e tjera qenë shterur.

Mânia qenkësh shtruar e po hante. Bëri sikur nuk e vuri re.

«Po më vdesin fëmijët urie», — tha Suloja.

Tjetri vazhdoi të përtypej.

«Jo, more! — foli pas pak duke gogësitur. — Përse i bëre, gjersa nuk je i zoti t'i rritësh?

Sulon e shpuan si thikë ato fjalë. Helm i derdhën në damarë. Mori të ikte. Po tregtari nuk e la zogun t'i shpëtonte nga dora.

«Mos merr zjarr, se bëra shaka! — u përpoq ta qetësonte. — Ne jemi nga një vend. Tëndi mishin ta ha, po kockën ta ruan.»

Suloja u kthye me dy mendje.

«Ç'kërkon nga unë?» — e pyeti tregtari.

«Dy karroqe misër.»

«T'i jap, — premtoi tregtari. — Më dhimbsen ata çiliminjtë e tu të shkretë. Po ti si do të ma shpërblesh? Para s'ke.»

«S'kam, — përsëriti Suloja.

Mane Gërshëra vështroi arkat me birrë e arançata, që i qenë bërë stivë në qoshe të dyqanit. «Tërë kjo vapë dhe s'hiqen, — mendoi. — Akulli s'gjen-det këtej nga ne. Të kisha ca dëborë», dhe e hodhi vështrimin nga mali.

«Bukën e ke atje!» — i tha Sulos.

«Në mal?» — Dhe Suloja u përpoq ta zbulonte përse kishte nevojë tregtari, për çaj, për pelin, apo për dru?

«Jo, — ia priti ai. — Ato i kam të gjitha. Nga ti dua... dëborë.»

«Dëborë?! — E vështroi se mos donte të tallej. — E ku ka dëborë tani?!»

Tregtari vazhdonte të përtypej. Suloja vriste mendjen.

«Mirë, e zëmë se ka, — tha. — Si ta sjell gjer këtu?»

Mania qeshi me djallëzi:

«Natën, — tha. — Po ia hodhe diellit, fitove bukën. Po të mbërtheu rrugës e ta çkriu, të rruat mundimi!».

Këtë radhë Suloja u mendua gjatë. Vështroi malin, pastaj tregtarin dhe përsëri malin.

«Tri orë t'i ngjitem, dy t'i zbres, bëjnë pesë, — mendoj. — Për pesë orë mbaroj punë». Dhe doli pa e përshëndetur.

Mane Gërshëra fërkoi duart.

«Do të ma sjellë», — tha.

Të nesërmen pa gdhirë mushka e Sulo Motinit qëndroi para dyqanit. Kalimtarët u grumbulluan në çast dhe vështronin ngarkesën e çuditshme. U mblodhën edhe bakejtë e qytetit dhe rrudhën supet.

«Përse të duhet kjo?» — e pyetën.

Mania nuk u përgjigj. Fërkoi vetëm duart.

«Ehu, sa ka zanati! — thoshte vështrimi i tij lakmitar. — Tregtinë shumë e shohin po pak e njohin.»

Kur dielli i korrikut zuri të piqte si saç, Mane Gërshëra vari një tabelë para dyqanit:

«Kemi birra dhe arançata të ftohura në dëborën e Nemërçkës!»

Dhe kryqëzoi duart prapa banakut e priti. Të parët arritën bakejtë. Pastaj dyqani u mbush, sa s'kishte ku të hidhje mollën.

«Iku, more, iku!» — thërriste Mania, pa ua hedhur fare sytë bakejve të hutuar.

Pas një ore çdo gjë ra në qetësi; në dyqan qëndronin vetëm dy veta ballë njëri-tjetrit: Mane Gërshëra dhe Sulo Motina.

«Kësaj i thonë tregti, vëllaçko», — thoshte Mania, duke vështruar shishet e boshatisura në qoshe të dyqanit. I futi ato një e nga një në arka. Pastaj mori nga arka dy monedha dhe ia zgjati Sulos:

«Merri, se i ke hallall!»

Suloja i vështroi i habitur:

«Kaq pak!»

«Në daç. Në mos, po lëri! Nuk më hanë xhepin mua.»

Kështu i thoshte ngahera. Kështu edhe atë mëngjes. Sulo Motina nuk e bëri të gjatë. E dinte se në fshat e prisnin.

«A do t'i arrij dot vallë?» — dhe vrapoi te bukëpjekësi në fund të rrugicës. Ai i afroi lekët te sytë dhe i vështroi me kujdes.

— Ehe, ma hodhi njëri pardje, — tha. — Më dha pare fallco nga të Mane Gërshërës.

Kur u sigurua se paret ishin të rregullta, i zgjati Sulos një bukë e gjysmë.

— Herë tjetër më ke dhënë dy, — kundërshtoi ai.

Tregtari hodhi dorën mbi bukë:

— Ehe, herë tjetër po, por sot jo, — qeshi ai me shpoti. — Është luftë tani, or mik vëllai, dhe punët ndryshojnë me orë, e jo me ditë.

Sulo Motina e mbështolli bukën që të mos i ftohej dhe u nis. Rrugët e qytetit i kaloi si erë. Te postëblloku e ndalën.

— Për ku? — e pyeti një ballist, duke i vënë bajonetën në gjoks.

— Për në shtëpi.

Ballisti e kontrolloi me kujdes në trup; pastaj i vajtën sytë te sendi i mbështjellë:

— Ç'ke atje, komunikata?

— Bukë, — u përgjigj Sulo Motina dhe bëri të nisej. Por ballisti i preu rrugën me presën e bajonetës.

— Do t'ua shpiesh partizanëve, hë? pizeveng! — e shau dhe ia nguli bajonetën në bukë. — Oho, qenka e ngrohtë valë! — dhe filloi të hante. Suloja desh iu hodh në grykë, por atë çast nga postëblloku dolën dy të tjerë të armatosur, me zhgaba në qeleshe.

— Më jepni bukën! — thirri Suloja.

— Njëri nga ata, ai me një vërgan bombash nën kollanin e fishekëve e copëtoi bukën dhe ia zgjati mushkës.

— Gjynah, — tha. — Ka uri e gjora.

Mushka u përtyp. Sulos iu errën sytë.

Zgjati dorën t'ia merrte. Por njëri nga ballistët i vuri tytën e automatikut në gjoks dhe e shtyu me forcë:

— Zhduku! — ulëriu. — Komunist i qelbur!

Suloja mezi e kapërdiu atë lëmsh që iu mblodh në fyt.

— Të qelbur jeni ju, — tha dhe eci, pa e kthyer kokën prapa.

Duarthatë mezi çapitej. Në gjoks iu mblodh një mal me urrejtje. Përpara ngrihej madhështor Nemërçka. Mali sikur e ftonte me heshtjen e tij. Suloja u përpoq të dallonte shkëmbinjtë dhe lerat. Ato iu panë si zgavra. Vështrimi u largua nga ato dhe ndali mbi fshat. Në mes shtëpive kërkoi kasollen

e tij, po në vend të saj iu shfaq sofrë e zbrazët. Ajo nisi t'i vërtitej e t'i vërtitej. Që prapa vinte e qeshura e ballistëve. «T'u isha hedhur, — mendoi. — Së paku njërin do ta kisha mbytur».

Rruga iu zgjat litar. Kur arriti në shtëpi, dielli ishte ngritur dy hostenë. E rrethuan gruaja e fëmijët dhe nisën të kërkonin me padurim nëpër mushama. Si s'gjetën gjë, u tërhoqën syprush.

— Ma morën larot e Ballit! — tha Suloja.

— Lenën e goditi në gjoks hidhërimi i syve të tij.

— Na marçin të këqijat! — ia ktheu.

Duart e ashpra të Sulos përkëdhelën fëmijët.

— Shkuan? — pyeti.

— Shkuan, s'kanë shumë.

Nisi të ecte nëpër oborr. Çdo hap i sillte në veshë një krismë. «Luftë, — mendoi. — Bëhet luftë! Dhe shkoi brenda. Mori pushkën e kollanin. Në kokë ngjeshi festën me yllin e kuq që ia kishte qëndisur Lena.

— Po shkoj, — tha.

Ajo mbështeti kokën në gjoksin e tij të ngrohtë prej burri.

— Ec, — ia ktheu. — Mos ki dert për ne!

Fjalët i përpiu gjëmimi i luftës.

QO mundet të kthehet në një nga dy gjendje të ndryshme: në gjendjen e hapur dhe në gjendjen e mbyllur. Në gjendjen e hapur, kontakti i kontaktit është i hapur dhe kontakti është i mbyllur. Në gjendjen e mbyllur, kontakti i kontaktit është i mbyllur dhe kontakti është i hapur.

QO mundet të kthehet në një nga dy gjendje të ndryshme: në gjendjen e hapur dhe në gjendjen e mbyllur. Në gjendjen e hapur, kontakti i kontaktit është i hapur dhe kontakti është i mbyllur. Në gjendjen e mbyllur, kontakti i kontaktit është i mbyllur dhe kontakti është i hapur.

Ajo pas kësaj të bëhet e qartë se e njëjta gjendje mund të jetë e hapur ose e mbyllur. Në gjendjen e hapur, kontakti i kontaktit është i hapur dhe kontakti është i mbyllur. Në gjendjen e mbyllur, kontakti i kontaktit është i mbyllur dhe kontakti është i hapur.

BISEDE PËR QARKULLIMIN

QO mundet të kthehet në një nga dy gjendje të ndryshme: në gjendjen e hapur dhe në gjendjen e mbyllur. Në gjendjen e hapur, kontakti i kontaktit është i hapur dhe kontakti është i mbyllur. Në gjendjen e mbyllur, kontakti i kontaktit është i mbyllur dhe kontakti është i hapur.

Kur mbeti vetëm, i hodhi çelësin derës dhe mbështeti shpatullat mbi të. Vështrimi i rrëshqiti së pari mbi tavolinën e punës, ku dukej një komplet boje dhe një kalendar. Në të majtë ishte shtrati, garderoba dhe në fund soba. Ajo skuqte nga zjarri dhe shpërndante në dhomë një ngrohtësi të këndshme.

«Ja, pra kjo është e tëra; — mendoj. — Në këtë dhomë do të kaloj disa muaj. Ndofta një vit. — Qeshi pa arsye. — Në fillim sesi m'u duk. Po nuk paska qenë aq e tmerrshme»

U mbështet në shtrat. Transistori përhapte tinguj të lehtë. Ishte një melodi për gjeologët, që atij i pëlqente shumë. Por atë cast iu duk e tapert. Donte të ishte vetëm. Të kujtonte gruan, fëmijët. Dhe dhoma u mbush sakaq me zërat e tyre. Djali dhe

vajza iu hodhën në qafë e gati i zunë frymën. Oli e vështronte në një mënyrë të çuditshme. Ç'kuptim kishte ai vështrim dhe ç'shprenje: mall, dashuri, apo qortim? Sado që u përpoq, nuk mundi ta përcaktonte me saktësi këtë. Humbi në mendime.

Lajmi i qarkullimit i ra si bombë Olit. Gjer atë çast ishin aq të qetë, aq të gëzuar. Qenë rregulluar si s'ka më mirë me shtëpi, me punë, me shkolla e me çerdhe për fëmijët. Po befas gjithçka u përmbys. Olit iu duk sikur do t'i humbisnin përgjithnjë gëzimin, dashurinë.

Ajo: Pse heshte? Ti ke njëzet e ca vjet shërbim në ushtri. Edhe me shëndet nuk je aq mirë. Mund të dilje në pension. Ca ti dhe ca unë, do të rregulloheshim. Tani puthu me Tiranën!

Ai: Po ti e di, Oli, se unë kisha dhënë fjalën. «Jam gati të shkoj ku të jetë nevoja!» — kisha thënë. Veç kësaj, ne nuk e kemi marrë me tapi Tiranën. Si ti, si unë, në fshat kemi lindur.

Ajo: Ja që erdhëm këtu. Tani si thua, të bëhemi prapë fshatarë?

Ai: Ne nuk po shkojmë në fshat, megjithëse po ta donte puna edhe atje mund të shkonim. Ne po shkojmë në Berat.

Ajo: Si fshati, Berati, për mua njëlloj janë.

Dhe u lëshua mbi krevat. Ai e la një copë herë. Pastaj iu afrua. I lëmoi shpatullat, flokët.

— Ti je e mrekullueshme, Oli, — i tha te veshi. — Unë krenohem me ty. Bëhu më e arsyeshme!

Gjyko me gjakftohtësi!

Olit i shndritën sytë. Pas asaj dite, nuk ia zuri më në gojë qarkullimin. Atë ditë që do të niseshin sytë i kishte më të butë e më të qetë se kurdoherë. Vetëm qështe pa kuptim.

«Dëgjo, — i tha kur po ndaheshin. Kërko mënjëherë shtëpi! Mos ki hall për mua! Punoj ku të jetë. Doradorës kemi rrogën tënde».

Seç donte të shtonte tjetër, po treni u nis.

«Ç'donte të më thoshte, vallë?» Vështroi tej dritares, po imazhi i saj qe zhdukur. Në vend të përgjigjes, trokitën në derë. Iu duk sikur gërricte një mace, me thonj. Ai e hapi. Nga gjysmerrësira e shikonin dy sy, hetues.

— Ah, qenkeni ju, shoku Nasi? — pyeti të porsardhurin.

— Po, mik i dashur. Shkova në shtëpi dhe e shtrova me kalamajtë. Por, s'di pse m'u kujtuat ju. «Po shoku Loni?» — thashë. Dhe ja erdha.

Loni e ftoi me mëdyshje. Nuk qe puna se donte të rrinte dhe ca vetëm të lexonte gazetën e të dëgjonte radion. Nuk ishte vetëm kjo. I dukej se tek ai person shihte diçka të veçantë, që të shtynte ta largojë e jo ta afroje.

Ai u ul pranë tavolinës dhe foli me zë teatral:

— Ku je, o jetë misterioze, prej beqari! — dhe iu afrua krevatit, ngriti batanijet. Çeli dhe komodinën, garderobën.

— Mirë, — tha. — S'ka më mirë. Dhe tani, mik i dashur, ngrehu!

Lonit iu bë se në zërin e tij kishte një çiltërsi të shtirur:

— Për ku?

— Po ja andej, nga shtëpia ime. Kalojmë disa orë pranë televizorit.

Loni u mendua.

Të falënderit! — i tha. — Por jam ca i lodhur. Një herë tjetër.

— Si të doni. — Nasi hapi çantën, nxori një copë

sallam, pak djathë, disa qepë e hudhra të njoma, një shishë raki dhe dy gota. E tundi shishen në ajër.

Ku je, o raki, antibiotik i mirë i melankolisë!
— foli me po atë zë teatral.

Loni shikoi shishen.

— Të falemnderit, po nuk e kam për zemër,
— tha.

— Do ta kesh, mik i dashur, do ta kesh. Jā, sa të shijosh të parën, — ia ktheu Nasi dhe i mbushi gotat për buzë. — Shëndeti juaj, shoku Loni! Uroj që t'ju duken të shkurtër ditët në këtë qytet të meritshëm.

Për një kohë ata gjerbën në heshtje rakinë e zier nga rrush i pjekur moskat, që ta zbuste kraharorin me afshin e saj aromatik. Një raki për merak, meze jo aq të këqija, pak muzikë dhe mbi të gjitha diçka që nuk shkonte.

— Me fund!

Loni nuk ia prishi.

— Tani ma bëre qejfin. — Nasit i qeshën sytë. I mbushi prapë gotat për buzë. — Nuk më thua, i dashur, cili ishte ai mik që të hodhi këtej?

Si nuk mori përgjigje, Nasi ndërroi bisedë. Nisi t'ia përshkruante një për një shokët e shtabit, që nga sekretari i komitetit, deri tek ushtari i shërbimit, duke e këshilluar me kë të shoqërohej e nga kush të ruhej. Loni nuk i vinte vesh. Ndiqte me vëmendje radiopostën.

— Është koha të pimë pak, — i tha Nasi pas pak dhe i hodhi një vështrim dhomës nga kreu në fund.

— Nuk më thua sa vjetër parashikon të ngryseth në këtë kuvli?

— Ndofta një, apo —

— Si?! Këq shpejt do të na lësh shëndenë? Keni miq ju, or vëlla.

— Unë nuk thashë se do të shkoj.

— Mos do të marrësh familjen?

— Doemos.

Nasi i afroi karrigen. I hodhi të dyja duart në supë dhe e tundi lehtë. Në lëvizjet e tij, në fjalët, në shprehjen e fytyrës, Loni vuri re diçka që nuk përkonte me mendimet.

— Gabim!

Nasi tundi në ajër gishtin tregues, si të kërcënonte dikë. — Një gabim i pakorrrigjueshëm, mik i dashur. Fatal, do të thosha. — Iu afrova të veshi e i pëshpëriti ngadalë:

— Ti mos dil hapur! Do t'i marr thënjë! Ja, sa të gjej shtëpi e punë për gruan. Kështu bëjnë të mëncmit, mik i dashur.

Loni ia priti:

— Para se gjithash, mëndoj se ende nuk jemi bërë miq.

Po Nasi as që e vuri re nervozizmin e tij. Dukej që kishte ardhur në qejf.

— E drejtë, — tha, — shumë e drejtë. Po përse të mos e provojmë? Ja, unë e parandiej se shumë shpejt do të miqësohemi. Pastaj, ne nuk po njihemi sot për herë të parë, por kemi një jetë të tërë.

— Sa për mua...

— Mos u ngut, i dashur! Më mirë le t'ia lëmë kohës këtë dhe të shijojmë ca nga të mirat e kësaj bote! Hajt! — foli duke i treguar rakinë. Kur përfunduan emisionet e radios, Nasi u ngrit.

— Natën e mirë dhe të mirë u pafshim nesër!

Të nesërmen Loni u përpoq t'i shmangej takimit. Për disa orë lexoi protokollat e shtabit, duke u

përpjekur të njihej me gjendjen në njësi. Po kur doli, Nasin e ndeshi në korridor.

— Për ku, mik i dashur?

— Dola njëherë ashtu kot, — iu përgjigj Loni.

— Vërtet!? Aq mirë. Shëtisim bashkë! — Tha kë-shtu dhe i hodhi krahun.

Një copë herë u çapitën në heshtje. Kishte ni-sur, të frynte një erë e lehtë. Mbi rrugën e gjerë para ndërtesës së shtabit, të rrethuar nga të dyja anët me parulla të shkruara bukur, vërtiteshin gje-thet e zverdhura të plepit. Ato të ndillnin mëzri.

— Pra, — e prishi heshtjen Nasi, — do të rrini një kohë edhe me ne. Epo, çka! Po, nuk më thua, me ç'detyrë, mik i dashur?

Loni ngriti supet.

— Ti e di, atë e vendos komiteti.

— Domethënë, ndërroni nomenklaturë? Në mos gabohem, nja dy kategori më poshtë, hë? — Nxori një fishkëllimë të zgjatur. — Thashë unë!

— Çfarë thatë?

— Jo, asgjë. Po, as sektorin nuk ta treguan?

— Në prapavijë, e ku tjetër!

Lonit iu duk sikur hapat e tyre merrnin një kumbim të çuditshëm nga asfalti. Ata ia shtonin nervozizmin.

— Mos ju gënjen gjë mendja se do t'ju cak-tojnë në shtab? — foli Nasi, si ecën edhe ca në hesh-tje. — Ne, edhe pa ju, nuk jemi pak. Flitet se do të bjerë gërsëra.

Loni e ndjeu se nuk do të mund të heshtte më.

— Dëgjoni, «mik i dashur»! — i tha duke u për-pjekur ta imitonte në zë. — Ju po më dukeni një bu-rokrat tipik.

Nasi buzëqeshi hidhur.

— Vërtet thua? — Ju folá hápur? — Nasinuk u mundua t'i zgjidhte më fjalët si më parë. Nuk thá më, me vend é pá vend, «mik i dashur». Toni i tij u bë i vrazhdë dhe buzëqeshja tallëse.

Loni mendoi se kjo sjellje i shkonte më mirë. I ktheu krahët dhe eci drejt zyrave. «Ç'njeri!» — mërmëriti.

Atë ditë Loni dë të merrte për herë të parë shërbimin, ndaj u përpoq ta harronte atë që ndodhi. Duhej të ishte i qetë. Në orën e caktuar u paraqit në zyrën e oficerit të rojës. Ishte një dhomë plót dritë në hyrje të shtabit. Ai shfletoi rregulloren dhe nisi të lexonte, po telefonat nuk e lanë. Sa hidhte një shënim në regjistër, binte përsëri zilja. Diku një ushtar ishte hedhur në mes të flakëve, për të shpëtuar pronën e përbashkët e kooperativistët lufteshin që të falënderohej para efektivit. Në një repart tjetër kërkohet me ngut mjeku.

Si kreu shërbimet e nevojshme, nisi të lexonte përsëri rregulloren. Po zilja e telefonit prapë ushtoi.

— Ju flasim nga «Roja e ajrit». Kishim më leje një ushtar, duhej të kthehej mbrëmë, por ende nuk po duket.

Loni shënoi të dhënat në regjistër dhe uli reëptorin. «Roja e ajrit!» Emër i bukur!

Thua jse e harroi bisedën me Nasin. Gjer në mbrëmje zilja e telefonit ra disa herë. Ai hodhi në regjistër njoftime të tjera, por mekanikisht. Mendja i punonte gjithnjë tek «Roja e ajrit». U ul e shkroi një lutje për komitetin e partisë. Afër mesnate vendosi të shtrihej e të merrte një sy gjumë.

Ngriti batanijet dhe shikoi çarçafët. Ata binin erë sapun. Befas pyeti veten: Sa veta ishin mbuluar mëta? Dhjetëra? Jo, qindra, ndofta dhe mijëra. U mbështoll me ta dhe atëherë provoi një ndjenjë të guditshme. Në fillim iu kujtuan mësha e re, aksionet e rinisë, hekurudhat. Pastaj në përfytyrimin e tij dhoma e oficerit të rojës mori përmasa fantastike. Loni iu duk sikur u dyndën aty të gjithë ata që kishin kryer shërbim në atë dhomë, që kishin mbajtur në vesh kufjet e telefonit, që ishin ngritur natën për të kontrolluar rojat, që kishin ndier shqetësimet e shërbimit dhe kishin dremitur si ai, pa u zhveshur, nën ata çarçafë; nën ato batanije. Dëgjoji zërat e tyre, ndjeu erën e djersës së derdhur transheve e poligoneve dhe nuk mundi të mbyllte sy gjer në mëngjes.

Por edhe Nasi nuk bëri gjumë të mirë atë natë. Sa mbyllte sytë, hovte i trembur. I bëhej sikur që mbledhur organizata për të shqyrtuar karakteristikën e tij. Ai çapitej korridorit. Ishte një korridor të përgjatë, që niste aty dhe zgjaste gjer thellë në hënë e majë. Ndërsa ecte, majtas e djathtas kërcitnin brava, dëgjoheshin zëra: «I gjori Nasi, do të qarkullojë!» Mbajti hapin të dëgjonte më mirë. «Do të qarkullojë!» — përsëriti një zë i dytë. Pastaj gjëmoi i tërë korridori: «Do të qarkullojë... do të qarkullojë!»

Ai zuri veshet me duar dhe shpejtoi drejt zyrës, po ëëra që e mbyllur. Trokiti në zyrën e shefit. Priti, por nuk mori përgjigje. Trokiti përsëri. Nga brenda sikur e qesëndiste një zë. Atëherë i vuri shpallullat derës e shtyu më të gjithë forcën. Kur e hapi, shtangu: «Loni?!»

S'mbylli më sy. «Dalim nganjëherë ëndrrat, da-

lin, — mendoi. — Ja, atëherë kur më vdiq gjyshja... Sikur i kishim pak hallet tona, na edhe ky Loni tani! Kush e kishte në defter!

Kur arriti në korridorin e shtabit, iu duk se do të ndiente kërcitjen e bravave dhe zërat. Shpejtoi hapin, u fut në zyrën e tij dhe qëndroi gjatë me vështrimin e ngulur mbi dosje. Ato qenë plot shkresa, grafikë e shënime që kërkonin përgjigje. Po ai ishte si i mpirë. Nuk i bëhej për asgjë. «Sa të vështrira janë këto qarkullimet», — mendoi. — Nganjëherë digjet i njërit me të thatin bashkë».

Duhej të dilte së keqes përpara. Ta peshonte mirë çdo gjë dhe, sidomos të mos humbiste kohë. Para së gjithash, të mendonte diçka për Lonin. Të merrte vesh si qëndronte puna e tij. Se, doemos, e kishte një klëçkë, derisa e qarkulluan. Kush të luan kot së koti nga ministria!

Po si ta zbulonte këtë? Ndofta mund të mësonte diçka nga shoku i qendrës që kish ardhur me shërbim. E gjeti pranë zyrave. Pinë së bashku një kafe.

— I gjori Loni, — tha kur dolën. — Shok i mirë, po ç'e do...

— Përse thoni kështu? — e pyeti shoku i ministrisë.

— Si përse!? Po ja, bre, kot nuk e sollën këtu, de! Tjetri e pa ngultas dhe mblodhi supet.

— Kish vjet në ministri dhe qarkulloi, — tha. — Si të gjithë. — shtoi.

Nasi u përpoq të qeshte.

— Qarkulloi! — përsëriti. — Pse, vetëm ai ishte për qarkullim? — Ja, jeni edhe ju. Po ju... E zgjati zërin, — jeni kuadër. I pakomprometuar! — Dhe lëvizni dorën në ajër si të peshonte diçka. — E, ç'ç marrim vesh edhe ne të bazës.

Shoku tundi kokën.

Ore, babam, ti nuk i kuptoke mirë këto gjëra, më duket! — E përshëndeti dhe u largua.

Nasi mbeti prapë vetëm.

— Ma hodhi, — tha. Përballë qenë zyrat e shtabit. I vështroi me radhë. Ku të shkante?

«Në kuadër! — vendosi më në fund... Mití na i ka të gjithëve në dosje «radioskopitë»».

Shkoi atje. E vërtiti me kujdes. Po nuk mundi të mësonte asgjë për të qenë, as atë ditë dhe as të nesërmen. Të pasnesërmen bëhej mbledhja e organizatës. Kur kujtoi mbledhjen, ia ndezi vështrimin një mendim i fshehtë. Për Lonin ajo ishte mbledhja e parë. Domsdo ai në fillim do të bënte prezantimin. Dhe atëherë...

Loi foli shkurt. Tregoi se familja e tij kishte qenë bazë luftar. Një vëlla e kishte dëshmor, tjetri që përleshur me bandat e diversantëve deri më 1951. Ai vetë e kishte mbaruar shkollën në gjashtëdhjetër. Kishte punuar pak kohë në repart, pastaj në ministri.

— Kjo është e tëra, — tha dhe shtriu krahët anash. Mori të ulej, por ndërroi mendje. Shtoi:

— Kam bërë një lutje në komitet për të më caktuar të «Roja e ajrit». Atje...

Iu duk se kryesoren e kishte thënë, ndaj nuk e zgjati.

— Ne kemi shumë nevojë këtu, — ia ktheu sekretari i organizatës. — Sidoqoftë ta shikojmë! Pyetje besoj nuk ka, — vazhdoi ai. — Atëherë...

— Kam unë, kam unë! — thirri Nasi duke u ngritur me ngut në këmbë. Shikoi nga Loni, pastaj nga shokët dhe fërkoj duart.

— Të më falni, shokë, por më duket, se nuk po

na ndjek njeri pas. Pra të mos nxitohemi! Të sqarohemi mirë! Unë, për shembull, doja të dija: ka pasur pretendime për punën e shokut Loni atje ku ka shërbyer? — Fërkoj prapë duart dhe buzëqeshi me cinizëm.

— Nuk ju kuptova, — iu drejtua sekretari. — Folni më qartë!

— Më qartë? Po, mirë! Shoku Loni na bëri tërë atë biografi! Bukur xhanëm, po ndonjë vërejtje, ndonjë kritikë, nuk paska pasur? Ja, u bënë gjithë ata plënume! P'pesti, i gjashti... Dölën gjithë ato gjëra!... Po ai?

Loni u ngrit

— Si të them! Gjatë punës, domosdo më janë bërë dhe kritika. Bie fjala ndonjëherë jam treguar ca i rrëmbyer dhe e kam shkelur me ndonjë shok.

Nasi nuk e la të vazhdonte.

— Tjetër, shoku Loni, tjetër!

— Po ja, mbasë dhe jetën nuk e njoh aq mirë. Kam punuar pak në bazë,

— Aty të dua, mik i dashur! Je burokratizuar, me një fjalë. Ke koncepte. Pa na thuaj më shkoqur: cilat janë ato? Si i keni shprehur? Nga i keni huajtur xhanëm? Se, domosdo, të rrethuar jemi, e... njerez që nuk na duan kemi, e...

— Ku e ke fjalën ti, o Nasi? — nuk iu durua sekretarit.

— Nasi ngrysi vetullat.

— Të lutem, shoku sekretar, mos më ndërhy! As presion mos më bëj! Këtu jemi të gjithë komunistë! — dhe u kthye nga shokët, duke kërkuar ndihmën e tyre. — Unë e kam me shokun Loni. Të zbërthehet sa më mirë shoku Loni, se ne nuk kemi vetëm

të mirë. Jemi dialéktikë, e organizata duhet t'i dijë të gjitha.

— Unë kaq kisha, — tha Loni. — Në harrova gjë, shokët! le të ma kujtojnë!

— Atëherë përse të hoqën?

Loni e ndjeu se diçka i ishte mbledhur në kraharor, por vendosi të mos ngutej.

— Mua nuk më hogën, unë qarkullova si shumë të tjerë, sipas normave! — tha me zë të ulët, dhe u ul. Po e ndjeu se nuk i kishte thënë të tëra. — Sa për Nasin, — shtoi nga vendi, — natyrisht ju e njihni më mirë. Por mua më duket se ky shok ka lakra

Sekretari tundi kokën.

— Kjo është e vërtetë, — shtoi menjëherë pas Lonit dhe vështrroi nga shokët. — Sikur deshët të thoshit diçka ju, shoku Miti.

Miti ishte njeri i qetë. Rrallë fliste. Ai zakonisht dëgjonte më shumë vëmendje të tjerët dhe mbante shënime. Ndonjëherë edhe ngrihej. Fliste ngadalë dhe çdo fjalë e tij zinte vend. Por atë çast dukej që e kishte humbur gjakftohtësinë.

— Mendoj të shtojmë edhe një pikë në rendin e ditës, — tha. — Bisedë për qarkullimin dhe propozime konkrete për qarkullim». Këtë gjë na e detyron, në radhë të parë, shoku Nasi. Ai nuk i kupton mirë këto probleme. Ka lakra në kokë që ç'ke me të! Një gjë të tillë ne e kemi vënë re dhe herë tjetër. Tani mendoj se është koha të ndalemi.

Nasin e shpuan si hostën këto fjalë.

— Ç'është ky propozim i çuditshëm! — tha. — Nga na e nxori shoku Miti këtë! Ky është ofendim për mua. Është! — dhe vështrorri nga shokët. Kërkoi ndihmën e tyre. — Flisni, more shokë!

— Po, do të flasim! — ia ktheu Samiu.

— Do të flasim, posi! — ia kthyen edhe Tafa, Sullejmani, Sherafi...

— Dakord, por... — i ndërpreu sekretari. — Më parë të hedhim në votë propozimin e shokut Miti! Kush është pro që t'i shtojmë një pikë të re rendit të ditës?

Të gjitha duart u ngritën lart.

NGJITHA DUART U NGRITËN LART.

Konferenca e përbashkët e Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, ka përfunduar me sukses. Në të kaluarën, konferencat e përbashkëta të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, kanë qenë të rëndësishme për popullin e Kosovës dhe të Shqipërisë. Konferencat e përbashkëta të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, kanë qenë të rëndësishme për popullin e Kosovës dhe të Shqipërisë. Konferencat e përbashkëta të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, kanë qenë të rëndësishme për popullin e Kosovës dhe të Shqipërisë.

General Sekretari i Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, i ka bërë të ditur se konferenca e përbashkëta të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, ka përfunduar me sukses. Konferenca e përbashkëta të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Kosovës dhe të Komitetit të Përbashkët të Komunistëve të Shqipërisë, mbledhur në ditën e mërkurë të 17 majit të vitit 1961 në Tiranë, ka përfunduar me sukses.

NGJARJE NË STEPË

Korriku sikur kishte mbledhur në atë vend tërë nxehtësinë e muajve të verës së 1961-së. Dielli i stepës digjte si saç tokën e përzhitur. Në tërë atë hapësirë të pafundme nuk lëvizte asnjë fije bari. Nga toka ngriheshin avuj mbytës dhe krijonin diku larg imazhin e një liqeni të plumbtë. «Volga» vraponte e vraponte drejt tij. Liqeni, në vend që të afrohej, largohej, po nuk zhdukej. Ai ishte gjithnjë në sfondin e stepës. Hera-herës të dukej sikur valët e plumbta shpejtonin mbi stepë, për të shuar etjen e saj e për t'i derdhur në damarë freskun jetëdhënës.

Gjeneral Shvarcovi zbriti ngadalë nga «Volga» dhe hodhi i pakënaqur një sy përreth. Vartësit e tij sikur kishin bërë gjithçka për t'ia larguar mërzinë që i ndilte stepa. Tenda ishte ngritur me mjeshtërinë e barinjve kozakë të atyre anëve. Në tavolinën e

vendosur nën tendë dukej dora e kujdesshme e një kamerieri nga ata të restoranteve të klasës së parë. Gotat prej kristali, shishet, frutat, pastat dhe pastaј vazoja me lule të freskëta në mes. Çdo gjë ishte në vendin e vet. Adjutanti nuk kishte harruar as ventilatorin me bateri, të ndërtuar posaçërisht për Shvarcovin nga mekanikët më të mirë të akademisë. Por asgjë nuk ia largonte zagushinë mbytëse gjeneralit. Po ta shikoje me kujdes, do të vijë re se kishte diçka që ia kish prishur keq qetësinë e këtë bënin çmos ta zbulonin adjutanti dhe kamerierët, që vërtitëshin pas krahëve të tij. Ata vrisnin mendjen të gjenin se çfarë mungonte, me shpresë që t'ja kthente Shvarcovit humorin e humbur. Kamerieri i parë, i veshur me bluzë të bardhë borë e me pantallona blu, të cilat kishin dy viza të kuqe anash, u zgjat që prapa dhe vendosi mbi tavolinë transistorin. U përpoq të kapte një stacion për të qenë, por në atë orë të mesditës dukej sikur të gjithë spikerit e Lindjes e të Perëndimit e kishin bërë me fjalë të jepnin lajmet. Kjo gjë e nervozoi edhe më shumë Shvarcovin. Më në fund kondesatori ndeshi në një muzikë xhazi. Në fytyrën e ngrirë të gjeneralit lëvizi një buzëqeshje e lehtë, të cilën adjutanti e vuuri re menjëherë. Vetëm vapës së stepës nuk i gjendej dermani.

— Gozhda del me gozhde, — u përkul nga gjenerali oficeri që ishte pranë tij, një flokëqethur me makinë zero e me qafën rrathë-rrathë. Në supe mbante spaletat e kolonelit me shenjat e armës së aviacionit dhe në gjoks një shirit po aq të trashë e me dekorata si të gjeneralit, tek i cili ndrintë ylli i artë i Heroit të Bashkimit Sovjetik.

— Nuk ju kuptova, — foli Shvarcovi pas një heshtjeje të shkurtër.

Koloneli i aviacionit qeshi në mënyrë konfidenciale, ashtu siç kishte fituar të drejtën të qeshte vetëm ai në praninë e komandantit të akademisë, dhe mbushi dy gota me vodkë.

— Për mua më mirë një uiski! Një skoç uiski. Ka?

— Natyrisht.

Kamerieri, si e mbushi gotën tërë elegancë, hodhi në të pak sodë sipas zakonit.

Ata nisën të gjerbnin ngadalë pijet, derisa gotat u zbrazën dhe u mbushën rishtas. Gjenerali lëvizi dorën duke lënë të kuptohej se nuk dëshironte të pinte më. Adjutanti nxori një shami tjetër të bardhë borë nga çanta dhe ia zgjati për të fshirë djersën.

— Edhe ju! Ku e gjetët ta bënit tani këtë qitje! — shfryu i pakënaqur Shvarcovi.

— Zbatuam urdhrin tuaj, shoku gjeneral, — ndërhyri me takt koloneli. — Ju vetë caktuat ditën dhe orën.

— Ah, po, desha ta shihja me sytë e mi këtë qitje eksperimentale, — u kujtua gjenerali. — Ju e dini se unë ngula këmbë për kushtet. Po hëpërhë më duket se janë ca të vështira, — Shvarcovi fshiu djersët mbi buzë e mbi mjekër. — Ndofta edhe të parakohshme, — shtoi. — Sidoqoftë, çdo gjëje i gjendet ilaçi. Veç vapës...

— Dhe stepës, — shtoi koloneli. — Stepë, stepë dhe vetëm stepë! — foli ai duke i nxjerrë fjalët me një fishkëllime të zgjatur dhe nisi të këndonte melodinë e preferuar të një këngë ruse me zë të ulët sa për të dëgjuar vetëm gjeneralin.

— Qenkeni në qejf, Seriozhä! — Gjenerali zbrëtheu jakën e këmishës.

— Pse jo, koleg!

Nisën të flisnin vesh më vesh.

— Kur mendoj se edhe pak vjet na mbeten përgjithësisht për të jetuar, bëhem me humor dhe dua të pi vodikë, vodikën tonë të shkëlqyer, vodikën e pakrahasuar ruse. Para saj uiski më duket një hig.

— Kurse mua, ta them hapur, vdekja më ndjell tmerr. Po më mirë të mos flasim për këtë! Edhe sa mbeten ende për të bërë qitje? — pyeti gjenerali oficerin e poligonit.

— Kjo është ndërresa e parafundit, — iu përgjigj ai në drejtqëndrim.

— Ashtu? Atëherë shumë mirë! — tha Shvarcovi, dhe u ngrit. Sytë i shkuan te katër oficerët e ndërresës, që qëndronin në vijën e zjarrit, dhe te të tjerët në bazën e nisjes. Sipas rregullave të poligonit, ata i kishin kthyer shpinat tendës së gjeneralit. Të veshur me uniformat verore, dukeshin nga prapa të gjithë njëjloj. Dallonin vetëm nga flokët. Dy të fundit i kishin të zinj. Gjenerali pyeti për kombësinë.

— Shqiptarë, — i shpjegoi komandanti i kursit, i cili rrinte më këmbë prapa krahëve të tyre, bashkë me kamerierët dhe adjutantët.

Vështrimi i gjeneralit rrëshqiti mbi oficerët me flokë të zinj.

— Juzhnie ljudi! — tha ai duke shtrënguar nënfullat.

— Po, shoku gjeneral, njerëz jugu janë.

Gjenerali u kthye nga komandanti i kursit.

— Si mësojnë?

Tjetri u përpoq t'i zgjidhte fjalët, me qëllim që të jepte përgjigjen që kënaqte eprorin:

— Si t'ju them! As mirë, as keq. Ashtu, — dhe si

e lëvizi pëllëmbën majtas e djathtas e shikoi në sy, duke u përpjekur të hetonte në i kishte pëlqyer apo jo përgjigjja komandantit të akademisë.

— Për politikë, besoj, të çajne, hë? — ndërhyri gjenerali, duke qeshur me shpoti. Qeshi edhe komandanti i kursit.

— Oh, natyrisht. Por edhe për qitje nuk bien poshtë. Sidomos ai, si e ka emrin? Po, Sokol, Sokol Shpendi.

Gjenerali shqiptoi shtrembër e duke i ndarë fjalët në rrokje:

— Sokoll Shpiendi!

Ai u çapit drejt makinës, por atë çast vrojtuesi i rezultateve thirri sa u tund poligoni:

— Tabela e djathtë dyzet pikë, nga dyzet të mundshme.

Shvarcovi i hodhi një vështrim hetues kolonelit të aviacionit: «Si është e mundur?» — pyeste vështrimi i tij. Koloneli rrudhi supet. Ata u panë gjatë në sy. Nuk vendosnin, në duhej të qëndronin ende, apo të hipnin në makinë e të shkonin.

— Ma sillni këtu tabelën! — urdhëroi pas pak gjenerali. Urdhri u plotësua menjëherë. Gjenerali vështroi gjatë mbi tabelë. Shumica e goditjeve nxinin si grenza në rrathët anësorë e jashtë tyre, ndërsa duke iu afruar qendrës vinin e rralloheshin përherë e më shumë. Në rrethin e dhjetës ishin pesë-gjashtë goditje.

Gjenerali e flaku tabelën mbi rërë:

— Eta slluçajnost! — shfryu. — Kjo është një raste.

Ata që u ndodhën pranë i miratuan fjalët e tij, duke tundur koken:

— Natyrisht!

Gjenerali lidhi përsëri duart pas shpine e nisi të çapitej nën tendë. Transistori përhapte një melodi të lehtë orkestrale, tingujt e së cilës sikur hiqeshin zvarrë mbi rërën e stepës. Shvarcovi zgjati dorën dhe e mbylli.

— Kjo është rastësi! — përsëriti.

Fjalët sikur mbetën pezull mbi zagushinë e stepës.

— Jo! — kundërshtoi ai që sapo kishte kryer qitjen, duke vazhduar të pastronte me kujdes pistoletën. — Nuk është rastësi.

Gjenerali u kthye me rrëmbim. Ndeshi në vështrimin e oficerit të panjohur.

— Si!? — pyeti rreptë.

— Thashë se nuk është rastësi, — u përgjigj po aq rreptë tjetri, duke i përdorur fjalët ruse me një akcent të huaj.

Gjeneralit i thëri në tëmtha, e vështroi tjetrin për disa çaste, por shpejt u detyrua t'i largonte sytë prej tij.

— Ju e flisni keq rusishten! — i tha.

— Ndofta, — u dëgjua rishtas zëri i parë. — Pedagogu më ka vënë gjithnjë notë të mirë. Megjithëse.... ka më rëndësi që kjo ta thotë mirë fjalën e saj, — shtoi duke treguar tytën e pistoletës.

Gjenerali shkeli me nervozizëm cigaren e ndezur. Eci ngadalë nga kreu i tavolinës në fund. Akcenti prej të huaji i njeriut të jugut dhe vapa ishin krejt të padurueshme.

— Unë nuk ndërroj mendim, — vazhdoi. — Dyzet pikë, me sekonda të numëruara, kur objektivi është njëzet e pesë metra larg, me pistoletë luftarake e jo sportive, është tamam rastësi të arrihen.

Vështrimi i Shvarcovit rrëshqiti mbi fytyrën e

oficerit pastaj mbi ata që i rrethonin. Ishin grumbulluar gati të gjithë oficerët e kursit të fundit. Shumica i miratuan me entuziazëm fjalët e gjeneralit. Disa nuk bënë asnjë lëvizje. Kureshtja se si do të përfundonte dialogu në mes tyre i kishte përrpirë.

— Ju lutem, si e keni emrin? — pyeti gjenerali sa për të fituar kohë.

— Sokol. Sokol Shpendi.

— Dhë tani, kapiten Shpendi, pohoni se unë kam të drejtë, — nguli këmbë komandanti i akademisë. — Dyzet pikë janë thjesht një rastësi.

Shqiptari shkëmbeu një vështrim kuptimplotë me shokun e tij e iu përgjigj:

— Jo!

Oficerët që i rrethonin lëvizën si në ethe.

— Kokëfortë! — mermëriti një zë.

Duke u përpjekur të buzëqeshte, gjenerali e ndjeu se ishte ngërdheshur dhe kjo e bëri të skuqej.

— Pra, — shtoi pas pak, — njëri nga ne të dy gabon. Unë do të pranoj se jam vetë ai që ngul këmbë pa arsye, me kusht që të më provoni të kundërtën.

Sokol Shpendi vështroi tabelën ku shquheshin qartë goditjet në rrethin e dhjetës:

— Ja prova! — tha.

Gjenerali e ndjeu se biseda kishte arritur kulmin.

— A jeni i zoti ta përsëritni rezultatin? — e pyeti duke ia ngulur sytë në bebëza.

Sokoli e pa po me aq ngulm.

— Besoj se po, — iu përgjigj i vendosur.

— Mirë, atëherë. Vendosni atje tej një tabelë të re! — urdhëroi drejtuesin e qitjes. — Sa për pis-

toletën, — iu drejtua Sokol Shpendit, — keni të drejtë të zgjidhni atë që qëllon më mirë. Ose, po të dëshironi, mund të bëjmë më parë kolaudimin. Këto janë kushtet. Pranoni?

Kapiteni uli kokën.

— Ju falem nderit, nuk është nevoja. Pistoleta ime qëllon në shenjë, — foli me po atë akcent prej të huaji.

— Eh, nuk mundem ta duroj këtë të folurën tuaj. Është më të vërtetë e tmerrshme.

Gjenerali ishte bërë shumë nervoz. U ul në karrige dhe ndoqi me kujdes veprimet e shqiptarit. Sokol Shpendi iu afrua shokut, shkëmbeu me të disa fjalë në gjuhën e vet, pastaj eci me hap të qetë dhe u ndal mbi vijën që kufizohej nga dy flamuj të vegjël të bardhë. Atje mori fishekët, mbushi krehrin, e vuri në pistoletë dhe, duke mbajtur tytën lart, u çapit i sigurt drejt vijës së zjarrit. Vështrimi i tij u ndal mbi tabelë. Ai u përpoq të dallonte rrethin e dhjetës.

— Zjarr! — komandoi drejtuesi i qitjes.

Pistoleta u ul nga lart poshtë. Tyta e saj u ndal në qendër të tabelës. Sokolit iu duk se i dridhej dora nga emocioni. Ishte i bindur se të gjitha vështrimet qënë përqëndruar mbi të. «Po sikur!?... «Dëshira për t'u kthyer nga shokët iu shndërrua pak nga pak në një tundim të vërtetë. Iu desh të sforcohej, për të mos iu nënshtruar atij tundimi. Vështrimin ia përpiu fundi i stepës. Diku, nga ajo anë, por larg, shumë larg, ndodhej Atdheu i tij. I përballuar ai mbylli sytë dhe mbi stepë u ngritën kodra, male, kurse hapësirën e murme e veshi gjelbërimi i butë i ndezur. Ai mori frymë thellë. Iu duk sikur kraharori iu mbush me aromën e trëndelinës.

Kur hapi sytë, e ndjeu se gjithçka kishte kaluar. E tërë hapësira që e rrethonte u ngushtua dalngadalë, gjersa u përmbloodh në atë tabelë të vogël, të mbuluar nga rrathët. Ai ngriti dorën. Shënoi, tërhoqi këmbëzën. Pastaj përsëri... dhe raportoi:

— Kapiten Shpendi e mbaroi qitjen.

Grumbulli i oficerëve u shkëput nga tenda, si të kishte shpërthyer pranë saj një predhë dhe u vërsul drejt tabelës.

— Dhjetë... nëntëmbëdhjetë... njëzet e nëntë... tridhjetë... tridhjetë e tetë! E pabesueshme!

Shoku i tij, Petriti, i numëroi edhe një herë goditjet për t'u siguruar dhe rendi te Sokoli. Iu hodh në qafë. E puthi.

— Të lumtë, Sokol! Të lumtë!

Sokoli sikur u përmend nga një ëndërr.

— Duhej të kisha qëlluar më mirë, — tha. — Për inat.

Gjenerali e vështronte që lart. Ai përpiquej të ruante gjakftohtësinë. Dukej i thyer, por jo i mundur.

— E pur, si muove, — përsëriti pas pak në gjuhën latine shprehjen e famshme të Galileut. — Unë e përsëris, kapiten: Kjo është thjesht një rastësi. Teoria e qitjes e pranon posibilitetin e goditjeve. Ajo pranon gjithçka, natyrisht, duke përjashtuar mundësinë që dy plumba të bien në të njejtin vend, — iu drejtua kolonelit të aviacionit, i cili përfitoi nga rasti e thumboi:

— Ashtu! Duke përjashtuar mundësinë që të përsëritet dyzëtpikëshi nga ky i huaj.

— Më falni, kolonel, por këtë gjë nuk e thotë teoria e qitjes, — e korrigjoi Petriti, shoku i Shpendit.

— E thotë, e thotë, — qeshi koloneli. — Natyrisht, përderisa ju, shqiptarët, nuk e keni hedhur ende poshtë.

Këtë radhë e qeshura shpërtheu me gjëmimin e një krisme.

— Nëse ju, shoku kolonel, dëshironi t'jua provojme, — shtoi Sokoli kur ra heshtja, — atëherë s'kemi kundërshtim.

— Mos dëshironi të qëlloni përsëri? — pyeti Shvarcovi.

— Po!

— Jeni gati?

— Gati!

— E, mirë. Furnizues, — thirri komandanti i kursit, për të fituar kohë, — jepini shqiptarit tetë fishekë! — Pastaj iu drejtua Shvarcovit: — Dakord, shoku gjeneral?

Shvarcovi uli kokën në shenjë miratimi.

— Shokët më kanë thënë, — i tha Shpendit, — se në gjuhën tuaj, «shpend» ka kuptimin e fjalës «ptiçnij». — Dhe qeshi me ironi. — Pra kini kujdes, Sokoll, mos ju fluturojnë plumbat! Stepa jonë, siç e shihni, është kaq e madhe, ndofta më e madhe se ai vendi juaj.

Gjeneralit i pëlqeu shakaja e tij.

— Ju lutem, më jepni një nga cigaret tuaja! — iu drejtua mirënjohës kolonelit. Ky i zgjati në çast paketën. Ai vuri cigaren në buzë dhe nxori shkrepësen ta ndizte. Por duart i dridheshin nga nervozizmi. Këtë e vunë re të gjithë dhe menjëherë.

— Nuk doja aspak t'ju ofendoja, — foli prapë Shvarcovi, — por vendi juaj është vërtet tepër i vogël, diçka më pak apo më shumë se pesëmbëdhjetë,

njëzet mijë kilometra katrorë, në qoftë se nuk më tradhton kujtesa.

— Kujtesa ndofta nuk ju... tradhton, — Sokoli i mëshoi fjalës së fundit, duke i dhënë asaj një kuptim të dyfishtë, — por diçka tjetër, shoku gjeneral Shvarcovi.

— Çfarë?

— Nervat.

— Kjo është shpifje. Unë nuk jam aspak nervoz. Përkundrazi.

— Ndofta, — vazhdoi Sokol Shpendi. — Në qoftë se është ashtu siç thoni, atëherë mua më mjafton njëra nga të dyja tabelat. Zgjidhni kë të doni.

Gjenerali kërceu në këmbë.

— Ju... guxoni të mateni me mua?!

— Po!

Komandanti i akademisë vështroi ata që e rrethonin.

— Paturpësi! — shfryu koloneli i aviacionit.

— Përse paturpësi!? — pyeti Petriti. — Më duket se këtu nuk ka asgjë të veçantë. Një garë miqësore. Vetëm kaq.

— Ashtu? — koloneli ktheu kokën andej nga erdhi zëri, pa e ndërruar pozicionin e trupit. — Po a e dini ju kë keni përpara, shokë «të nderuar?» — pyeti me ironi. — Para jush atëherë është njëri nga gjeneralët më të lavdishëm, Andrej Mihailović Shvarcovi!

— E dimë, — pohoi Petriti. — Ajo që thatë është plotësisht e vërtetë, kolonel.

— Kurse unë nuk mbaj as tituj as grada të larta, — shtoi Sokoli. — Jam ushtar i popullit tim, pjesëmarrës i thjeshtë i Luftës sonë të lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Koloneli tundi dorën në ajër, si të donte të godiste dikë me putrën e ariut.

— Për llafe ju shqiptarët jeni të paarritshëm!

— Kur është nevoja, edhe për pushkë s'mbetemi pas...

— Mirë, shoku gjeneral, nëse më lejoni, dëshiroj të bëj unë qitje në vendin tuaj, — iu lut koloneli i aviacionit komandantit të akademisë.

— Jo! Këtë radhë do të përpiqem të provoj unë diçka, — tha me ton solemn Shvarcovi. — Ju e dini se nuk kam qenë qitës i keq.

Dhe gjenerali qeshi në një mënyrë kuptimplote, i bindur se atë buzëqeshje të tij ishte në gjendje ta zbrëthente mirë koloneli i aviacionit. Sikur të vazhdonte, ai do të thoshte se ishte qitës i shkëlqyer. Kur qe ende i ri, e çaktuan në skuadrën e qitësve të dalluar, që përfaqësonin akademinë në garat pan-akademike. Duke u stërvitur, dogji arka të tëra me fishekë. Dhe treguesit më të lartë i arriti pikërisht në qitjet me pistoletë. Pastaj erdhi lufta. Fishekët që zbrazi nga Leningradi në Poznan nuk kishin të llogaritur. Ai numërohej ndër dy-tre qitësit më të mirë të armatës. Madje, Urdhrin e Parë të Trimërisë, të firmosur nga komandanti i frontit, e mori disa ditë më vonë, pasi kishte asgjësuar njërin nga snajperët më të mirë të Rajhut të Tretë, me një goditje të vetme. Ai snajper i kishte shkaktuar dëme shtabit të divizionit. Pas kësaj ngjarjeje Shvarcovi doli në krye të listës së snajperëve të armatës dhe nisi t'i ngjiste me një shpejtësi të pabesueshme shkallët e karrierës ushtarake, duke arritur brenda katër-pesë vjetve nga major në gjeneralmajor. Po për këto ai nuk tha asnjë fjalë. Më mirë t'i tregonte me gjuhën e zjarrtë të pistoletës së tij me dorezë fil-dishi.

— A jeni gati, pra? — pyeti Sokolin.

— Gati, shoku gjeneral!

U nisën të dy. Gjenerali ecte me hap të rëndë, krenar dhe solemn. Sokoli u përpoq ta rregullonte hapin me të, por e pati të vështirë. Qëndruan larg tabelës në distancën e caktuar. Nxorën pistoletat. Këtë radhë nuk u dëgjua më komanda «zjarr!». Kur në vijën e zjarrit ndodhej gjeneralkoloneli, në poligon nuk duhej të pipëtinte as miza. Këtë rregull të thjeshtë e të vjetër sa ushtria, e dinin mirë të gjithë.

I pari ngriti krahan gjenerali. E drejtoi pistoletën mbi tabelë. Gryka e saj lëvizte çuditërisht. Sokoli e dalloj në çast. «Është bërë nervoz», mendoi dhe tërhoqi pa u ngutur këmbëzën e pistoletës. Plumbat pushuan diku në gjirin e stepës. Ajo mori në gjoksin e saj të pafund edhe goditjet e gjeneralit. Pastaj i erdhi radha vrapimit, rendjes nervoze drejt tabelave. I pari, si gjithnjë, vraponte çaplehtë Petriti. Ai pa në fillim tabelën e Sokol Shpendit.

— Dyzet! — gati ulëriu dhe u hodh në tabelën tjetër. Arriti tamam në çastin kur njëri nga oficerët përpiquej të hapte një birë në rrethin e dhjetës.

— Megjithatë, përsëri nuk bëhen dyzet! — tha Petriti. — Gjithsejt tridhjetë e tetë nga tridhjetë e gjashtë që ka marrë realisht gjenerali.

Kur i paportuan shifrat, Shvarcovi murmuriti diçka nëpër dhembë, pastaj u përpoq ta shprehte edhe një herë mendimin me gjuhën e plumbave, por ky mendim nuk i doli asnjëherë ashtu siç dëshironte; tridhjetë e pesë, tridhjetë e shtatë, përsëri tridhjetë e shtatë dhe më në fund tridhjetë e dy. Ishte me të vërtetë shumë nervoz. I papërmbajtur. Ndofta kohët e fundit nuk i kishte bërë në rregull edhe

stërvitjet e zakonshme për një gjeneral të denjë. Sidoqoftë ai nuk duhej të lejonte t'ia kalonte një farë shqiptari...

— Për herë të fundit! — tha ndërsa ngriti krahum dhe zbrazi tre fishekë të tjerë me dorën që nuk mundte ta zotëronte kurrsesi. Fishekët goditën rrethin e shtatës, të tetës dhe vetëm një herë dhjetën. Koloneli i aviacionit iu afrua, i hodhi krahum dhe e ftoi të pinin nga një gotë uiski nën tendë. Por ai e ndjeu se e kishte humbur qetësinë e ndofta për herë të parë po bëhej qesharak në sytë e inferiorëve.

— Unë nuk shoh në këtë mes asgjë për t'u shqetësuar, gjenerali im, — foli ngadalë koloneli dhe ngriti zërin, që ta dëgjonin qartë të gjithë. — Në fund të fundit, kjo është shkolla jonë, janë armët tona.

Sokol Shpendi e rroku në çast kuptimin e atyre fjalëve.

— Armët janë vërtet tuajat, — i tha. — Sa për shkollën, ne e kemi nisur atë në vendin tonë, në vitet e zjarra të Luftës Antifashiiste Nacionalçlirimtare. Atje kemi mësuar edhe si të qëllojmë. Për tabela patëm gjoksin e armikut. Dhe qëlluam jo keq, paçka se armët qenë gjithnjë të armiqve.

— Dëshiron të thotë se ne i kemi mundur armiqtë në shekuj me armët e tyre, i erdhni në ndihmë Petriti.

Gjenerali bëri shenjë me dorë që të heshtnin.

— Ju e flisni gjuhën tonë në një mënyrë të tmerrshme, — përsëriti kushedi për të satën herë.

Sokol Shpendi u hoq sikur nuk dëgjoji. Ai e ndjeu se gjenerali mezi përmbahej.

— Në vendin tonë, — tha, — ne nuk qëllojmë gjithnjë në tabela kaq të mëdha. Nganjëherë na pëlqen t'i kemi ato ja kaq! — shtoi duke nxjerrë nga

xhepi një paketë cigaresh. — Dëshironi ta provojmë? Mund ta vendosim njëzet metra larg. Nuk janë shumë, — përfundoi duke e shikuar Shvarcovin drejt në sy.

— Mirë.

Njëri nga oficerët vrapoi dhe e vendosi paketën në distancën e duhur. Gjenerali nxori pistoletën me dorezë të fildishtë dhe zbrazi thujse pa ndërprerje një karikator të tërë. Po e kuptoi, pa qenë nevoja të shkonte njeri atje, se asnjë nga plumbat nuk kishte goditur në shenjë.

— Pistoletë e keqe! — tha dhe e hodhi me nervozizëm mbi rërën e stepës. Sokol Shpendi u çapit drejt saj, e mori dhe nisi ta pastronte me kujdes nga rëra.

— Ne kemi një fjalë të urtë, — tha me po atë ton të qetë, që e tërbonte gjeneralin shumë më tepër sesa akcenti prej të huaji. — «Nuk është shpata, hekuri i dheut, por krahu i fuqishëm i Skënderbeut». Nuk di si e përktheva në rusisht, u shfajësua pas pak, — por në gjuhën tonë këto tingëllojnë bukur, tamam si një këngë epike.

Ndërsa fliste kështu, vazhdonte të pastronte pistoletën duke u kujdesur që të mos mbetej në të asnjë kokërrizë rërë. Ndërkaq iu afrua komandanti i kursit dhe i foli ngadalë te veshi:

— Dëgjoni, kapiten Shpendi! Ju nuk duhet ta goditni atë shenjë.

— Sokoli ngriti ngadalë sytë nga pistoletë dhe i nguli mbi fytyrën e komandantit të kursit. Në shprehjen e saj kishte diçka të ftohtë e të huaj, si rëra e stepës.

Tjetri nisi të fliste përsëri. Por tani zëri i tij mori

një tingull tjetër, kurse shprehja e fytyrës mbeti e pandryshuar.

— Kuptomëni drejt, shoku Shpendi. Ju duhet të keni më shumë respekt për gjeneralin. Ju e kup-toni se ai mund ta goditë lehtë shenjën, por është bërë nervoz dhe për këtë, duhet të më besoni, fajin e keni ju.

Sokoli ngriti supet. U mat të thoshte diçka, por nuk arriti. Rreth tyre u grumbulluan të gjithë oficerët e kursit: rusë, bullgarë, çekë, polakë. Secili nga ata ishte i bindur se zemërimi kishte arritur cakun e një skandali dhe se gjithçka ishte në dorën e Sokolit. Po të donte, ai mund ta goditë shenjën, po të donte mund të mos e goditë dhe gjithçka do të mbyllej me aq.

— Sokol, miku im, mos e godit!

Ai ngriti sytë. Para tij atje, në gjoksin shterpë të stepës u pleksën fytyrat, zërat, gjuhët, kombë-sitë. Dhe bashkë me to u përzien lutjet, urdhrat, krenaritë:

— Sokol, mos guxo!

— Ju lutem, Sokol! Ta lëmë me kaq dhe të shkojmë e të kthejmë nga një gotë!

Ai nuk i dallonte të gjithë zërat, por ishte e qartë, se të gjithë ata shprehnin një dëshirë të vet-me këmbëngulëse: Të mos e goditë. Sytë e tij se kë kërkuan në mes tyre. Kur e gjeti, Sokoli eci drejt tij. Po Petriti u tregua më i shpejtë. Ndalën ballë për ballë.

— Thuaji dhe ti, Petrit! — iu kthyen këtij. ata që luteshin. Po Petriti nuk foli. I vinte keq ta prishte atë heshtje të madhërishtme. Sokolit nuk i mungonte intuita. Ai e gjeti në sy përgjigjen që kërkonte nga Petriti. Dhe u nis. Qëlloi një herë, dy, tri.

— Tani mund ta merrni paketën ta shikoni,
— tha.

Disa vetë rendën të merrnin paketën. Po komandanti i akademisë nuk e pa të udhës të priste. Sedra e tij e përkëdhelur prej gjenerali të ushtrisë së madhe, që nuk ishte prekur as nga gjeneralët e Hitlerit, as nga gjeneralët e vendeve të tjera të Evropës e të Azisë, ishte lënduar rëndë tamam atje, në vendin e tij. Ai u fut në «Volgën» komode, e cila nisi të thithte me ngulçim ajrin e rëndë të stepës ruse.

SHOKËT

Ajo ishte një përmbysje e befashme dhe e menjëhershme. U duk sikur u hapën qiejt e derdhën mbi ta tërë zemërimin e zbrazëtirave të pafund. Kur e mblodhën veten, gjithçka kishte ndodhur. Minai qëndronte i shtrirë me këmbët mbuluar nga dheu, kurse Tarja me komandant Vasilin kishin ngjeshur shpatullat në ballin e tunelit dhe, ndonëse ishin një pëllëmbë larg, nuk arrinin ta shihnin njëri-tjetrin. Errësira ishte e plotë dhe e frikshme.

Jashtë sinjalin e dha Marku. Ai po futej në pjesën e betonuar, kur u shemb dheu disa metra para tij. Marku nuk arriti ta kuptonte menjëherë atë që ngjau. Kaluan disa sekonda dhe atij gati iu zu frymë, kur mendoi se po të ishte ndodhur katër-pesë hapa më tej, e tërë ajo masë e murme do të ishte zbratur mbi të dhe do ta kishte bërë petë.

Ky mendim i kujtoi shokët e turnit, me të cilët ishte duke punuar pak më parë. U kthye dhe rendi te gryka e tunelit. Zëri i doli i çuditshëm:

— Shpejtoni! Tuneli u shemb!

Fjalët dolën të pashkëputura, si një ulërimë e zgjatur që të zë frymën.

— Shpej-to-niii! — thirri pas pak, po këtë herë tingujt u shkëputën si të prerë me sëpatë. Ata dolën të çjerrë, fishkëllues, si një kujë. Shokët që ndodheshin jashtë e kuptuan në çast se kishte ngjarë diçka e jashtëzakonshme dhe u derdhën drejt tunelit. Atje qëndruan si para një humnere marra-mendshe dhe vështruan shoku-shokun duke kërkuar me sy ata që mungonin.

— Astrit!

— Këtu jam.

— Zalo!

— Këtu.

— Mungon komandant Vasili!

— Edhe Tarja!

— Edhe Minai!

Dikush nisi të thërriste:

— Shoku komandant! Mina!... Tare!...

Po fjalët i përplau sakaq gryka e errët e tunelit. Për disa çaste askush nuk foli më. Dheu ngrihej para tyre si një varr i stërmadh. Koha dukej sikur kishte mbetur në vend. Me sytë e hapur tej mase, ushtarët qëndronin gjysmë të përkulur, në një pozicion të çuditshëm, si të përgatiteshin për t'u ndeshur me diçka të mbinatyrshme e për të shpëtuar shokët. Po masa e dheut e kishte fshehur çdo gjë nën shpatullën e malit dhe ata më në fund dolën nga kllapia.

Petritit iu prenë gjunjët. U ul dhe thirri me zë të çjerrë.

— Pu-pu, shokët...! Ku janë shokët?!

Nardi zuri tëmthat me duar.

— Aman, Petrit, mos thirr kështu!

— Si të mos thërres, bre?! Shokët, bre vëllezër! Ku janë shokët?!

Zijait iu rrokullis një lot nëpër faqe dhe shpejtoi ta fshinte:

— U treguam tamahqarë, more shokë! Nuk e betonuam në kohë dhe ja tani! Ja, si e pësuam!

Marku kishte ngrirë dhe nuk qe i zoti as të lëvizte, as të fliste. Mendimi se tërë ajo masë dhe mund të kishte rënë mbi të, ia kishte mpirë gjymtyrët. Të tjerët thërrisnin, goditnin me shkelma dheun e shkrifët.

Zaloja zuri veshët me duar.

— Heshtni! — U mat të shtonte edhe diçka, po nuk mundi. Në fyt i qe mbledhur një lëmsh mbytës. Nga i vinte tërë ajo marramendje?

— Heshtni! Heshtni! — vetëm këto thoshte, si të përpiqej të nxirrte bashkë me fjalët edhe atë lëmsh që i zinte frymën. Shokët u mblodhën rreth tij dhe prisnin. Në fillim as ai nuk diti ç'të thoshte. Si zëvendës i komandantit, duhej të mendonte diçka. Balli i qe mbushur me bula djerse. Shkopsiti xhaketen.

— Nuk bën ta humbasim si Zijai, more shokë! Ne jemi ushtarë dhe...

Zijai nuk e la të vazhdonte:

— Aman, Zalo, ç'të bëjmë? Si t'i shpëtojmë shokët?

Sakaq që prapa krahëve të tyre u dëgjua një zë:

— E tmerrshme, shokë!
Ushtarët u kthyen nga ai që foli.
— Çfarë është e tmerrshme?
— Gjysma e kodrës atje lart është shembur, —
tha dhe tregoi me dorë drejtimin. — Është krijuar
një humnerë e madhe!

Disa vrapuan andej nga tregonte Astriti dhe u
kthyen shpejt:

— Hon! Një hon i vërtetë! — thanë.

Zaloja i pa vetullngrysur.

— Sidoqoftë, — ia priti, — ne do t'i shpëtojmë:
O burrani, të heqim dheun shpejt!

U shkëput nga shokët e rendi nga baraka.

— Lopatat! Sillni shpejt lopatat!

Ushtarët morën shpejt e shpejt nga një lopatë
dhe iu vërsulën përgut të dheut. Nisën të hiqnin
dhë me rrëmbim. Lopatat ndiqnin njëra-tjetrën.
Veç zhurmës metalike që shkaktohej nga ndeshja
e metalit në gurë dhe dheut që hidhej tej, asgjë
nuk dëgjohej. Të gjithë ishin përkulur mbi lopata
dhe punonin në heshtje që ndillte mendime.

Sekush foli:

— Ej, komandant Vasili, mor shokë! — dhe u
lëshua mbi kodrën e dheut sikur të donte ta për-
pinte.

Zalos nuk i hiqej nga mendja komandanti. Në
fillim ata nuk u morën vesh mirë me njëri-tjetrin.
Komandant Vasili e shënoi emrin e Zalos në listën
e atyre ushtarëve që i shënojnë ditët e shërbimit
në rripin e mesit dhe që u bëjnë bisht vështirësi-
ve. Dhe këtij iu mbush mendja se komandanti e
shihte ndryshe nga të tjerët. Po ditët kaluan, ata u
njohën, e panë se ishin shpejtuar në gjykime dhe
i hynë në zemër njëri-tjetrit. Ishin jo thjesht ko-

mandant e vartës, por mbi të gjitha shokë. Pak nga pak Zalos i lindi e iu forcua në vetvete ajo ndjenjë që e shtynte të mos kursente asgjë për komandantin. As edhe jetën. Po kjo nuk ndodhi menjëherë. Shoqëria e tyre, dashuria e respekti për njëri-tjetrin u kalitën në stërvitje, në marshime, në poligone, në shërbi-met e shumta, ditën dhe natën. Ndaj tani ushtarit i dukej sikur kishte një jetë të tërë që njiheshin. Sikur ishin rritur bashkë.

Ndërsa hiqte dheun me lopatë, as ai vetë nuk e kuptoi përse i vajti mendja tek ajo natë, nata e parë që do të merrte shërbimin. Zaloja kishte pritur të merrte armën dhe të bënte rojë. Shokët do të flinin, gjethet do të fëshfërinin, yjet do të dridheshin lart në qiell, kurse ai... Ai do të vigjilonte. Dikush i kishte thënë se pranë vendrojes kalonte vija e kufirit. Se atje mund të shfaqej befàs keqbërësi, mund të shfaqej armiku. Pastaj...

Por ajo natë nuk ngjante me të tjerat. Yjet që në fshehur të trembura prapa reve. Vetëtimat e ndiznin qiellin flakë dhe fshikullonin egërsisht majat e pemëve. Dukej sikur gjoksi i qiellit çahet, nxirrte diçka të zjarrtë të frikshme nga thellësitë dhe e lëshonte me tërbim drejt tokës. Kurrë ndonjëherë vetëtimat nuk i ishin dukur aq të zjarrta e të tmerrshme sa asaj nate. Bëhej një çast heshtje. Pastaj diçka çahet e thyhet atje lart dhe një gjarpër i zjarrtë nisej me një dritë verbuese. Dhe përsëri gjithçka topitej në errësirë. Ai priste gjersa përsëri gjithçka përzihej e merrte rrugë. «Po sikur...»

Vetëtima ia preu në mes mendimin. Tej, në të dalë të repartit dalloj një hije. «Njeri?» Priti sa të ndriçohet përsëri vendi. «Po, njeri!» Ç'hall e kishte nxjerrë jashtë në atë tufan?! Ai zuri pozicion dhe

priti. Vendi u ndriçua përsëri. Tani i harroi vetëtimat. Harroi çdo gjë. Vështronte vetëm njeriun, që ecte drejt vendrojes. Cili ishte ai? Mos vallë?... mos vallë?... Po, komandant Vasili! Me siguri që vinte për kontroll. Kur ndali pranë tij, Zaloja vuri re se ai kullonte i tëri nga uji. Nën sjetull seç mbante.

— Merre, — i tha. — Tëndja është bërë qull e do të ftohesh.

Ishte mushama.

— Po ju, shoku komandant?

— Unë nuk jam lagur aq, — dhe ia hodhi kraheve. Zalos iu kujtua nëna, kur ngrihej natën dhe e mbulonte.

Ato orë i kaluan bashkë. Ngroheshin me frymën e njëri-tjetrit. Pastaj erdhi ta ndërronte Minai. Po Vasili nuk u largua. Qëndroi gjersa pushuan vetëtimat.

«Eh, komandant, komandant!» — tha me vete dhe iu vërsul si i tërbuar dheut me lopatë. Në të dalë të tunelit po ngrihej një kodër tjetër nga dheu i hedhur. E atje sikur nuk kishe hequr asnjë lopatë.

— Shokë!

Ushtarët u kthyen nga Zaloja. Djersët u rridhnin rrëke. Qepallat u qenë veshur me pluhur. Buzët bërë shkrumb.

— Nuk e kemi mirë! — vazhdoi ai. — Si e heqim dheu, si nuk e heqim, ç'bëri!

Ata u mbështetën mbi lopata. Petriti u ul mbi pirgun e dheut.

— Po sikur të kërkojmë një vinç? — pyeti Nardi.

— Punë e kotë. Ku pret koha?!

Zaloja vështronte lart, atje ku pjesa e betonuar
puqej me dheun e vithisur.

— Atje të heqim, — tha. Si s'na ra ndër mend
më parë? Na shkoi kot mundimi.

Vrapuan lart. Lopatat u ngjeshën njëra pas
tjetrës. Ata hiqnin dheun, tjetri binte nga lart. Ata
hiqnin, dheu binte. Por tani që e dinin se ç'po bënin,
e harruan lopatën. Shpresa e takimit me shokët u
jepte krahë. Disa orë punë dhe nuk e ndienin lodh-
jen. Në fillim sikur do t'u dilnin krahët nga vendi.
Sikur do t'u çahej kraharori nga lodhja dhe dësh-
përimi. Pastaj u veshën me avuj djerse. Trupat si-
kur iu mpinë. Po kështu edhe mendimet. Vështro-
nin vetëm dheun. Dhe pas tij shokët. Komandant
Vasilin, Taren, Minanë.

Dikush foli:

— Sikur ta kishim këtu dhe Minanë!

Nuk u mor vesh se kush ia përmendi emrin.
Lopatat ndalën një hop. Vështrimet u fiksuan mbi
dheun e butë, nga dilnin avuj.

— Minai, more vëllezër!

Dhe u vërsulën përsëri mbi dheun.

Minai punonte sa për pesë. Punonte dhe nuk
nxirrte zë. «Po fole një fjalë, mor i uruar!» — e
ngacmonte Tarja. Ai e vështronte dhe qeshte. Një
ditë dikush i tha «xhaxhai i kompanisë». Dhe i mbe-
ti «Xha Minai». Nuk u mor vesh kush ia ngjiti atë
nofkë, po të gjithë e pranuan në heshtje. Madje
dhe vetë Minai. E pranuan, jo vetëm se ai vinte më
i rritur nga shokët, as se ishte pjekur para kohe.
Jo vetëm për këtë, por kishte diçka të veçantë në
sjelljen e tij, në mënyrën si ecte, si fliste, si rre-
gullonte krevatin, komodinën. Diçka që të ndillte
mendime.

Një mbrëmje, kur të gjithë ishin mbledhur në dhomën e kulturës dhe shkruanin letra ose lexonin, Minai u fut me vrull brenda. Kroi zërin. Diç donte të thoshte, po u pendua. Në duar vërtiste një letër. Tarja ia rrëmbeu. «Telegram», — thërriti. Dhe lexoi: «Zarja lindi djalë. Na shkruaj ç'emër t'i vëmë.» Tarja e kapi nga supet dhe e tundi:

— Shiko, i ligu i dynjasë, qenka bërë baba dhe ka turp!

Shokët e rrethuan sakaq.

— I ligu i botës, u bërë baba!

Minai rrinte serioz.

— Më duhet një emër, — tha. Një emër për të qenë.

Tares nuk iu durua:

— Epo folni, more shokë, se më çmendi ky xha Minai! Si na e mbajti të fshehtë, që priste të bëhej baba? Të më falni, domethënë, po që sot e tutje unë do ta thërres «memec».

Tarja ndryshonte shumë nga ai. Madje ata sikur plotësonin njëri-tjetrin. Atë që linte mangut Minai në bisedë, e mbushte Tarja, atë që s'e bënte dot ky në punë, e plotësonte Minai.

— Edhe ti, o Tare, na shurdhove fare. Lopatë e ke atë të shkretë gjuhë!

Ai, kërcente si kaphosh.

— Të më falni, domethënë, po gjuhën allahu na e ka sajuar për të folur e jo për ta mbajtur vegël rezervë, si ca e ca, — dhe vështronte Minanë.

Minai nuk e prishte fare terezinë. Vazhdonte punën.

— Ki mendjen, — i tha një ditë, — se do të ta pres atë gjuhë me gërshërë.

Tarja e pati përgjigjen në majë të gjuhës.

— Të më falësh, shoku Mina, por unë nuk e nxjerr gjuhën nga goja!

Një e dy dhe «Të më falni, domethënë... «Një ditë prej ditësh shokët e vunë përpara: «Të na falësh, domethënë, o shoku Tare, po ta vumë një fle-tërrufe sa një çarçaf».

«E përse u munduat kaq shumë, or xhanët e Tares?»

«Ashtu kot, domethënë. Ja, vumë re se ke një javë që nuk po e realizon normën dhe s'të lamë brinjë pa thyer.»

«S'prish punë. Është bërë shuall kurrizi im».

«Po pse, o Tare vëllai, me kurriz i pret kritikati?»

«Epo ç'të bësh, domethënë. Veshët na i nxori jashtë përdorimit xha Minai!»

Lopatat ndiqnin njëra-tjetrën. Dheu përplasej me zhurmë atje, poshtë: zhup-zhup-zhup.

— Shokë!

Ishte një thirrje gati entuziaste. Vështrimet e të gjithëve i rrëmbeu ajo fashë drite, që u shfaq befas në mes dheut dhe pjesës së betonuar të tavanit.

— Fitore!

Lopatat lëvizën më shpejt. Nga zgavra te hapur ata dolën në hapësirën humnerë. Askush nuk i vuri re gojët e hapura, gojët e shqyera nga të katër anët, dheun që rrëshqiste papushim, kodrën e dheut që mund të përmbysesj mbi ta. Shikonin atë vijë, pas së cilës duhej të ishte hapësira tjetër. Shokët.

Ç'kishte ngjarë vallë me ta?

Marku deshi të pyeste, po ndërroi mendje. U vërsul me duar, si një ari, mbi dheun e butë.

— Me lopatë, Marko, me lopatë!

Ai mori lopatën. Të tjerët po ashtu. Askush nuk qe në gjendje të thoshte sa vazhduan në atë mënyrë. Më në fund lopatat ndeshën përsëri në boshllëk. Ishte një si pus i errët, i thellë.

Zaloja thirri. Zërin e Zalos e përpiu errësira. Ata ishin kapur dorë për dorë dhe shtrëngonin fort shoku-shokun, duke u përgatitur t'i bënin ballë së papriturës. Kaluan një sekondë, dy, tri. Zemrat sikur nuk rrihnin. Thërritën të gjithë njëherësh:

— Shokë, ku jeni?

Nga poshtë u ngrit një zë, si psherëtimë.

— Këtu!

— Gjallë?

— Po.

— Zëri i Tares ky! Për ideal, zëri i Tares! O Tare!

Të gjithë sa u ndodhën atje ia ngulën sytë zgavërës. Nuk u durohej, sa t'i shihnin. Pasuan disa sekonda. Një minutë. Ndofta dy. Por që poshtë nuk u bë më njeri i gjallë. Dëgjohej vetëm një si murmurimë e zgjatur.

— Shoku komandant!

Po përgjigje nuk pati. Zalos nuk iu durua më. Kërceu në zgavër dhe rrëshqiti poshtë. Në fillim nuk mundi të dallonte asgjë. Errësira ishte e thellë dhe rrëqethëse. Mbi krye hapej ajo, zgavra. Që andej futej një fashë e zbehtë drite. Zalos-i duke largët ajo dritë. Hapi krahët që të mos rrëzohej. Ndeshi njërin nga ata.

— Tarja? — dhe e preku me gishtat që i dridheshin, si të donte të bindej në ishte vërtet ai. Atë çast dalloj dhe dy të tjerët. U lëshua mbi ta.

— Vëllezër!

Ata i shihin kapur dorë për dorë. Sa kohë kishin ashtu?

— Ç'prisni më, shoku komandant? A nuk e dini se dhe vazhdon të gremiset dhe nga çasti në çast?!...

Në zërin e tij kishte qortim. Qetësia e tyre e habitte.

— Ç'prisni më?! — thirri prapë. Komandanti psherëtiu:

— Deri këtu në rregull, — tha. — Por tani nuk më binden më. Unë i urdhëroj: «Dilni, more shokë!» Ata: «Dil ti, shoku komandant». — Punë është kjo? Ku ka bërë vaki të mos të bindet ushtari?!

Zaloja kapiti sytë. «Ja si qenka!» Dhe prapë nuk i besohej.

— Ju s'jeni në rregull, more shokë! — foli Zaloja. — Ju nuk dini se ç'bëhet atje jashtë! Ju...!

Dhe i vështrroi të tre me radhë. Në fillim komandantin. «Është e kotë, — mendoi. — Nuk del para ushtarëve ai».

— Unë, pa komandantin... — tha qetë Minai.

Zaloja e tundi fort nga supet.

— Eej, je çmendur ti?! — Të tre do të dilni! — dhe e mbërtheu nga shpatullat. — Ndihmomëni, shoku komandant!

Ata e shtynë Minanë me forcë nga poshtë. Pastaj u kthyen nga Tarja.

— Hajde, dil ti tani! — dhe e shtynë edhe atë. Pastaj doli komandant Vasili dhe më në fund Zaloja. Të gjithë i mbështolli drita marramendëse. I rrethuan shokët, Ata i ngritën të tre në krahë dhe s'dinin ç'bënin. Tarja i vështronte i hutuar. Fytyra i ishte llangosur me baltë. I dukeshin vetëm dhembët dhe sytë.

— Të më falni, domethënë, po unë po zbres prapë atje, se boll ju kam mërzhitur! — dhe mori të ecte drejt zgavrës.

Ata e mbërthyen në çast. Kujtuani se e kishte me gjithë mend.

— Të kemi falur përgjithnjë, o Tare!

Dhe nuk u besohej që i kishin përsëri shokët në mes tyre.

KUR MARR DYFEKUN E BËJ PËR PJETË MALIT

Veprimet luftarake në prapavijë të «armikut» kishin zgjatur një ditë e një natë. Ndaj të ngrysur çeta vullnetare kishte kaluar në zbrazëtitë e forca-ve tona të vijës së parë, që futur thellë dhe kish rrethuar e asgjësuar shtabin e «të kaltërve», duke mbjellë në radhët e tij panik e pasiguri. Të gjitha këto e lodhën çetën por ajo nuk jepej, se e kishte kryer detyrën me sukses. Tani ajo po përgatitej të kthehej në rajonin e saj.

— Nisemi vajza!

Në rreshtin e parë çapiteshin tri më të gjatat e çetës: Zoga me atë hap të menduar prej burri, Bardha vetullkaleshe dhe Mira me sytë e kaltër, që nuk i mbyllej goja as në pushim e as në marshime. Në fund ishte xha Maloja, kurse Shota qëndronte në krah të majtë, atje ku e kishte vendin

komandanti. Ajo binte në sy ndër shoqet jo vetëm për gërshetin e gjatë pendëkorbi, që i zbriste gjer nën bel, po edhe për atë zë të ëmbël e të dredhur, që e njihnin në ato anë dhe krojet e zajet. Kur ia merrte Shota, edhe bilbili në degë pushonte e mban-te vesh:

*Çeta jonë vullnetare,
Gur' i kështjellës së madhe...*

Po atë ditë kënga nuk shkonte.
— Seç ke ti, Shotë, sot! — i tha Zoga kur zërat u fashitën.

— Nuk kam gjë jo, — dhe Shota u përpoq të merrte një këngë tjetër. Po ajo s'shkonte që s'shkonte.

— Më kot mundohesh, s'je në terezi, Shotë. Më duket se ke rënë në dashuri, — i tha Mara dhe qeshi sakaq. Qeshën dhe të tjerat, kurse Shota u bë lullëkuqe. Nuk diti si të përgjigjej, po xha Maloja i erdhi shpejt në ndihmë.

— Ti qaj hallin tënd, moj qyqe, që do të mbe-tesh pa burrë, pa Shotën kush nuk e merr!

— Unë timin e kam gjetur më kohë, — e ngau fjalën Mara. — Ti vështro Shotën, xhaxha, se ato që e vrasin lart çoku mbeten pa martuar.

Qeshën prapë e u çapitën në heshtje. Shota nuk ia largonte sytë xha Malos. «Për së të nda-hemi do t'ia them, — vendosi dhe u përpoq të zgjidhte fjalët më të përshtatshme. — Kushedi si do t'i vijë.»

Xha Maloja ecte si gjithnjë në fund dhe, sado që përpiqej të mos e jepte vetën, Shota e kuptonte se ai mezi i ndiqte vajzat. Shkak e pa shkak ajo

e ndalte çetën për t'i dhënë mundësi atij të çlodhej.

— Ulu, xha Malo e ndize njëherë se e ke hak!

Ai nuk jepej aq lehtë.

— Ecim, çupa, ecim, — thoshte dhe dilte nga fundi në ballë të çetës.

«Kockë e fortë ky Malo Drini! — bënin çudi fshatarët. — As në të ri dhe as në pleqëri nuk e hoqi dyfekun nga krahët e nuk iu nda çetës.» Dhe vrisnin mendjen të gjenin shkakun. Mbase kjo vinte ngaqë fjala «çetë» i kujtonte Luftën Partizane. Mbase vajzat me dyfekun krahëve e yllin e kuq në ballë i sillnin ndër mend shoqet e luftës. Në fillim sesi iu duk, kur e pa veten në mes tyre. «Punë çupash!» — tha. Po pak e nga pak i hynë në zemër. «Vajza për kokë të vajzave, nuk barazohen me to as dy djem bashkë.» Dhe i mblidhte rreth vetes u jepte përvojën e vet:

— Shikoni tani si merret vija e shënjimit! — u thoshte.

Ato nuk ia prishnin kurrë. Xha Maloja u tregonte rregullat e shënjimit, pastaj shtrinte krahun përpara.

— Ja, «gjermani» ka zënë atë kodrën atje tej! — thoshte. — E ka bërë pëllëmbë e dyfek, si në Qafë të Këçikut. Tani më tregoni pak, nga do t'i afrohemi, si do ta sulmojmë, si do t'ia heqim kodrën nga duart?

Ato mblidheshin kokë më kokë. Përpiqeshin të gjenin rrugën më të mirë. Xha Maloja i dëgjonte dhe përdridhte me lezet mustaqet. «Vajza me një barrë mend»

Ato e rrethonin sakaq.

— Xha Malo, tregëna për luftën!

Ai atë priste. Plekste një cigare për qejf dhe e ndizte. Ato e përgjonin në sy. Edhe ai përgjërhej për to. I kishte si vashat e tij. Sa shumë holasi, kur Zoga u fejua në fshatin përtej! I mbloodhi menjëherë djemtë e fshatit dhe s'u la gjë pa thënë. «Të humburit e botës, s'qetë të zotë t'ia prishnit mendjen një çupe dhe ju fluturoi zogu nga duart!» Ata s'dinin si t'i përgjigjeshin. «Kujdes, mos ju rrëmbejnë Shotën; se pastaj s'më dilni përpara!» — i porosiste.

Vajzat i merrnin vesh ato fjalë dhe bëheshin edhe një herë aq.

— Tregona, xha Malo! — i dilnin në shtegun që i pëlqente. Ai në fillim kundërshtonte.

— Një herë tjetër, — thoshte. Po ato nuk i ndaheshin:

— Tani, xha Malo! Për herë tjetër kemi të tjerë.

Ai ulej këmbëkryq dhe ia niste:

— Që thatë ju, moj çupa, ish dimër i sertë atë vit. Të ngrinte dhe loti në sy.

Ato shpesh ia prisnin fjalën në mes:

— Po ti ç'ishe atëherë, xha Malo, komandant?

— E, de, komandant isha.

— Dhe shokun Subi e kishe nën komandë?

Ai bënte sikur nuk dëgjonte, po ato e kuptonin gjithçka nga shprehja e fytyrës.

Ngrihemi tani, se vajti dreka! — thoshte.

Ato ngriheshin dhe ecnin pas tij. Malo Drini e zinte dyfekun nga tyta dhe e hidhte në sup, si komitet. Rrypi i varej në të djathtë. Shota kafshonte buzën. «Nuk ia them dot, — mendonte. — Më mirë t'ia thotë nënë Duda.»

— Mirë mbeçi, vajza, dhe pastrojini mirë push-

kët, se do të vij t'jua kontrolloj! — i porosiste.

— Mos ki merak, xha Malo! Xixë do t'i bëjmë.

Kur arriti në shtëpi, e gjeti zjarrin ndezur e sofrën shtruar. Nënë Duda që kujdesur që çdo gjë të ishte në vendin e vet e ashtu siç i pëlqente atij. Kishte nxjerrë raki nga më e mira dhe kishte shtruar mezet që ai donte më shumë. Ai i pa të gjitha i kënaqur, zgjati duart prapë mbi zjarr dhe e ndjeu t'i shkrinte gjaku në damarë.

«Të shohim ku do të dalë kjo punë!» mendoi. Shtroi një gazetë, zbërtheu pushkën dhe pastroi me kujdes çdo pjesë të saj nga pluhuri e lagështira. Nënë Duda e gjeti kur po i shkonte një shtresë të hollë vaji.

— E pastrove mirë? — e pyeti.

— Po ja, si thua ti? — ia ktheu xha Maloja. Duda buzëqeshi, mbushi dy gota dhe ia zgjati njëren atij.

— Tani bromp, Malo Drini, dhe dorëzoja dyfekun rinisë, se u plakel! — e ngacmoi ajo.

Këto fjalë e goditën Malon atje ku i dhimbte më shumë. E shtyu me inat shishen. Rakia u derdh mbi velenxë.

— As jam plakur dhe as kam vdekur, — tha.

— Kur të vdes e dorëzoj dyfekun, në mos qofsh e zonja ti ta mbash.

Duda i mbushi prapë gotat.

— Ti, si të duash, — ia ktheu. — Po shiko, ka ardhur një letër!

Malo Drini ia rrëmbeu nga duart dhe nisi ta lexonte. Po gerrat e rreshtat iu përzien me njëri-tjetrin.

— Kujt i ra ndër mend të bëjë shaka? Janë me zarar këto, — shfryu.

— S'është shaka, jo, — e ngau fjalën nënë Duda.
— E solli korrieri. Edhe Shota e dinte, po do t'i ketë ardhur keq, të ta thoshte.

— Ashtu?! Demek qenkam bërë për mëshirë unë!

E mblodhi letrën shuk, e hodhi në zjarr dhe doli. Po gërmat nuk i shqitëshin nga sytë. I dilnin në gurët e rrugës, në muret e shtëpive, në fletët e pemëve. Nënë Duda e ndiqte që nga dritarja. Në fillim ai hyri në shtëpinë e Shotës, po doli sakaq dhe trokiti në portën e sekretarit të organizatës e më pas në atë të kryetarit të kooperativës. Në shtëpi u kthye afër mesnate. Nënë Duda e ndiqte që nga cepi i jorganit.

— Po ti, moj, ç'më përgjon ashtu si spiune!?

Ajo s'u bë as e gjallë e as e vdekur. Po ai ndezi sherrin dhe nuk mbajti mend ç'i tha. E zbrazi mbi të tërë zemërimin. Ajo heshte si një gur.

— Tani bjer e fli, se je lodhur! Nesër ditë gdhihet, — u përpoq ta qetësonte plaka.

— Nuk më flihet, jo. Ngrihu dhe bëmë një kafë, po deshe!

— Tani?! Do të të mbeten sytë në tavan, o i uruar!

Ajo u ngrit. Ai vazhdoi të shfrynte uf e buf. Një cigare e shuante e një e ndizte.

— Ç'ke ndër mend të bësh? — e pyeti nënë Duda.

— Do t'i shkruaj letër Enver Hoxhës.

Asaj iu derdh kafja në pjatë.

— Bobo, që do të na turpërosh tani në pleqëri!
— iu lut e iu lut që të mos e bënte letrën. Po ai as që ia vuri veshin.

— Ti hesht, se s'janë punë për gra këto! — e qesëndisi.

Ajo u ul në anën tjetër të oxhakut. Ai mori laps e letër dhe seç shkruante e shkruante. E gri-si dy-tri herë dhe e nisi prapë nga e para. Dudën e hidhte vendi. «E mjera, që do të turpërojë djem-të e mirë», mendonte e nuk fliste, se e dinte që do ta ndizte më shumë.

— Po ti, moj, ç'më rri si kopaçe e qullur!? Haj-de, bëmë një kafe, de!

— Prapë!? Ti sapo e pive!

— Pse, të dhimbset, a?

Dhe e gdhinë natën buzë vatre. Ai shkruante, ajo bënte kafën. Mezi zbardhi. Në fshat nisën të këndonin gjelat e parë. Malo Drini i hodhi shalën mushkës dhe u nis.

— Ku shkon? — e pyeti nënë Duda me gjak të ngrirë, kur po kapërcente pragun. Ai e pa ngrysur, pë nuk ia përgjigj. — Aman, shko ku të duash, ve-tëm Komandantin mos e trazo!

Malo Drini e goditi mushkën me shufrën prej thane dhe u bë erë. Vrapin e ndali në zyrat e Degës Ushtarake.

— Si kështu?! — e pyeti referentin pa u mbu-shur mirë me frymë. — Kush ma hoqi emrin nga lista e çetës?

— Ne ta hoqëm, xha Malo. Është rregull.

— Vërtet thua, more!?

— Po, xha Malo. Ka ligje qeverie. Për ty kemi pesëmbëdhjetë vjet që po i shkelim.

— A, jo xhanëm?!

Malo Drini nxori kutinë dhe u përpoq të plek-ste një cigare. Po gishtat nuk i bindeshin.

— Unë nuk kam dëgjuar për atë ligje, — tha si u mendua. — Unë dua të ma shkruani emrin në listë dhe ta mbyllim me këq këtë muhabet.

Po referenti nuk u tund nga e tija.

— S'të ndihmoj dot, — i tha. — Është vendosur ajo punë. Ti, po deshe, shkruhu në forcat e lira!

— Ashtu?! Dale, pa t'i tregoj unë forcat e lira!
— Malo Drini i zbriti shkallët dy e nga dy. Në oborr qëndroi dhe i hodhi një sy ndërtesës së Degës.

— Do të më shihni! — shfryu. Ata që rastisën pranë e shikuan të habitur, po ai as që u bë merak.
— Do të ankojem në komitet! — shtoi dhe doli nga porta me hekura.

Nëpunësi i shërbimit i komitetit i tregoi orët dhe ditët e takimeve, po ai as që e dëgjoi ç'tha.

— E kam ndryshe punën unë, — i shpjegoi. — Dua të takohem me Subinë. Merre në telefon dhe thuaji se ka ardhur Malo Drini. Kaq. Të tjerat i di vetë ai.

Tjetri e ngriti me mëdyshje receptorin e telefonit dhe, kur e uli, e ndryshoi menjëherë qëndrimin.

— Shkojmë bashkë! — ia ktheu dhe u çua. Po xha Maloja e uli nga supi.

— Të falemnderit, e di rrugën!

Shoku Subi e priste te dera e zyrës. Sa e pa, iu hodh në qafë dhe e mbuloi me pyetje:

— Si je me shëndet, shoku komandant? Si e kam nënë Dudën? Po shokët e tjerë ç'bëhen?

Po kur pa fytyrën e prerë të Malo Drinit, i mbetën fjalët në gojë. Iu duk shumë i lodhur dhe më i plakur se herët e tjera.

— Ç'ke kështu? Mos je gjë pa qejf? — e pyeti.

— Nga shëndeti nuk ankojem, por... — dhe i hodhi një sy tavolinës së mbushur me libra e letra,
— Ç'e do! Ti ke një barrë halle.

Sekretari i parë e uli pranë vetes.

— Presin ato, presin, — tha. — Malo Drini nuk pret. Hajde, tregomë si e ke hallin!

Maloja nuk diti si t'ia niste. U ngrit, iu afrua dritares dhe u përpoq të dallonte në mes ndërtesave të shumta godinën e Degës.

Nuk i kam punët mirë me ata që punojnë atje në Degën Ushtarake, — foli me rrëmbim. Sekretari i partisë vuri re se duart i dridheshin nga nervozizmi dhe nuk dinte si ta qetësonte.

— O Malo Drini, më duket se e ke harruar shoqërinë e luftës, — i tha pas pak. — Follmë hapur, si partizani partizanit, si komandanti ushtarit.

Maloja u gjallërua befas.

— Ashtu të të flas?

— Pa pikë druajtjeje.

— Po do të bësh si të të them unë, ama!

Sekretari i parë përkuli kokën dhe pritë. Plaku ia nisi:

— Mirë, atëherë. Unë jam komandant batalioni, apo jo? Ti komandant kompanie. Kështu?

— Kështu, shoku komandant.

— Dega Ushtarake është nën komandën tënde.

Mirë?

— Mirë.

— Atëherë, merre telefonin!

Shoku Subi e mori.

— Bjeri numrit të kryetarit të Degës!

Sekretari formoi numrin.

«Urdhëroni!» — iu përgjigjën nga skaji-tjetër i telefonit.

«Një minutë! Jam Subiu». — Sekretari u kthye nga Malo Drini.

— Ç'ti them tani?

— Thuaji të mos torolisen me Malo Drinin! Ose

prit njëherë, prit! — U mendua disa çaste. — Më mirë t'i biem shkurt! Puna është se mua ma kanë hequr emrin nga lista e çetës vullnetare. Kjo është e tëra, — shpjegoi. — Tani dua të ma shkruajnë prapë, se ndryshe të mbeta në derë!

Sekretari qeshi me të madhe, por u kujtua që telefonin e kishte të hapur dhe, si i kërkoi të falur kryetarit të Degës, i dha porositë e nevojshme. Pastaj qeshi prapë dhe u kënaq. Malo Drini plekste pa u ngutur cigare pas cigareje dhe e vështronte me bisht të syrit,

— Tani hajde të pimë një kafe! — e ftoi sekretari dhe i hodhi krahun. Ndërsa zbrisnin shkallët, xha Malos i qeshte fytyra:

«Të ishte nga ndonjë anë ai referenti i Degës dhe të më shikonte!» — thoshte me mend.

Kur po ndaheshin, Malo Drini e tërhoqi mënjane sekretarin e parë, në mënyrë që të mos e dëgjonin ata që mbushnin korridorin:

— Më fal që të trazova! — i tha. — Dhe mos u fol atyre të Degës, se janë djem të mirë. Po mua sesi më vjen nganjëherë. Më duket sikur mendojnë: «Aha, kaq e pate, Malo Drini! E hëngre çairin».

Sekretari iu afrua dhe i foli te veshi:

— Tani jemi vetëm, Malo Drini dhe nuk na dëgjon njeri. Do të më thuash një gjë, po drejt ama!

— Do të ta them:

— E ndien peshën e viteve?

Xha Maloja vështroi edhe një herë përreth:

Të vërtetën do?

— Të vërtetën.

— Dëgjo, atëherë! Kur marr dyfekun dhe bëj përpjetë malit, më duket edhe një herë vetja njëzet vjeç.

I shtrënguan fort dorën shoku-shokut dhe u ndanë si miq të vjetër. Sekretari i parë e vështron-te tek largohej. Trupin e mbante gjithnjë drejt e supet pak të varura. Pa arritur te dera, Maloja u kthye.

— Kam edhe një fjalë, shoku Subi.

I foli, po kësaj here më zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë sa ishin aty:

— Sa të më punojë gishti dhe syri, Malo Drini nuk e lëshon pozicionin. Këtë ua thuaj edhe shoqëve të udhëheqjes.

Subi Laska qeshi me gjithë zemër.

— Mos u plaksh kurrë, Malo Drini! — tha.

Po ai nuk dëgjoji. Mori pushkën atje ku e kish-te lënë dhe bëri të kthehej në fshat. Rruga e çante fushën mes për mes. Në ara gruri i pjekur lëkundej dallgë-dallgë. Që larg vinte vuvurima e kombajnës. Malo Drini vari festën mbi sy dhe ia mori këngës lehtë.

*Më dy prill na vjen haberi,
fonogrami me nxitim...*

— Vetë ia merrte dhe vetë ia kthente. Zilja e mushkës sikur ia mbushte me iso.

Nënë Duda e pa që larg dhe doli në sofat. Vështrroi Malo Drinin që ia zbriti mushkës e i hodhi frerinin mbi qafë dhe i mori me mend të gjitha. Priti ç'do t'i thoshte. Po ai s'foli, as ngriti sytë ta shikonte. Vetëm vazhdoi të këndonte me zë të ulët.

«I ka ecur mbarë», — mendoi Duda dhe solli nga kuzhina xhezven me kafe. Po ai prapë nuk i ngriti sytë.

— E piva një me Subi Laskën, — i tha, — nuk dua tjetër. Po dal njëherë andej nga kryesia.

Nuk i durohej sa të takonte shokët e t'ua tregonte fill e për pe të rejat e qytetit.

«Tani, po të duan, le të bëjnë prapë shaka me listat», mendonte.

Po çregjistrimi e bëri të vetën. Një natë, kur u dha alarmi, xha Malos nuk i trokiti njeri në derë.

«Burrë i vjetër, — thanë. — Ç'ta ngremë nga dysheku, se çoku merr ndonjë ftohmë.» Po kur arritën te Qafa e Muratit, e panë se ishin gabuar. Malo Drini kishte shkuar atje para të tjerëve. Kishte nxjerrë grykën e pushkës nga frëngjia e qendrës së zjarrit dhe përgjonte me gishtin në këmbëz.

Shota shtangu para tij.

Ai nuk e hoqi as syrin nga shënjestra, as gishtin nga këmbëza.

— Xha Malo, paske ardhur!?

Ai ngriti sytë:

— Edhe ti, Shotë, ma paske pasur me të pabesë?! — e pyeti.

— Ç'është ajo, xha Malo! Ti e di se unë të kam krah të djathtë.

— Po pse, de, nuk ma dërgove korrierin?

Shota u zu ngushtë.

— Gabova, — tha. — Mos ma merr për keq. Ja që e bëra këtë. Më fall!

Dhe qëndronte si e ngurosur në hyrje të qendrës së zjarrit, duke kafshuar me dhëmbë gërshtin pendëkorbi... Një copë herë të mirë as xha Maloja nuk i foli më. Më në fund zemra e tij e plakur u thye:

— Afrohu këtu, Shotë! — i tha butë.

Ajo u mbështet në supin e tij.

— Afrohu dhe ca, bija ime! Ashtu! Tani shikoje mirë atë luginën që nga Qafa e Muratit e gjer tej te përroi.

— E shoh, xha Malo.

— Po qoshen e rrugës e sheh?

— E shoh.

— Ashtu më rruash! Dhe tani dëgjomë! Më nëntëqindenjëzetekatrën, kur na ra hasmi me të pabesë, gjithë këtë vend që të zë syri ma besuan mua. Mua dhe Murat trimit. Ke dëgjuar për të besoj. Atëherë nuk kishim kala betoni si kjo. Luftonim në këmbë. Kapidan Selimi m'u vra ndër duar, kurse mua më mbërtheu plumbi shpatull më shpatull. Po hasmin s'e lamë të kalonte.

— E di, xha Malo. Ndaj i thonë Qafa e Muratit kësaj.

— Mirë, bijë. Dëgjomë gjer në fund!

Tyta e pushkës së xha Malos rrëshqiti nga faqja e kodrës, mbi qoshe të rrugës dhe u ndal tej te përroi.

— Këtë tokë e ruaj unë, Shotë, — tha. — Edhe në vdeksha, këtu të ma bëni varrin! Dhe të më lini një frëngji të hapur, që po të guxoje hasmi të shkelë kufirin, të nxjerrë grykën e dyfekuq' e ta qëlltoj.

Ai e mbështeti faqen e rrudhur mbi qytën e pushkës dhe e hodhi përsëri vështrimin mbi atë rrip toke të vaditur me gjakun e Murat trimit.

40

«NËNOJA»

Gjer vonë, nënë Shega u mor me përgatitje. Nxori nga sënduku fustanin më të mirë, këmishën e bardhë borë, këpucët dhe çorapët e rinj të mbështjellë në një bohçe. Pastaj i hodhi ftesës një vështrim të gjatë, e vendosi mbi radio dhe nisi të pas-tronte dekoratat.

E mbesa, Ermira e ndiqte me kërshtëri që nga nimi tek ishte ulur lëvizjet në heshtje të gjyshes. Heshtja e saj kishte diçka të veçantë, solemne. E kjo ngjiste rrallë, kur gjyshja do të shkonte për ndonjë vizitë të rëndësishme «te djemtë», apo kur e caktonin në presidiumin e ndonjë mbledhjeje, ose në tribunë me rastin e 1 Majit.

— Sa e mirë që je, moj nënole, kur nuk flet!
— e ngacmoi i nipi, Sokoli. Ajo vrenjti vetullat. Në

këso rastesh nënolja ndizej si kashta e s'pushonte së foluri. E niste nga koha e saj dhe vinte gjer në ditët tona. I bënte për ujë të ftohtë. Ata e dëgjonin pa nxjerrë zë, se kjo ishte mënyra më e mirë për ta çarmatosur. Kurse atë natë gjyshja sikur ishte bërë memecë. Nuk i punonte gjuha. Në të vërtetë ajo fliste me vete. Dhe mendimet e pashprehura të lodhin më shumë.

— Nënole, çoç ke harruar, — i tha Ermira dhe i zgjati shaminë.

— Març dhe nga ditët e mia, moj bijël — e uroi gjyshja.

Sokoli kish pritur rastin që ta ngacmonte.

— Ti s'ke për vete, nënole. U bërë tetëdhjetë vjeçe.

— Do të bëhem dhe njëqind. Tani që na solli Partia me Enverin tërë këto ditë të bardha, s'kam për të vdekur kurrë.

Ermira iu hodh në qafë dhe e mbuloi me të puthura.

— E mjaft tani, mjaft, se nuk puthen plakat!

Po Ermira e puthi prapë. Ajo gjithnjë e përkëdhelte gjyshen si një të vogël. I krihte flokët e nuk ia hiqte duart nga qafa. Nënolja përpiquej t'ia largonte, po e ndiente se nuk bënte dot pa përkëdheljet e së mbesës.

— E di unë përse do të shkosh atje ti, nënole, — tha befaz Sokoli.

— Pa hë, mor bukurosh!

— Që të dalësh në televizor.

— Si the, si?!

Nënë Shega u përpoq të drejtonte trupin, që ta shihte më mirë të nipin. Ai ë mori para duarsh dhe nisi të kërcente me të nëpër dhomë.

— Ah, more zullap? E di unë ç'do ti, po s'ta kam fuqinë, — e qortoi gjyshja.

Sokoli kroi zërin dhe u përpoq të imitonte speakerin:

«Sot në zonën e thellë të Mirditës u inaugurua fabrika e re e pasurimit të bakrit. Në këtë festë të gëzuar, me gjithë kohën e keqe dhe të ftoh-tin e madh, ka ardhur të marrë pjesë dhe nënolja e Sokolit».

Nënë Shega aty vrenjtej, aty qeshte:

—Hesht, more zullap, se...

Po Sokoli kishte marrë zjarr dhe s'dinte të pushonte:

— Pa do t'i lëshohen nënoles sonë, që the ti, Ermira, të gjithë korrespondentët me blloqe nëpër duar. Pa do ta marrin vesh edhe ata të fshatit. Gjysh Murati do të përdredhë mustaqet. «Si hekur kjo Shega, more shokë, — do të thotë. — U ngrit në palcë të dimrit dhe erdhi në Mirditë. Tunde, moj Shega jonë, tunde, se për këtë ditë i dhe vatanit dy djem azganë!»

Herë duke qeshur e herë duke iu «hakërruar» njëri-tjetrit, u gdhi mëngjesi. Një mëngjes i ftohtë, i plumbtë. Treni çante me gjëmim mbi shina. Në vagona s'kishte ku të hidhje mollën, po nënë Shegës i bënë vend menjëherë. Ajo ishte mbështjellë e tëra. Vetëm sytë kishte lënë përjashta. U ul afër dritares, çmbështolli shallin dhe u hodhi një vështrim atyre që e ftuan të ulej. Qenë të gjithë të rinj, si Ermira dhe Sokoli. Njëri, me fytyrë të hequr dhe vetullat kaleshe, seç i pëshpëriti shokut që kishte në krah. Ai kishte një buzëqeshje të ngrohtë e vështrim të ndezur. Të tretit nuk ia shihte fytyrën. Qenkësh vajzë! Në një çast iu kujtua Er-

mira. Po ai trup. Po ai fustan. Nënë Shega u përpoq ta shihte po ajo e kishte mbuluar fytyrën me gazetë dhe bënte sikur lexonte. Në të vërtetë mezi e mbante të qeshurën dhe i afrohej asaj gjithnjë më shumë, duke e ngjeshur te dritarja. Nënolja u mat t'i fliste, po kur vajza largoi gazetën, mbeti gojëhapur.

«Ermira!»

Pikërisht ajo.

— Po ti nga më mbive këtu, jet-o?

— Ja këndeje. Pse, vetëm do të të linim ne, nënole? U zumë e u grimë me Sokolin tërë natën kush të të përcillte. Më në fund fitova unë, — tha dhe e rroku për qafe. Nënë Shega u kënaq.

Njerëzit e shtëpisë i qenë lutur nënë Shegës të mos shkonte, se ishte ftohtë e binte shi. Po ajo nuk qe tundur nga e saja. Ishte përgjigjur:

— Mor po edhe sikur kërcunj të bien nga qielli.

Kishte një arsye të fortë që e shtynte Nënolen drejt Mirditës në atë mëngjes të ftohtë. Qe histori e vjetër ajo. Po nënoles i dukej sikur kishte ngjarë dje. Sikur i shihte edhe tani shpatullat e gjera të të birit tek çapitej para saj.

Ata shkonin të lëronin në arë. Qe kohë mbjell-jesh. Përpara ecte mushka me parmendën mbi samar. Prapa vinin qetë e Mere agait, që i kishin marrë me të tretë. Shega me Markun ecnin në mes. Ajo thurte çarapë të leshtë, ai këndonte me zë të ulët. Ishte i hedhur dhe i fortë, si një div. Nëna edhe i gëzohej, po edhe i trembej forcës së tij. E ndiqte me cep të syrit, tek çapitej para saj dhe kafshonte buzën.

«E mjera unë, thoshte. — Do të ma hanë me sy djalin».

Marku u përkul dhe mori një gur në anë të rrugës, siç bënte shpesh kur kalonin andej.

«Shikoje mirë këtë gur, nënole!» — i tha. Ai e thirri i pari kështu e pastaj e thirrën të gjithë.

«E ç't'i shoh, more bir? Gur si të tjerët është.

«Jo, nënole, nuk është si të tjerët. Pa shikoje pakëz! Është me damarë të kuq ky. Ka madem brennda.»

Nënë Shega nuk e kuptonte mirë atë fjalë.

«Le të ketë ç'të dojë! Neve nuk na hyn në punë.»

«Do të na hyjë, nënole, ke për të parë! Për ne e fsheh metalin ky gur. Për popullin e ruan. Vetëm të rrosh e të shikosh se ç'fabrikë e madhe do të ngrihet këtu, kur të çlirojmë Shqipërinë. Do të na e ketë zili bota. Ke për të parë!»

Nëna qeshte. «Punë çiliminjsh», — thoshte. Po ja fabrika u ngrit dhe oxhaqet e saj pushtuan qiellin. U derdhën aty për të punuar njerëz nga e gjithë Shqipëria. Vetëm Marku nuk ishte që të shikonte. Kishte rënë në ballë të luftës me shokë shumë. Po për nënolen ishte gjithnjë i gjallë. Edhe tani sikur ia shihte ato shpatulla. Sikur ia dëgjonte atë zë. Dhe ecte drejt tij.

«Ja atje, do ta ndërtojmë, nënole.»

Dhe u ngrit vërtet si mal fabrika; atje ku tha Marku u ngrit, ku dallgëzonte një det me njerëz. Nënë Shega u fut në mes tyre.

Binte një shi i imtë, po ajo kishte harruar të hapte çadrën dhe nuk e dëgjonte as zërin e Ermirës, që i lutej të futej nën strehë. Shumë gjëra i kishte harruar atë mëngjes. Vetëm atë nuk e harronte. Shpatullat e tij. Zërin. Fjalët.

«Po, biri i nënës, u ngrit fabrika. Sa një mal u ngrit.»

Zemra i gufonte, sikur do t'i çante kraharorin e do t'i dilte përjashta. Atë s'e mbante vendi. Çapitej ngadalë e seç mërmëriste nëpër buzë. Fliste me vetën. Me Markun. Dhe me shokët e tij. Me të gjithë. Po atë çast në mes tyre u fut befasi syri i xhamtë i kameras. Fjalët i mbetën në buzë. Iu kujtua në çast Sokoli, ajo meseleja e televizorit dhe i ktheu shpinën e mori të largohej. Po syri i xhamtë nuk i shqitej. E ndiqte ngado pas. Nënë Shega e humbi durimin.

— Më lër, mor bir! — iu lut.

Kameramani e vështroi i hutuar. Po nuk pati kohë ta tëhollte më tej. Dikush foli me zë të lartë:

— Po vijnë!

Të gjithë u kthyen nga vargu i makinave që po afroreshin. Kameramani humbi në mes tyre.

Mbrëmja erdhi e butë dhe me shi. Sokoli mbështolli librat dhe i vendosi me kujdes në sirtar. Iu afrua ngadalë televizorit dhe shtypi çelësin. Dikëka kërciti: trak. Nuk kaloi shumë dhe u dëgjuan tingujt e muzikës, dhe më në fund u afruan figurat. Zëri i spikerit u dëgjua qartë. Ai të kujtonte çuditërisht zërin e Sokolit:

«Sot para dite, në atmosferën e një entuziazmi të madh revolucionar, u inaugurua...»

Dhoma u tund nga zërat e mijëra njerëzve që mbushnin ekranin. U mbajt fjala e përshëndetjes. Pastaj shiritit iu afrua i deleguari i Qeverisë.

— E gëzofshi uzinën, shokë!

Ai ngriti gërshërën ta priste. Po dora i mbeti në ajër. Vështrimi i tij qe ndeshur me atë të nënë Shegës.

«Nënë Shega kjo!?»

Në çast gjithçka sikur ngriu në vend. Pas-taj njerëzit i hapën rrugë dhe ai eci drejt saj. I shtrëngoi dorën. I hodhi krahun dhe bashkë me të u çapit drejt hyrjes së uzinës, ku zgjatej shiriti.

— Të takon ty ta presësh, nënë! — tha i dele-guari duke i dorëzuar gërshërët dhe u kthye pas-taj nga grumbulli i njerëzve që prisnin:

— Projektuesi i kësaj vepre, shokë, është biri i kësaj nëne trime, Mark Gjergji. Kur përlësheshim me fashistët e këtyre anëve, ai na thoshte shpesh: «Pas Çlirimit këtu do të ndërtojmë një fabrikë të madhe.» Dhe populli e ndërtoi. E bëri realitet ën-drrën e dëshmorëve.

Dukej sikur televizori nuk do t'i mbante dot tërë ata zëra, tërë ato duartrokitje dhe do të çahej.

— Merri gërshërët, nënë Shega! Preje shiritin!

Ajo ngurroi një çast. Duart, buzët, i tërë trupi i dridhej. Hodhi sytë nga njerëzit. Të gjithë ata e vështronin me ngulm dhe prisnin. Ajo zgjati dorën.

—E gëzofshi, bijtë e mi!

Përmes perdes së lotëve, që ia veshën sytë nga gëzimi, dalloi diku kameramanin, i cili përsëri e kishte drejtuar mbi të syrin e xhamtë. Ndërkaq çdo gjë u mbështoll nga tingujt e sirenave, që lajmëro-nin fillimin e punës në uzinën e re. Bashkë me ata tinguj sikur çante kohërat edhe zëri i Markut:

«E sheh, nënole, e ndërtuam fabrikën!»

«Po, bir, e ndërtuam. Tani ta gëzoni!»

...në korridorin e gjatë të degës ushtarake...

...në korridorin e gjatë të degës ushtarake...

NË KORRIDORIN E GJATË TË DEGËS USHTARAKE

...në korridorin e gjatë të degës ushtarake...

Emri i tij nuk gjendej në asnjë listë. Në shtëpi nuk i dërguan ndonjë fletëthirrje për të shkuar ushtar, si të gjithë vërsnikëve që kishin arritur moshën e shërbimit! Megjithatë ai u fut në një radhë me rekrutët e tjerë. Ecte pa i vënë vesh mospërfilljes së tyre, Pas ca dikush puliti sytë.

— Po ky!?

Sakaq fare pranë gjëmoi një zë i fuqishëm «Parti-Enver!». Tërë rruga u tund nga thirrjet entuziaste të rekrutëve dhe çdo gjë u harrua. Si kaluan disa minuta, ata u futën në korridorin e gjatë të Degës Ushtarake, të mbushur me tym duhani, erë djerse dhe fragmente bisedash të lëna nga njerëzit, që porsa kishin dalë. Djemtë ic ngulën vështrimet një dere gjysmë të hapur, mbi të cilën ishte

vendosur një kornizë e vogël me germat «Komisioni». Pikërisht në atë derë, nga koha në kohë, dukej një kokë e shogët, e cila përsëriste:

— Tjetri!

Sa hynte brenda, rekruti i dilte përpara një tavoline e gjatë, e mbuluar me cohë të kuqe e me një vazo lulesh të freskëta në qendër. Matanë tavolinës kishin zënë vend shokët e komisionit. Ishin pesë-gjashtë oficerë dhe dy civilë, shumica me moshë të thyer, veç njërit me fytyrë vezake e leshra të dredhura. Ai kishte ulur kokën mbi një fletore dhe zhgaraviste figura pa kuptim. Nëpër dhomë vente e vinte një burrë i shëndoshë tullac me një palë syze të trashë prej miopi. Mbi gjoks i varej stetoskopi.

— I aftë, — foli mjeku duke e goditur lehtë rekrutin mbi shpinën lakuriqe dhe vështroi nga dera.

— Tjetri!

Para tavolinës qëndroi një djalë trupshkurtër, me mëngët e kominosheve të shpërveshura.

— Erdha drejt e nga turni, — buzëqeshi ai si i zënë në faj. — Nuk më mbeti kohë të ndërrohesha, së bëhesha vonë.

Këto fjalë nuk ngjallën asnjë kureshtje tek anëtarët e komisionit, me përjashtim të atij më të riut i cili, si e hetoi disa çaste me vëmendje, nisi ta skicojë. Ndërkohë, mjeku i vendosi stetoskopin në gjoks.

— I aftë. Tjetri!

Pak nga pak korridori po boshatisej, por kjo gjë nuk ra në sy menjëherë. Vetëm kur mbetën katër-pesë vetë, e si u larguan edhe ata, për disa

minuta sundoi heshtja, gjersa kërciti dera e në kornizën e saj u duk koka e shogët.

— Po ti?! — pyeti.

Djali që qëndronte në korridor u fut brenda pa dhënë përgjigje. Ata të komisionit vazhduan të bisedonin të shkujdesur. Asnjëri nuk e përfilli të porsaardhurin. Ai priti disa çaste dhe shqiptoi me zë emrin dhe mbiemrin e vet:

— Ilir Meçani!

Mjeku u kthye ngadalë dhe e kundroi që prapa syzeve me xham të trashë.

— Se ku e kam dëgjuar këtë emër, — mërmëriti pa iu drejtuar askujt. Ai gjithnjë e kishte habitur komisionin me kujtesën e vet të pagabuar.

— Po po, e kam dëgjuar diku. — Dhe prapë u mendua. «Meçani... Meçani... Djall o punë!» — Mos je nga Malasi, or djalë?

— Po.

— Nipi i Meçan Kovacit?

— Si urdhëron!

Mjeku hoqi syzet, nisi t'i pastronte pa u ngutur me lëkurën prej kamoshi dhe e vështroi djaloshin nga koka te këmbët.

— Demek nipi i Meçan Kovacit?

— Ai vetë.

Bisedat u fashitën njëra pas tjetrës. Anëtarët e komisionit u kthyen nga djali, që qëndronte i hutuar para tyre, herë duke i futur duart në xhepa e herë duke i nxjerrë.

— Përse u lodhe gjer këtu? — e pyeti mjeku, pa ia ndarë sytë.

— Dua të shkoj ushtar, — tha me gjysmë zëri tjetri. Pastaj sikur iu largua ajo ndjenjë pasigurie. Shtoi me ton të vendosur:

— Jam në moshë të mbroj atdheun!

— Po... — Mjeku picërroi sytë. — Po... Dashke të shkosh ushtar! Epo, mirë. Po më parë t'u përgjigjesh disa pyetjeve.

— Posi!

Djali bëri një hap përpara. Mjeku u çapit në për dhomë, pastaj u ndal përballë tij.

— Pyetja e parë: A ke dalë herë tjetër para komisionit ushtarak të Degës?

Djalit iu njomën pëllëmbët e duarve nga djerësa.

— Po.

— Kur?

— Para dy vjetësh.

Mjeku sikur u çlirua nga një ngërç.

— E shikoni? — iu drejtua shokëve. Ata rru-dhën supet, kurse ai u kthye prapë nga djaloshi.

— Pa na thuaj, or çun, ç'përgjigje të dhamë atëherë?

Illir Meçani nuk u ngut të përgjigjej.

— E pra, ç'përgjigje të dhamë?

— Më nxorët të paaftë.

Mjeku kujtoi i heshtur diagnozën: Spazëm funksionale me hemiperezë të anës së djathtë. — Pastaj shikoi me kujdes djaloshin dhe vazhdoi me mend:

«Gjurmë të një paralize të hershme, të cilat dallohen ende qartë në këmbën dhe dorën e djathtë, madje edhe në fytyrë, në cepin e buzës e në kapakun e syrit.»

I tha djaloshit me zë:

— Tanë ç'dëshiron? I paaftë nuk lejohet të vihet nën armë!

Djaloshi kafshoi buzët. Kraharori i ngrihej e

i ulej si të ishte kthyer nga një vrapim i gjatë. Një dridhmë e lehtë ia përshkoi tërë gjymtyrët.

— Që atëherë ka kaluar kohë, doktor, dhe...

— Çfarë pastaj?

Kanë ndryshuar punët, doktor.

— Po. Në dy vjet ka gjëra që ndryshojnë, por ka dhe... — mjeku u kthye në çast nga shokët, si të kërkonte edhe mendimin e tyre, — gjëra që, natyrisht, nuk ndryshojnë.

Djali s'diti si ta kundërshtonte.

— Më mirë më vizitoni, doktor! — tha dhe u kthye nga anëtarët e tjerë të komisionit:

— Epo vizitoheni, gjërsa ngul këmbë! — ndërhyri njëri prej tyre.

— Vizitoheni! — shtuan dy-tre të tjerë në një gojë.

— Po, po, vizitoheni! — mori zemër Ilir Meçani, shpërveshi sakaq mëngën e djathtë dhe nisi të përthyente dorën, duke dashur të tregonte forcën e muskulit. Pastaj u ul e u ngrit disa herë mbi gjunjë, si të donte të jepte prova për këmbënguljen e tij.

Mjeku mblodhi buzët:

— Qoftë e bërë, or çun! Zhvishu! — tha dhe, si shkëmbeu disa vështrime kuptimplote me anëtarët e komisionit, filloi ta vizitonte pacientin e çuditshëm, në fillim pa ndonjë dëshirë. Por pak nga pak kureshtja iu shtua. Vështroi një copë herë kra-hun e këmbën e djathtë, pastaj gjymtyrët e majta.

— Interessant! — foli ngadalë, megjithatë të tjerët e dëgjuan qartë. — Nxori metrin dhe mati disa herë trashësinë e gjatësinë, e gjymtyrëve. — Interessant! — përsëriti me zë të lartë. Pa e pasur mendjen, hoqi prapë syzet dhe i pastroi ngadalë me

lëkurën prej kamoshi, siç kishte bërë disa minuta më parë. Shokët ishin mësuar me këtë zakon të tij. Ai e përsëriste sa herë ndodhej para ndonjë rasti të veçantë, të cilit nuk e kishte të lehtë t'i jepte rrugë.

— Tani, djalo, ec! — e urdhëroi. — Prapa-ktheu! Ec akoma, ec!... Ulul!... Ngrehu!... Ec... Ec...! Ulul Ngrehu!

Mori në raft çekiçin e neurologut dhe nisi ta goditte lehtë në kyçe. I provoi reflekset e shollës të këmbëve dhe e urdhëroi prapë të ecte.

— Ec drejt! Ashtu! Ec!

Anëtarët e komisionit nuk ua ndanin sytë.

— Të vënë djersë, doktor! — tha më i riu syresh.

Ai bëri sikur nuk dëgjoji. Doli disa çaste nga dhoma dhe u kthye pas pak me një dosje nën sqetull. Lexoi me vëmendje vendimin e parë të komisionit, krahasoi të dhënat e atëhershme me të tanishmet dhe kërkoi një cigare, sado që nuk e pinte.

— Ja, kështu, or çun! — Nisi të lexonte me zë vendimin që kishte marrë komisioni i Degës mbi paaftësinë e përhershme të rekrutit Ilir Meçani. Pastaj nisi të trokiste gishtat mbi tavolinë me ritmin e një marshi.

— Ja, kështu, or miq! — shtoi pas pak. — Dëgjuat tani një vendim pa vlerë. Një vendim që... e kam firmosur unë, dhe disa nga ju. I drejtë, natyrisht. Kurse tani... tani...

Dukej sikur po fliste përçart. Anëtarët e komisionit vështruan njëri-tjetrin. Dikush vuri edhe buzën në gaz.

— Ç'flisni kështu, doktor!?

— Është vërtet për t'u çuditur, — pohoi mjeku.

— Literatura jep edhe raste të tilla, doemos, por në jetë.. në jetë ato ndeshen rrallë. Shumë rrallë.

Kërkoj nga shokët që të mbushnin një kartelë. E, ndërsa ai më i riu nisi të plotësonte shtyllat një e nga një, mjeku u interesua të mësonte si ishin fshirë aq çuditërisht gjurmët e asaj sëmundjeje të hershme. Po Ilir Meçani heshte si një gur. Me trup i riu Ilir Meçani ishte aty, po mendja i fluturoi në ata dy vjet të shkuar.

— I paaftë! — tha atëherë mjeku me syze të trasha e flokë të rënë dhe anëtarët e komisionit firmosën njëri pas tjetrit. Ajo flakë e goditi Ilir Meçanin me forcën e një sëpate dhe ai mezi e mblodhi veten.

Doli si i dehur nga Dega. Fshati ishte katër orë larg. Në xhade venin e vinin makinat. Ai i vështronte me inat. Çdo gjë që e rrethonte i ngrinte nervat. Edhe plepat në rresht, si ushtarët në të dy anët e rrugës, edhe kalimtarët e rrallë, të gjitha i ndillnin mëri. «I paaftë!» Kjo fjalë gjemonte me dridhmen e një krisme: «I paaftë... Bam... I paaftë... Bam-bam... I paaftë!»

Dreq o punë! Ja dhe fshati. Si të shkante atje? Si t'u dilte njerëzve përpara? Ç't'u thoshte? Ata me siguri do ta pyesnin:

«Hë, mor Ilir, shkovë?» Ai do të ecte. Ata do ta pyesnin: «Fol, de, të pranuan?» Ai do të heshte. Po ata prapë do ta pyesnin:

«Hë, mo Ilir, ç'na thua?

Po ai s'do të kishte gjuhë të përgjigjej.

«Ilir, mor bir, ç'ke kështu?»

Para syve i doli gjyshi, gjysh Mitrushin. Si nuk

i kishte shkuar më parë mendja për gjyshin!? Tek ai vinin të merrnin mend jo më nga fshati e nga krahina, po që nga ana e anës. Madje, edhe shokët me diplomë e çmonin dhe e nderonin. Kurse ai që e kishte gjyshin e tij...

— Gjysh, nuk më pranuan — tha, ndërsa kraharori nuk i ngopej me frymë.

— Ku, more bir?

— Në ushtri.

Gjyshi vuri kokën e bastunit nën sqetull dhe me fundin e tij nisi të gërryente tokën. Maja metalike këpuste si iriq rrënjët e barit.

— Vetë vajte, apo të thirrën?

— Vetë.

Gjyshi u mbështet edhe më mirë mbi bastun dhe e shtyu me tërë forcën.

— Pse shkove, — e pyeti pa ditur ç'ti thoshte.

Kraharori i djalit ngrihej e ulej me rrëmbim. Brenda tij dukej sikur kërciste e copëtohej diçka, si rrënjët e barit.

— Që të mbroj atdheun. Kjo dihet.

Këto fjalë patën një kumbim të çuditshëm. Gjyshi nuk e kishte dëgjuar kurrë të fliste ashtu të nipin. Nuk i kishte parë aq të ndezur sytë e tij. Kishte kujtuar se i nipi ishte djalë i qetë e si baballëk. Kurse tani po zbulonte një njeri tjetër tek ai.

— Që të mbrosh atdheun, — the, hə?

Gjyshi u turbullua nga ato fjalë, nga ai vështrim. Në vështrimin e nipit dalloj diçka nga rinia e tij e largët dhe e harruar. Si nëpër mjegull iu kujtua se njëherë e një kohë edhe atë e kërkuan të shkante nizam e të linte kockat në Anadoll. Po Meçan Ko-

vaçi nuk u bind. Vendosi të dilte firar. Dhe jeta e vet rrodhi e sertë maleve. U ushqye Meçan Kovaçi me boronica e mana toke. Përthau plagët në llohë e shqotë. Kërceu me dhinë e egra nga shkëmbi në shkëmb, fjeti me arinjte guvave dhe u bë i sertë si ata... Si mali. Si shkëmbi.

— Nuk më pranuan! — përsëriti Iliri.

Gjyshi u zgjua nga kujtimet.

— Për një vit? Për dy?

— Jo. Përgjithnjë, — iu përgjigj ai dhe prapë iu ngrit gjoksi si dallgë deti.

— Si kështu?!

Gjyshi i lëmoi flokët e ashpër e të ngritur si gjemba iriçi. I shikoi krahun, këmbën. Pastaj u mbështoll me gunën e dhirtë dhe tymosi me llullë duhan të fortë fshati për dy ditë e dy net me radhë. Dukej sikur të njëqind e kusur vjetët i kishte kaluar atje, në mes tymit, pa e larguar llullën nga goja. Më në fund thirri nipçen dhe e vështroi gjatë në kokërr të syrit, si të kërkonte atje të fshehtë të mundon-te.

— Ilir, a je i fortë, or bir? — e pyeti. — A je si ata gjyshërit e qëmoçëm, që ke lexuar ndër libra e që të kanë dhënë emrin?

— Si të them? — u përgjigj Iliri.

— Të thuash «jam». Ja, kështu të thuash! — i erdhi në ndihmë gjyshi.

— Jam, gjysh! — tha ai prerë.

— Ja, kjo është fjalë burri, — u kënaq gjyshi. — Dhe tani më thuaj prapë: Do që t'i lësh të habitur ata të komisionit?

Ilirit iu drodhën buzët si letër cigareje, po fjalë nuk nxori.

— Ty po të pyes, — mori zjarr gjysh Meçani.
— Do që të shkosh ushtar si të gjithë shokët, apo...?
— Dua! — u përgjigj nipi dhe u duk sikur atë fjalë e shkuli nga thellësitë e gjoksit.

Gjyshi gjeti në tonin e Ilirit dhe ca më shumë në sytë e tij përgjigjen që kërkonte. Vështroi gjatë gjuhët e flakës në oxhak. Iliri priti me shpresë dhe përsëri e qortoi veten që nuk e kishte ndarë me gjyshin brengën që e mundonte. Njerëzit merrnin rrugën nga ana e anës e vinin të këshilloheshin me të, kurse ai e kishte në shtëpi dhe kotej poshtë e përpjetë!...

— Tani hapi mirë veshët dhe dëgjomë! — i tha gjyshi. — Sëmundja tënde, or nipçe, ndryshon nga të gjitha të tjerat. Ajo nuk shërohet me barëra, por me të lëvizur, me të punuar. Ja, de, me se shërohet! Kuptove tani?

Iliri mblodhi supet.

— Nuk kuptove? E, mirë atëherë, dëgjo ç'të them dhe mos më ndërpre!

Dhe kuvenduan gjatë.

Të nesërmen Iliri u ngrit pa rënë dita dhe mori përpjetë malit. Barinjtë e kooperativës e pritën vetullngrysur.

«Gjysmë njeri, — thanë, — nuk na bën lazëm».

Po ditët rrodhën e u zhdukën si vesa dhe ata u bindën se qenë nxituar. Gjatë atyre ditëve Ilir Meçanit s'i zunë këmbët dhe. I binte malit me kopenë përpara cep më cep, zbriste dy-tri herë në javë nga stani në fshat dhe mbrëmjeve ulej në shtrungë e milte dhentë, duke i mbushur vedrat me qumësht. Barinjtë vështronin shoshoqin në sy dhe ngrinin supet.

«Iliri ynë ky?»

Ai bënte sikur nuk e vinte re habinë e tyre. Ndërkaq i pëlqente të ndizte sherrin për hijgjë dhe të mundej befaz me barinjte, ose të hante inat se kush do ta hidhte gurin nga honi në hon. Shpesh mundej kot në këto gara, po kishte dhe raste që dilte i fituar, e kjo i linte pa mend të tjerët. Në mbrëmje lajmi bëhej me këmbë dhe e merrte vesh i tërë fshati. E dëgjonin dhe vajzat e skuqeshin nga njëra-tjetra. «Iliri moj! — thoshin. — Kujt i shkante mendja për Ilirin!»

Gjysh Meçani qeshte për nën mustaqet e zbardhura borë.

— Pa afrohu këtu, or nipçe! — i tha një ditë. — Dhe tani, hajde, shtrëngoma një herë dorën me të djathtën! Po fort ama, fort!

Gishtërinjtë kockëthatë e kockëgjatë të gjyshit kërcitën, po ai nuk e dha veten.

— Nuk është forcë ushtari kjo, or, jo! — tha Meçan Kovaçi. — Ushtari kthen çeliku.

Iliri uli kokën dhe nuk foli.

— Dëgjo! — tha prapë gjyshi. — Tani që mbushë vitin në stan, do t'i lësh bagëtitë dhe do të zbrësesh në kovaçanë. Me kryetarin jam marrë vesh unë.

Ilirit i theri në zemër. Ishte mësuar me malin, me stanin, me barinjte. S'i ndahej shpirti nga ata. Po fjala e gjyshit nuk bëhej dy. Dhe erdhën ditë të vështira për Ilir Meçanin. Sa çelte dita, ai ndizte zjarrin, pastaj, kovaçi nga njëra anë e ai nga tjetra, rrihnin tërë ditën e ditës metalin e skuqur, duke lodhënë forma nga më të çuditshmet. Aq shumë e lodhte kjo punë, sa disa herë i kishte rënë të fikët dhe që rrëzuar shakull mu atje, nën farkë,

po kur përmendej e goditte edhe më me inat metalin e skuqur në kudhër, si t'ia kishte ai të gjithë fajin. Në mbrëmje kthehej i kapitur në shtëpi, hante si i babëzitur dhe shtrihej e flinte. Atëherë e merrte fjalën Meçan Kovaçi. Ai hidhte tej sharkun e dhirtë dhe fillonte nga puna. E niste lehtë e lehtë, pastaj gishtërinjtë e tij kockëtrashë lodronin e kërcenin me një shkathtësi të çuditshme mbi çdo damar, çdo muskul e kockë. Ishte mjeshër i masazhit Meçan Kovaçi. Ku vinte dorë ai, ngrihej dhe i vdekuri nga varri.

— Për sonte mjaft, — thoshte më në fund dhe mbulohej sërish me gunë, afrohej pranë oxhakut e priste atje agimin.

Një mëngjes Malasin e zgjuan nga gjumi thirrje të shqetësuar. Thuhej se natën rrugëve të fshatit ishte shfaqur lugati. E kishte parë me sytë e tij xha Markoja, roja i depove. Ne, s'do mend, nuk e besuam, po hajde t'ia mbyllje gojën xha Markos. «E kam parë dhe pikë», ngulte këmbë. Puna u trash aq, sa ndonjë plakë nuk guxonte ta kapërcente pragun e shtëpisë natën. Atëherë ne vendosëm të bënim rojë, të bindur se do ta linim xha Markon me gisht në gojë. Përgjuam një natë. Dy. Një javë. Kur ja! Sa zbardhi vetulla e hënës, «lugati» sikur mbiu nga dheu në oborrin e shkollës. Rrëshqiti si hije anës murit dhe nisi të hidhej e të përdridhej në brezin e sulmit të shkollës. Vrapoi mbi tarabë, kapërceu trarin e ekuilibrit, rrëshqiti nën pengesat prej teli dhe e nisi prapë nga e para. «Nxënës ky?! Ndonjë nxënës sedërli», thamë ne dhe u bëmë rrafsh me tokën. E rrethuam nga të katër anët dhe kërcyem mbi të. Kur ç'të shihnim, ishte Iliri ynë! Ilir Meçani! «Po, ti mor i

uruar, përse tani natën?» Ai na u shkëput nga duart dhe u bë erë. Nuk i erdhi mirë që ia zbuluam të fshehtë. Po dorë s'hoqi nga e tija. Të pasnesërmen doli në mesditë e nisi të stërvitej në brezin e sulmit.

Ishte koha që kopshtijet kundërmonin erë ftoi e shegët e hapura gojë sikur buzëqeshnin nga degët. Në fshat kishin ardhur fletëthirrjet e para për ushtarë.

Mjeku i 'Degës dhe Ilir Meçani' qëndronin të heshtur përballë njëri-tjetrit. Ata të komisionit ushtarak kapsitnin sytë.

— Firmoseni! — i tha mjeku anëtarit më të ri, i cili vazhdonte të skiconte në fletore portretin e Ilirit. Ai e la lapsin mbi tavolinë dhe u ngrit.

— Do ta firmos, doktor, — tha. — Po ti nuk na shpjegove si ngjau kjo mrekulli që brenda dy vjetve ndërrova mendim dhe e shpallë këtë djalosh nga të paaftë në të aftë.

Mjeku që zënë vërteq ngushtë. Pa ditur si të përgjigjej, hoqi syzet e xhamta dhe nisi t'i fshinte me lëkurë kamoshi, sado që ato ishin plotësisht të pastra.

— S'di si të them. Mbase unë jam thjesht një mjek, kurse ai që e ka ndjekur ka qenë tamam shkencëtar!

Ilir Meçani ia rrëmbeu fletëthirrjen nga duart dhe u derdh përjashta.

— Gjysh, o gjyshi im, më pranuan! — thirri sa u tund tej e tej korridori i Degës Ushtarake.

PUNË TË MBARË, GENCI!

Dera trokiti lehtë.

Ishte korrieri i Degës së Punëve të Brendshme. Oficeri pyeti pa ngritur sytë nga gazeta:

— Hë, Arben, ç'kemi?

Tjetri mori drejtqëndrim:

— Ka ardhur një fshatar, shoku shef. Kërkon t'ju takojë. Duket mjaft i shqetësuar.

— Lejoje!

Brenda u fut një plak i thinjur, i kërrusur nga pesha e viteve, me një cigare të fikur në buzë.

— Urdhëroni, gjysh!

Oficeri i shtrëngoi dorën dhe i afroi një karrige, po fshatari nuk u ul. I hodhi një sy dhomës nga njëri cep në tjetrin, tavolinës, portretit në mur, vazos me lule mëllage, si të kishte ardhur për të

parë ato dhe jo për hall. Dukej që mendohej si të fillonte.

— Njëditëzaj po kthehesha nga pazari për në fshat. Nën hijen e ullirit, e di atë ullirin e Xhebro Komitit ti? Nën hijen e atij ulliri de, u ula ta ndizja një e të mbushesha me frymë. Kur, që the ti, m'u afrua një djalë. «Ku shkon, or plak?» më pyeti. «Në fshat», i thashë. «E paskemi rrugën bashkë», më tha. «Do jetë ndonjë nga djemtë tanë», mendova. Qëndruam ca dhe u ngritëm. Unë përpara e ai pas, gjersa arritëm te përroi. Atje rruga që mbytur në baltë. Unë i zgjata dorën dhe i kërkova ndihmë, po ai, lëre ç'ndihmë më dha! Ma ngjeshi me një shkop pas koke, që the ti, sa m'u soll bota rrotull. Nuk mora vesh ku rashë e qysh u përmenda. Kur e mblodha, ai më kishte marrë ç'pata në xhep dhe që zhdukur nga sytë këmbët. Ja kështu!

Plaku i zgjati shefit prapë kutinë e cigareve. Pastaj tundi kryet.

— Më ndje, harrova që ti s'e pi, — tha. Duart i dridheshin, ca nga nervozizmi, ca nga pleqëria. Shefi seç vazhdonte të shkruante në një libër të trashë.

— Kam dyshim, — shtoi pas pak xhaxhoja, — se ai kopuk ngre dorë edhe kundër të tjerëve. Prandaj zëreni dhe shtrëngojadi rripat.

— Doemos, doemos. Po edhe me ndihmën tuaj, veç, — iu përgjigj oficeri dhe u ngrit. Thirri në zyrë një nga shokët e tij, Gencin.

— Ky, — tha, — do ta ndjekë çështjen.

Genci e nxiti plakun ta riprodhonte ngjarjen gjer në hollësitë më të vogla; madje të përshkruante edhe tiparet e keqbërësit.

— Ja, nga trupi vinte i mangët. Kishte flokë të verdhë. Xhaketën kadife. Kaq.

— Po tjetër? — pyeti Genci.

— Ëhë; tjetër mos prit! S'punon kjo, — tha plaku dhe vuri gishtin në tëmtha. Pastaj shtoi: — Po ta shoh përsëri mund të më kujtohet edhe ndonjë tipar tjetër i tij.

Atëherë Genci u ngrit, doli jashtë për pak kohë dhe hyri me disa fotografi. Ia tregoi ato plakut me radhë duke e pyetur në ishte djali keqbërës në ndonjërin prej tyre. Dhe si mori përgjigjen «jo», i hodhi krahun dhe e ftoi për një kafe.

Klubi ishte plot. Disa u tërhoqën mënjane dhe u bënë vend. Plaku i vështroi të gjithë më nge. Iu dukën burra të pjekur, kurse Genci sikur nuk ia mbushte syrin. Ishte fare i ri e me push në faqe.

«Aha, s'ka për të nxjerrë gjë në kut ky!» mendoi.

Djaloshi sikur ia zbuloi mendimet.

— Do ta gjejmë, — i tha me bindje. — Hiç mos u bëj merak. S'ka nga na fluturon.

Po puna nuk ishte e lehtë.

Gjatë atyre ditëve atij nuk i zunë këmbët dhe. Rendi lagjeve, qendrave të punës, madje edhe në disa fshatra të afërta, duke hetuar njerëzit e dyshimtë për akte rrugaçërie.

Një javë u end me orë të tëra në tregun fshatar. Sheshi i gjerë e i rumbullakët ziente. Disa shitni zarzavate e fruta, të tjerë erëza e farëra. Ai u kujdes të mos tërhiqte vëmendjen e askujt. Hera-herës qëndronte pyeste për çmimet dhe vazhonte më tej. Pas ca u fut në një pasticeri, prej nga mund të vrojtonte pa rënë në sy. Nuk kaloi shumë dhe i vajti kamarieri.

— Kafe?— e pyeti.

— Jo, një kasatë,— iu përgjigj ai.

Si doli nga pasticeria, Genci i ra prapë tregut nga qoshja në qoshe.

Genci u mat disa herë të raportonte për veprimet e atyre ditëve, por ndërroi mendje. E ç'rëndësi kishin ato, përderisa nuk kishte mundur të binte në gjurmë?

Shefi e thirri dhe nisi të shfaqte mendimet e tij. Genci ishte mësuar me këtë metodë të shefit. Kur donte të shkurtonte kohën e analizës së fakteve, ai e merrte shpesh fjalën vetë, parashtronte një mendim, të cilin aty e mbronte me zjarr e aty kërkonte argumente nga bashkëfolësi. Madje, jo rrallë hidhte për diskutim edhe mendime për të cilat kishte edhe vetë rezerva, por që nuk mund të mos përfillëshin.

Ai foli ngadalë, duke i lënë kohë Gencit të thellohej në ato që dëgjonte.

— Keqbërësi duhet të jetë me pak përvojë, përderisa vepron ditën e pazarit, duke e lehtësuar deri në një farë shkalle punën për zbulimin e tij.

Shefi e la Gencin të mendohej.

— Dakord gjër këtu?— pyeti pas pak.

— Jo, — u përgjigj Genci, — jo, plotësisht.

— Ashtu!? — vështrimi i shefit u gjallërua. Genci e dinte se atij i pëlqente debati.

— Atëherë më provoni të kundërtën!— tha dhe i nguli vështrimin.

— Më duket se keqbërësi nuk është fare fillëstar...

Si i renditi me kujdes mendimet, Genci priti në heshtje gjykimin e shefit. As ai nuk u përgjigj menjëherë. Duke u vërtitur nëpër zyrë, siç e kishte

zakon, përpiquej ta peshonte çdo gjë pa u ngutur.

— Po, mund të jetë edhe ashtu,— tha më në fund.— Ka të ngjarë të jetë edhe ashtu. Megjithatë...

Ata biseduan gjatë, duke kundërshtuar, ose miratuar, sipas rastit, mendimet e shoshokut. Pastaj hartuan me kujdes planin e veprimeve të ardhme, duke u përpjekur të fitonin sa të ishte e mundur më shumë kohën e humbur. Si e përfunduan edhe këtë, u ngritën të dilnin.

Shefi i zgjati dorën për t'u përshëndetur.

— Mos harroni se nesër është e diel. Një rast i volitshëm për t'u gjurmuar, e ndofta edhe për ta arritur atë që dëshirojmë. Pra, punë të mbarë, Genci! Nesër në mbrëmje takohemi e bisedojmë përsëri.

Genci hëngri darkë në shtëpinë e ushtarakëve dhe shkoi në dhomë. E dinte se para detyrave të vështira, kryesorja ishte të pushonte mirë e të flinte, me qëllim që të nesërmen të ishte më i fortë, më i freskët! Mori nga rafti një libër e nisi të lexonte, me shpresë se mund ta zinte gjumi më shpejt. Por germat e rreshtat ngatërroheshin me njëri-tjetrin e në vesh i kumbonin gjithmonë porosinë e shefit.

Flaku batanijen. U ngrit dhe iu afrua dritares. Jashtë vesonte. Në rrugë vazhdonte lëvizja. Një çift i ri çapitej ngadalë. Kurse një i moshuar i hidhte hapat me të shpejtë. Gencit iu kujtua plakku me të cilin ishte takuar disa ditë më parë në zyrën e oficerit të rojës.

«Po sikur të kërkoj ndihmën e tij?» pyeti veten. Dhe vendosi: «Ashtu do të bëj!»

U ngrit e doli sakaq jashtë. Mori rrugën e fshatit të plakut. Ai ishte afër. Ecte. Ecte dhe

mendonte. A do t'ia dilte mbanë? Po, pse jo! Në qoftë se plaku nuk e mbante mend fytyrën e keqbërësit, ky i fundit me siguri e njihte. Ndjenja e takimit, e ndeshjes me keqbërësin ia kthjellonte mendimin, e bënte të përmbajtur.

* * *

Përsëri në treg nisi t'i vrojtonte me kujdes kalimtarët. Një çast iu duk se jo një e dy, por shumë nga ata që e rrethonin ishin veshur me xhaketa kadife, vinin të pakët nga trupi, kishin flokë të verdhë... Shkurtoi hapin dhe vrojtoi me shumë kujdes. Xhaketat kadife e qeleshet sikur i përpiu dheu. E kuptoi se kjo pandehmë të vjen shpesh nga lodhja, ose nga ngulmimi për të arritur atë që do, sidomos kur i ke ngulitur fort në kujtesë tiparet e atij që kërkon. Në këso rastesh të duket sikur ke rënë në gjurmë e je fare pranë suksesit. Por, kur përqendrohesh dhe vëren më me mprehtësi, bindesh se kjo është më tepër një iluzion sesa një e vërtetë.

Papritur vështrimi i kapi një djalë të veshur me xhaketë kadife, i shkurtër nga trupi e i shëndetshëm. Ngadalësoi hapin dhe e shikoi më me kujdes. I hodhi edhe plakut, që sillej rrotull tij, një vështrim pyetës:

«Ai?»

Plaku ngriti supet. Megjithatë Genci vendosi të mos i ndahej. Njeriu me xhaketë kadife pyeti në dytri vende për çmimet, bleu disa erëza dhe doli nga tregu. I panjohuri u ndal disa çaste në vitrinat e një dyqani, pastaj mori rrugën e komitetit ekzekutiv. Kur u fut në zyrat e seksionit të

tregtisë, Gencit iu çel fytyra. Referentin e kishte shok fëmijnie dhe mund të futej brenda shkak e pa shkak. E la plakun jashtë dhe hyri. I gjeti tek bisedonin kokë më kokë atë dhe referentin. Ky i fundit e pa Gencin, iu turr dhe e takoi.

— Ku je, mor!? Në një qytet dhe shihemi kaq rrallë! Seriozisht që më ka marrë malli.

Genci u përpoq të tregohet po aq i shkujdesur dhe i përzemërt. Pastaj i hodhi një sy thuasë rastësisht njeriut me xhakëtë kadife. Po shpejt mori vesh se nuk qenkësh ai.

U kërkoi leje dhe u largua drejt tregut. Plaku në një krah, ai në tjetrin.

Keqbërësi kishte shumë mundësi të shfaqej në orët e drekës, ose pasdite vonë. Sidoqoftë, duhej të ishin gati për çdo të papritur. Dhe nuk u gabua. Kishin kalluar më pak se dy orë, kur plakun e kapi lehtë Gencin nga krahu dhe i pëshpëriti:

— Qepmu pas!

Genci eci midis njerëzve.

— Pa shih njëherë. Çoç më ngjan sikur është ai atje, tek ajo shtylla prej betoni!

Ai u ndal dhe e vrojtoi pa tërhequr vëmendjen e kalimtarëve. Përballë, përfund një shtyllë ishte ulur një i ri me syze dielli dhe një kapelë kashtore. Plakut i kishin mbetur sytë mbi flokët e verdhë e të paqethur të tij dhe te xhaketa kadife. Genci e porositi:

— Xhaxha, ec drejt shtyllës.

Keqbërësi rrinte këmbëkryq dhe mbllaçitej i qetë. Vështrimin e përhumur e kishte hedhur diku përpara, në një pikë të padukshme. Më në fund sikur u zgjua nga gjumi dhe e nguli shikimin mbi një grua, që çapitej ngadalë me fëmijën për dore, pa-

staj mbi një ushtarak. Kur dalloi plakun, stepi për një çast, pastaj u tërhoq këmbadoras si mace, duke u përpjekur të fshihej në turmë. Por, ishte vonë.

Dy krahë të fuqishëm e mbërthyen fort keqbërësin dhe i folën në vesh:

— Mos u mundo të lëvizësh! I dimë të gjitha.
Plaku i ndoqi pas i çliruar.

Fund

PËRMBAJTJA E LËNDES

| | |
|--|-----|
| 1. Fantazma e të humburve | 3 |
| 2. Ai i buzëqeshi | 18 |
| 3. Ata që i bien dyares | 26 |
| 4. Këngë për nënat | 37 |
| 5. Ngarkesa e dëborës | 53 |
| 6. Bisedë për qarkullimin | 65 |
| 7. Ngjarje në stepë | 78 |
| 8. Shokët | 95 |
| 9. Kur marr dyfekun e bëj përpjetë malit | 107 |
| 10. «Nënolja» | 120 |
| 11. Në korridorin e gjatë të Degës Ushtarake | 127 |
| 12. Punë të mbarë, Genci! | 140 |